

1 E mërkurë, 22 janar 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.04

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
6 Gjykatës, paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të shënohet
12 në procesverbal që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit.

14 Sot do të vazhdojmë me marrjen e dëshmisë prej
15 Dëshmitarit të Prokurorisë W02183.

16 Znj. Sekretare, sillni dëshmitarin në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
19 z. Strohmejer.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
22 vazhdojnë pyetjet nga e Gjykatësve. Gjykatësi Mettraux ka disa
23 pyetje për ju.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
25 Smith.

1 DËSHMITARI: HANSJOERG STROHMEYER [Vijon]

2 Pyetje nga Trupi Gjykses: [Vazhdim]

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëmëngjesi, z.

4 Strohmeier. Do të doja të vazhdoj të trajtojme një çështje në
5 veçanti mbi të cilën ju bënë pyetje nga palët. Pjesa më e
6 madhe e pyetjeve të mia kanë të bëjnë me Qeverinë e Përkohshme
7 të Kosovës.

8 Pyetja ime e parë është më shumë një qartësim. A e kuptoj
9 drejt që nga pikëpamja e Kombeve të Bashkuara kjo Qeveri e
10 Përkohshme nuk kishte ekzistencë të ligjshme? A ju kam kuptuar
11 drejt?

12 PË. Saktë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A do të thotë, për
14 rrjedhojë, pra, dhe përsëri nga pikëpamja e Kombeve të
15 Bashkuara, se ju nuk e keni konsideruar dekretet dhe vendimet
16 që janë miratuar nga kjo Qeveri e Përkohshme, nuk i keni
17 vlerësuar që këto kishin ndonjë vlefshmëri ligjore, pra, me
18 fjalë të tjera, nuk kishin ligjin në Kosovë nga pikëpamja
19 juaj?

20 PË. Saktë.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A vlen kjo dhe për
22 emërimet e bëra nga Qeveria e Përkohshme, pra, që ju nuk i
23 keni konsideruar këto si të vlefshme nga pikëpamja ligjore apo
24 relevante për misionin tuaj?

25 PË. E saktë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kam kuptuar drejt
2 dhe, në qoftë se s'është nuk është kështu më thoni, se ju,
3 Kombet e Bashkuara, ishit të kujdesshëm në mënyrën se si i
4 keni trajtuar apo ndërvepruar me këta individë me qëllim që të
5 mos jepnit legjitimitet apo perceptimin e legjitimitetit
6 Qeverisë së Përkohshme?

7 PË. Nuk ishim të kujdesshëm në raportet tona me këta
8 individë, por ishim të kujdesshëm që të mos angazhoheshim apo
9 shkëmbejmë, ndërvepronim me ta në cilësinë e tyre si me
10 funksione qeveritare. Më është bërë një pyetje gjatë
11 deklaratës time lidhur me faktin nëse kisha dëgjuar dikënd që
12 t'i referohej z. Thaçi si kryeministër. Ne, kjo do të ishte
13 një prej shembujve, ne nuk e kemi quajtur atë kryeministër.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe kjo ishte pyetja ime e
15 radhës. Pashë te shënimet e takimeve, procesverbalet e
16 takimeve që keni mbajtur ju, e kam fjalën, KFOR-i, UNMIK-u me
17 z. Thaçi dhe z. Çeku ku duket që aty atyre u referohet si
18 gjithmonë si udhëheqës të UÇK-së apo përfaqësues të UÇK-së. E
19 kuptoj drejt që kur keni biseduar me z. Çeku dhe Thaçi ju i
20 jeni drejtuar atyre si udhëheqës të UÇK-së dhe jo si ministra
21 të qeverisë, është e saktë?

22 PË. E saktë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani, Misetic ju pyeti në
24 veçanti lidhur me atë që dinit ju për kohën, rrethanat, vendin
25 e krijimit të kësaj qeverie të përkohshme, ju kujtohen këto

1 pyetje?

2 PË. Më kujtohet.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju tregoj disa
4 dokumente dhe të shohim nëse mund të na ndihmoni pak më shumë
5 lidhur me këtë.

6 Sekretarit i kërkoj të shfaqë në ekran dokumentin P1138.

7 Së pari, z. Strohmeyer, do t'ju them se çfarë pretendohet
8 të jetë ky dokument me qëllim që ta dini se për çfarë po
9 flasim. Ky është një dokument i dorëshkruar që mendohet të
10 jetë i Jakup Krasniqit, shkruar nga Jakup Krasniqi. Dhe mban
11 titullin "Formimi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së". Ky
12 dokument, sa na kanë thënë neve, është gjetur në shtëpinë e
13 Jakup Krasniqi. E kuptoni?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen
16 e fundit të dokumentit, që është në faqen 11 në anglisht, e
17 njëjta faqe në shqip. SPOE00231437. Dhe do t'ju kërkoja të
18 përqendroheshit në paragrafin e parë të plotë i cili fillon me
19 fjalët: "Në kohën kur Kosova ..."

20 E shikoni këtë?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pjesa e dytë e kësaj
23 fjalisë të parë lexon si në vijim:

24 "... shtabi i UÇK-së i jep kompetenca kryeministrit që
25 kishte dalë nga Marrëveshja e Rambujesë, z. Hashim Thaçi, që

1 ta formojë Qeverinë e Unitetit Kombëtar të Kosovës që u quajt
2 QPK ...”

3 E shikoni këtë?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime e parë është:
6 Në ndërveprimet tuaja me z. Thaçi, a ju tha ai ndonjëherë, siç
7 shkruhet këtu në dokument, që atij i ishte dhënë përgjegjësia
8 për të formuar Qeverinë e Përkohshme?

9 PË. Ka gjasa, por nuk më kujtohet me saktësi. Kjo mund të
10 ketë ndodhur në Hotelin Grand, por nuk më kujtohet me saktësi.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t’i kthehem Hotelit
12 Grand pak më pas.

13 A mund të kalojmë në faqen 8 të të njëjtit dokument?
14 SPOE00231434.

15 Në versionin në anglisht, z. Strohmeier, do t’ju kërkoja
16 të shikonit mesin e faqes, paragrafin e madh që fillon me
17 fjalët: “Një mbledhje tjetër shumë e rëndësishme ...”

18 E shikoni këtë?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtu dokumenti i referohet
21 një takimi të datës 27 dhe 28 shkurt 1999, i cili përshkruhet
22 si në vijim:

23 “Një mbledhje tjetër shumë e rëndësishme e UÇK-së ishte
24 ai i datës 27, 28 shkurt 1999, e cila është mbajtur pas
25 kthimit të delegacionit të UÇK-së nga Konferenca Ndërkombëtare

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 6

1 e Rambujes, në të cilën janë biseduar për katër çështje vitale
2 të kohës si: a) Shtabi i Përgjithshëm është njoftuar për
3 rrjedhat e konferencës; b) është biseduar për një delegacion
4 të UÇK-së i cili duhej të shkonte në SHBA - i cili në fakt nuk
5 shkoi kurrë; c) është vendosur përfundimisht për komandantin e
6 përgjithshëm të UÇK-së; dhe d) është caktuar kandidati nga
7 radhët e UÇK-së për kryeministër të Qeverisë së Përkohshme.

8 Pyetja ime është e ngjashme me ato më herët. Kur jeni
9 takuar me z. Thaçi dhe keni diskutuar idenë e Qeverisë së
10 Përkohshme a u përmend në praninë tuaj se kandidati për
11 kryeministër ishte përzgjedhur nga UÇK-ja, nga Shtabi i
12 Përgjithshëm i UÇK-së? A është kjo diçka që iu përmend juve?
13 PË. Jo. Në një formë, dhe po mendoj që është përmendur në një
14 version të deklaratës time, më kujtohet që njerëzit i
15 referoheshin atij si kryeministër. Ne nuk e kemi bërë këtë
16 gjë. Tani rrethanat konkrete se si u arrit në këtë pikë nuk
17 jam i sigurtë të kem ditur këtë gjënë atë kohë dhe tani s'më
18 kujtohet gjithsesi.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dokumenti vazhdon më
20 poshtë dhe lexon:

21 "Qeveria e Përkohshme do të formohej për të udhëhequr
22 vendin pas konferencës, përfundimit të konferencës së
23 Rambujesë. Marrëveshja u arrit -- që u arrit në Rambuje kishte
24 -- dhe kishte thënë që Jakup Krasniqi duhet të ishte
25 kryeministër i Qeverisë së Përkohshme, por qeveria nuk u

1 formua: Kjo çështje nuk u bë publike.”

2 Do të ndalem këtu një çast. Dhe duke e lidhur me
3 përgjigjen që i dhatë Misetiç dje. Po a ishit i informuar që
4 pas diskutimeve në Rambuje, tre partitë kishin arritur një
5 marrëveshje për formimin e qeverisë në atë kohë? Këto ishin
6 LDK-ja, LBD-ja dhe UÇK-ja. A ishit ju në dijeni të ekzistencës
7 së një marrëveshjeje të tillë?

8 PË. Mund të kem qenë, por nuk -- sinqerisht nuk më kujtohet.
9 Ajo që mund t'ju them është që nuk ka patur shumë diskutim mes
10 nesh lidhur me Rambujenë sepse përshtypja jonë ishte dhe, kjo
11 lidhet me pyetjen tuaj të mëparshme, nuk kishte vazhdimësi mes
12 Rambujesë dhe periudhës pas 10 qershorit, sepse Rezoluta 1244
13 kishte krijuar një situatë tërësisht të re, përfshirë dhe disa
14 nga vendet anëtare që kishin qenë dëshmitarë të zhvillimeve në
15 Rambuje, dhe Rezoluta e Kombeve të Bashkuara vendosi një
16 regjim tjetër.

17 Kjo ishte e rëndësishme për të kuptuar në mënyrë të
18 përgjithshme kontekstin dhe se si zhvilloheshin ambiciet e
19 njerëzve por jo, nuk ishte diçka që ishte e ndërlidhur me ne,
20 “për shkak të Rambujesë, duhet të interpretojmë Rezolutën 1244
21 në këtë mënyrë apo në atë mënyrë”.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. E kuptoj
23 tërësisht dhe ju falënderoj për këtë. Për nevoja të
24 procesverbalit, prova materiale është 1269.

25 Tani dokumenti që po shohim vazhdon duke thënë:

1 "Informuam po ashtu pjesëtarët, anëtarët e Shtabit të
2 Përgjithshëm për bisedimet që kishin zhvilluar lidhur me
3 formimin e qeverisë, por nuk u formua asnjë qeveri. Edhe po të
4 ishte formuar qeveria, kjo nuk do t'i kishte shkaktuar asnjë
5 dëm popullit shqiptar dhe procesit politik. Në fund të fundit
6 lufta ishte bërë për të formuar një qeveri kombëtare dhe po të
7 ishte arritur një gjë e tillë në Rambuje do të kishte qenë
8 fitore e madhe për luftën e çlirimit, luftën çlirimtare. Në
9 Rambuje kreu i delegacionit të Kosovës ishte Hashim Thaçi.
10 Marrëveshja e arritur në Rambuje mes delegacionit të Kosovës
11 dhe delegacionit të Serbisë mbështetej nga Shtabi i
12 Përgjithshëm i UÇK-së i cili kishte emëruar Hashim Thaçin si
13 kryeministër."

14 Tani ky përshkrim a është në përputhje me atë që na thatë
15 më herët që z. Thaçi ishte prezantuar nga disa apo përshkruar
16 nga disa si kryeministër i Qeverisë së Përkohshme?
17 PË. Mendoj që po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po përmend këtu gjithashtu
19 provën materiale P645 për procesverbal.

20 A jeni në dijeni që në fillim të prillit 1999, një muaj
21 apo gjashtë javë pasi kishit arritur ju në terren, UÇK-ja
22 kishte shpallur formalisht, zyrtarisht, krijimin e Qeverisë së
23 Përkohshme dhe e kishte përshkruar përbërjen e saj?

24 PË. Dua të them jo. Mund të kem patur ndonjë informacion,
25 copëza informacioni në atë kohë, siç e përmenda, më duket

1 ditën e parë të dëshmisë sime. Gjatë kohës që isha në
2 departamentin e z. De Mello në New York në atë kohë, duke
3 marrë me disa prej aspekteve që ne i quanim, të asaj që ne i
4 quanim kriza e Kosovës, por nuk kam qenë i përfshirë kaq
5 shumë, nuk i kam ndjekur ngjarjet në hollësi.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Na thatë disa herë dje,
7 pardje dhe sot, nëse ju kam kuptuar drejt, që në një moment të
8 caktuar jeni takuar me z. Thaçi në Hotelin Grand në Prishtinë
9 ku thuhet t'ju ketë prezantuar juve një lloj organigrame të
10 kësaj qeverie të përkohshme, a është e saktë?

11 PË. E saktë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju tregoj një
13 dokument tjetër dhe t'ju bëj pyetje lidhur me të, nëse ai
14 dokument ngjan -- në një mënyrë apo në tjetër i ngjan atij
15 dokumenti që iu prezantua juve në atë takim që ju thashë.

16 I kërkoj Sekretarit të paraqesë në ekran dokumentin,
17 provën materiale 1270.

18 Ajo që shohim --

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Desha të theksoj se kjo nuk është
20 organigramë.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Misetiç.

22 Dokumenti që e kemi, që shohim këtu, mban titullin
23 "Komunikatë e Qeverisë së Kosovës". Data është 2 prill, vendi
24 Prishtinë, duhet të jetë 2 prilli 1999 dhe është publikuar në
25 KosovaPress. Po ju jap një çast që ta lexoni vetë, pastaj do

1 t'ju bëj disa pyetje.

2 I kërkoj Sekretarit që të na tregojë pjesën më poshtë të
3 faqes që të shohim dokumentin në tërësi. Faleminderit.

4 Nja dy çështje që desha të shoh. Të shohim pak më sipër.

5 Z. Strohmeier, pajtoheni që bazuar në këtë dokument

6 kryeministri apo personi që përshkruhet si kryeministër i

7 qeverisë së Kosovës është z. Hashim Thaçi?

8 PË. Bazuar në këtë dokument, po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtu kemi disa pozita që
10 janë të shpallura në këtë organ, përfshirë edhe vendet boshe
11 të -- vendin bosh të kryeministrit për LDK-në?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dokumenti më tej vazhdon
14 që LDK-ja nuk ka bërë propozime për -- nuk ka propozuar person
15 për këtë post?

16 PË. E saktë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se shohim pastaj
18 postet ministeriale të ndryshme, kemi një individ të ndryshëm
19 që janë të identifikuar si pjesëtarë të UÇK-së?

20 PË. E saktë.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime e parë tani
22 është, natyrisht për atë që ju kujtohet, nëse struktura e
23 përshkruar këtu përputhet në një mënyrë apo tjetër me atë që
24 juve ju kujtohet që z. Thaçi ju prezantoi si organigramë?

25 PË. Sinqerisht nuk më kujtohen hollësitë e personave që m'u

1 treguan mua. Siç e thashë, kur përdora fjalën "organigramë",
2 ajo që kisha në mend është ajo më kujtohej si një lloj
3 strukture që na ishte prezantuar neve dhe për ministrinë e
4 ndryshme. Siç e thashë në dëshminë time më herët, më kujtohet
5 që ka qenë e shkurtër, një faqe apo edhe më shkurtër. Pra,
6 mund të jetë ky dokumenti që po shoh tani, por nuk mund ta
7 them këtë me siguri.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet nëse
9 organigrama mbante emra të personave që duhej të merrnin
10 pozitë në qeveri?

11 PË. Nuk më kujtohet.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kalojmë, kthehem tek
13 Qeveria e Përkohshme pak më pas. Por tani për momentin juve
14 jeni pyetur disa herë të shpjegoni si e keni kuptuar ju
15 pozitën që mbante z. Thaçi në atë kohë dhe ju është kërkuar të
16 jepni mendimin tuaj dhe atë që Jackson, Mike Jackson kishte
17 thënë lidhur me këtë.

18 Dhe kur iu bë juve dhe kur iu bë atij e njëjta pyetje,
19 gjenerali Jackson tha që ai kishte kuptuar që roli dhe
20 pushteti i z. Thaçi ishte i krahasueshëm - kjo gjendet në
21 paragrafin 30 të deklaratës - ishte i krahasueshëm me atë të
22 kryekomandantit. Ai përshkruan z. Çeku si ushtaraku më i lartë
23 në UÇK në atë kohë dhe si vartës i z. Thaçi.

24 Ky përshkrim i z. Jackson a është, a përputhet me mënyrën
25 si ju i keni kuptuar rolet e z. Thaçi dhe z. Çeku në atë kohë?

1 PË. Në qoftë se mund të sqaroj pak më shumë këtë pikë sepse
2 dua të jem i saktë. Besoj që e kam deklaruar më parë dhe e
3 pashë në dokumente që z. Thaçi kishte nënshkruar angazhimin si
4 kryekomandant.

5 Pra, nga ndërveprimet tona, nga ana civile e bëra me të,
6 ne nuk e kemi konsideruar z. Thaçi detyrimisht si
7 kryekomandant, si komandant ushtarak. Z. Jackson kishte një
8 realitet tjetër dhe një bisedë tjetër që ishin më shumë në një
9 mjedis ushtarak dhe mund të jetë ky aspekti që z. Thaçi
10 paraqitej në këtë mënyrë më shumë para z. Jackson.

11 Për neve, ishte e qartë, për mu ka qenë gjithmonë e qartë
12 se z. Thaçi ishte lidhur me të gjitha çështjet politike apo
13 kur kemi patur biseda lidhur me përbërjen e Këshillit
14 Tranzitor të Kosovës, kur kemi caktuar takime, bisedimet për
15 krijimin e forcën e policisë, përfshirjen e pjesëtarëve të
16 UÇK-së në forcën e policisë, këto takimet caktoheshin
17 gjithmonë me z. Thaçi dhe në një rast ai erdhi bashkë me z.
18 Çeku.

19 Pra për ne, kjo ishte realiteti. Z. Thaçi ishte personi
20 tek i cili duhej të adresoheshim, të drejtoheshim dhe siç e
21 thashë dje. Në një moment të caktuar, në të gjithë këtë ne
22 kishim dëgjuar dhe jam i sigurtë që përtej meje kishte njerëz
23 që ishin të vetëdijshëm dhe të informuar për gjithë historinë
24 e Rambujesë, pra, kishte një kontekst.

25 Sa i takon z. Çeku, që edhe për këtë thashë, ishte e

1 qartë që nga pikëpamja funksionale, ashtu siç u përshkrua,
2 ishte ushtaraku më i lartë me të cilin duhet ta trajtonim në
3 aspekte, sa i takon aspekteve teknike, ishte, pra, personi me
4 të cilin kontaktonim. Kjo do të thotë që ai ishte personi me
5 të cilin komunikonte kryesisht gjenerali Jackson, pastaj ka
6 qenë bashkëbisedues i imi në takimet e para të hershme të
7 Komisionit për Implementim. Z. Thaçi nuk ishte aty. Dhe pastaj
8 në një takim që kemi bërë më 2 ose 3 korrik 1999 lidhur me
9 krijimin e forcës së policisë, mendoj, që Thaçi na tha që
10 ishte z. Çeku personi tek i cili duhej të drejtoheshim.

11 Nuk e kam parë atë duke dhënë urdhra apo komanda, por për
12 mua kishte një gjë që sugjeron një nivel -- ajo që kuptova,
13 pra, që "Për këto çështje, ju lutem merrni me këtë person,
14 kontaktoni këtë person", që identifikon dhe përforcon
15 perceptimin që ky ishte udhëheqësi në rrethanat dhe që ai
16 ishte personi që do të merrej pastaj me çështjet teknike apo
17 aspektet më të specializuara të kësaj çështjeje.

18 Kërkoj ndjesë që po zgjatem pak më shumë, por përshtypjet
19 që ishte kjo, pra, për marrëdhënien mes tyre dhe funksionet që
20 ata kishin, mënyra të paktën se si më janë prezantuar mua.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini kush e emëroi z.
22 Çeku si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?
23 PË. Jo.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të ishte kjo
25 relevante për të përcaktuar kush është epror dhe kush është

1 vartës, a u krijua kjo varësi, linjë varësie?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim dhe një herë provën
4 P1138, në faqen 8.

5 I lutem Sekretarisë të shkojmë më poshtë drejt fundit të
6 faqes.

7 Z. Strohmeyer, ju lutem lexoni paragrafin e fundit të
8 këtij teksti. Dokumenti i atribuohet z. Krasniqi edhe thotë:

9 "Kishin ndodhur disa zhvillime në SHP-në të UÇK-së gjatë
10 qëndrimit në Rambuje që tregonte shenja të një rebelimi. Në
11 mbledhje është analizuar mirë situata e krijuar dhe është
12 ardhur në përfundim se mbi çdo interes vetjak të secilit
13 individ e anëtarë të SHP-së të UÇK-së qëndron interesi i
14 luftës për liri dhe ai i pavarësisë së Kosovës."

15 Gjatë kontakteve, takimeve që keni pasur me z. Thaçi dhe
16 në rrethana të tjera, a jeni vendosur ju në dijeni se ka pasur
17 shenja rebelimi, po përdor fjalët që pamë në tekst, a ka pasur
18 shenja rebelimi brenda udhëheqjes së UÇK-së gjatë periudhës së
19 Rambujesë?

20 PË. Jo, nuk kam qenë në dijeni për këtë, jo.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shihni në fund të faqes te
22 poshtëshënimet. Unë lexova diçka që e ka burimin në dy burime
23 të ndryshme. Një është procesverbali i mbledhjes së Shtabit të
24 Përgjithshëm të UÇK-së më 27 dhe 28 shkurt të 1999 dhe një
25 burim tjetër është një botim tjetër po i z. Krasniqi. E shihni

1 këtë?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju tregoj diçka
4 tjetër dhe më thoni nëse mund të komentoni lidhur me këtë,
5 bëhet fjalë për provën 1431.

6 Që ta kuptoni, z. Strohmeyer, për kontekst, do të shohim
7 shënimin me shkrim dore të disa takimeve dhe ky dokument,
8 njësoj si dhe dokumenti pararendës, është gjetur në shtëpinë e
9 z. Krasniqi na kanë thënë.

10 Më intereson veçanërisht faqja tjetër.

11 Do ta shihni këtë, ky është një zbardhje e pjesshme, një
12 pasqyrim i pjesshëm i një takimi të Shtabit të Përgjithshëm
13 dhe mban datën 27 shkurt 1999 në Divjakë. E shihni?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndër të tjera, flitet dhe
16 për qëndrimin e Shtabit të Përgjithshëm rreth zgjedhjes së
17 komandantit. Ju lutem shihni shënimin poshtë emrit Fatmir,
18 poshtë emrit Fatmir. E shihni?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Fillimisht, a keni njohur
21 ndonjë person me emrin Fatmir që ka qenë anëtar i Shtabit të
22 Përgjithshëm në ndonjë moment kohor, përfshirë shkurtin në
23 1999?

24 PË. Jo, nuk më kujtohet.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Fatmiri në fjalë thotë:

1 "Propozoj që të krijojmë qeverinë sa më shpejt që të jetë
2 e mundur në mënyrë që të minimizojmë problemet brenda UÇK-së."

3 E shihni këtë?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani unë dua t'ju pyes për
6 këtë: Kur keni folur me z. Thaçi dhe ai jua tregoi këtë
7 organigramën, ua paraqiti këtë organigramën, a u tha ai ju pse
8 ishte e rëndësishme për ta të krijonin një Qeveri të
9 Përkohshme të Kosovës? Të shpjegoi pse, për ç'arsye po e bënë
10 këtë?

11 PË. Sikurse ua thashë, nuk më kujtohen shumë hollësi, por më
12 duket, besoj, se ka qenë për arsye ose për shkak të Rambujesë,
13 po në fakt nuk më kujtohet ndonjë gjë konkrete apo ndonjë
14 deklaratë konkrete në fakt, që të jetë përmendur ndonjë person
15 me emrin Fatmir.

16 Unë gjatë bisedave që kam pasur nuk më kujtohet të kemi
17 folur për formimin e qeverisë si një domosdoshmëri për të
18 mbajtur UÇK-në të bashkuar.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të themi atëherë që
20 z. Thaçi nuk u ka treguar ju cila ka qenë dinamika e brendshme
21 e UÇK-së në atë kohë dhe ata po përpiqeshin t'ju shisnin në
22 një farë mënyre këtë qeveri të përkohshme?

23 PË. Jam i bindur për këtë, po.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim provën materiale
25 P1138. Shohim faqen e fundit.

1 Ju lutem shihni paragrafin në mes të faqes nga gjysma e
2 poshtë thotë:

3 "Qeveri Përkohshme e Kosovës nuk ishte qeveria e formuar
4 nga një parti e vetme ..."

5 Pra:

6 "Qeveria e Përkohshme e Kosovës nuk ishte qeveri e ndonjë
7 partie, para së gjithash ishte qeveri e dalë nga lufta, nga
8 gjaku dhe mbi bazën e një marrëveshjeje dhe ajo kishte aromën
9 e gjakut. Lufta e gjaku ishin faktorët kryesorë që dërguan
10 deri në Rambuje e Paris delegacionin e Kosovës."

11 Më pas, po heq pjesën tjetër dhe thotë:

12 "Pas krijimit të Qeverisë së Përkohshme, drejtimi politik
13 i vendit i kaloi asaj, ndërsa Shtabit të Përgjithshëm i mbeten
14 detyrat operative të veprimit luftarak."

15 Tani unë dua t'ju pyes lidhur me këtë tekst, a përkon
16 kjo, a korrespondon kjo me atë që z. Thaçi dhe z. Çeku janë
17 përpjekur t'ju shesin ju? Pra, ju e keni thënë dhe në
18 përshkrimin tuaj atashimin e tyre me marrëveshjen e Rambujesë
19 edhe për faktin që ju si Kombet e Bashkuara kishit një vijë
20 ndarëse për këtë marrëveshje. A është kjo një përmbledhje e
21 saktë?

22 PË. Edhe një herë, në këtë takim z. Thaçi dhe unë po them që
23 ka qenë perceptimi ynë në atë kohë, ata kishin idenë e tyre
24 për mënyrën sesi do të ishte e ardhmja e tyre edhe do të
25 fokusoheshin në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës. Dhe ne na

1 kishin konsideruar si një organizatë që do t'u ofronte
2 mbështetje atyre. Nuk po them që kishte ndonjë ndjenjë
3 armiqësie ndaj Kombeve të Bashkuara, po në këtë mënyrë e
4 kishin perceptuar ata.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj. Kam dy pyetja të
6 tjera sqaruese për ju. Në fillim: A ju kujtohet që z. Misetić
7 më duket se ju pyeti për takimet që keni marrë ju në takime,
8 pra, ku ka pas të pranishëm komandant të zonave operative? A
9 ju kujtohen këto pyetje?

10 PË. Po, më kujtohen.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pashë procesverbalin që
12 kemi dhe dokumentacionet që kemi, veçanërisht besoj se unë u
13 fokusova në dokumentin që mban numrin 1D212 a 1D212.2. Në këtë
14 takim apo takime ku ju morët pjesë, ku ishin të pranishëm dhe
15 komandantët e zonave, këta të fundit a thanë ndonjë gjë gjatë
16 takimeve? Sepse sipas dokumentit që kam parë unë,
17 procesverbalit që kam parë unë, që ata nuk kanë thënë asgjë.
18 Por në atë takim ka folur vetëm z. Çeku.

19 Pra, pyetja ime është kjo: A përfshiheshin ata në
20 diskutime, të paktën në takimet ku ju keni qenë i pranishëm?

21 PË. Jo, mesa më kujtohet mua. Sidomos takimi i parë që më
22 kujtohet mua shumë mirë, ka qenë në një ambient, në një godinë
23 bosh, madje ka pas dhe një patkua -- tavolinat ishin vendosur
24 në formën e patkoit të kalit. Dhe z. Çeku më takoi mua dhe
25 gjeneralin Jackson jashtë ndërtesës. Biseduam pak jashtë

1 ambientit, jashtë godinës.

2 Dhe, siç ju thashë, kjo ka ndodhur e gjitha -- ka qenë
3 shumë miqësore, shumë konstruktive kjo bisedë. Dhe gjatë
4 bisedës së parë, po dhe gjatë bisedës së dytë kemi qenë vetëm
5 ne të tre që kemi folur. Z. Çeku, z. Jackson edhe unë që
6 kishim rolin kryesor në këtë takim ose më saktë - më falni -
7 z. Çeku dhe z. Jackson ishin personat që flisnin kryesisht dhe
8 ndonjëherë flisja dhe unë kur e gjykoja të nevojshme.

9 Pra, mesa më kujtohet mua vetëm ne të tre kemi folur. Nuk
10 më kujtohet të ketë folur në fakt ndonjë person tjetër në këto
11 takime. Dhe për faktin që nuk më kujtohet do të thotë që mbase
12 këta persona nuk kanë folur edhe e njëjta gjë vlen në fakt
13 edhe për ekipin e z. Jackson apo kolegët e UNMIK-ut që më
14 shoqëronin mua, as ata nuk kanë folur pra.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një pyetje tjetër
16 sqaruese. Kur u larguat nga Kosova në fund të gushtit të 1999-
17 s, mesa kuptoj unë, sipas jush procesi i demilitarizimit të
18 UÇK-së kishte përfunduar në atë fazë apo ishte në vazhdimësi e
19 sipër?

20 PË. Mesa mbaj mend unë, ka qenë ende në vazhdimësi e sipër.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju bëri pyetje z. Dixon
22 lidhur me z. Veseli për veprimet dhe vendndodhjen e z. Kadri
23 Veseli gjatë kohës që keni qenë ju në Kosovë. Ju kujtohen
24 pyetjet?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sipas Rezolutës 1244, a
2 ishte e autorizuar UÇK-ja të vazhdonte të kishte një agjenci
3 informative, agjenci informative?
4 PË. Siç ua thashë dje, që sipas nesh, nuk duhet të kishte
5 asnjë organizatë tjetër që duhet të funksiononte funksione
6 *quasi* apo gjysmë shtetërore, qoftë kjo UÇK-ja apo ndonjë
7 grupim tjetër. Për ne nuk mund të kishte një organizatë tjetër
8 që të ushtronte funksione ekzekutive si arrestime, ndalime,
9 gjykime, procese gjyqësore edhe nuk mund të kishin, nuk mund
10 të ushtronin funksione apo shërbime të një ministrie që
11 përbëjnë një shtet apo një qeveri në kushte normale.

12 Pra, sipas nesh, pa i hyrë në hollësi, vllente dhe për një
13 shërbim informativ, për ne kjo ka qenë e qartë, ky ka qenë
14 qëndrimi ynë, kjo nuk ishte në përputhje me mënyrën sesi e
15 kishim kuptuar ne Rezolutën 1244.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Kaq pyetje
17 kisha.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Ka pyetje nga Prokuroria?

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, kam pyetje, faleminderit.

23 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç:

24 Z. MISETIC: [Përkthim]

25 PY. Mirëmëngjes edhe një herë, z. Strohmeyer.

1 PË. Mirëmëngjes.

2 PY. Kam unë disa pyetje plotësuese në përgjigje të pyetjeve
3 që ju keni dhënë Gjykatësve dje edhe sot.

4 Dje, në një përgjigje të pyetjes nga Gjykatësi Barthe --
5 një çast sa të gjejmë referencën, gjykatësi ju pyeti:

6 "Personalisht a jeni takuar me anëtarë të Qeverisë së
7 Përkohshme të Kosovës të cilët në kohën e takimit nuk ishin
8 anëtarë apo përfaqësues të UÇK-së, po që ishin anëtarë, për
9 shembull, të LDK-së apo të LBD-së dhe që folën në emër të
10 Qeverisë së Përkohshme të Kosovës?"

11 Ju kujtohet pyetja?

12 PË. Po.

13 PY. Dje, më duket dje a pardje, s'jam i sigurtë, ju patë një
14 procesverbal të një takimi të KPI-së ku keni qenë i pranishëm
15 dhe në një moment gjeneral Çeku - dhe për procesverbal është
16 prova 1D212, paragrafi 31, faqja SPOE00000430 - sipas
17 procesverbalit gjeneral Çeku ka thënë që UÇK-ja ka emëruar një
18 ministër drejtësie dhe ai donte që Kombet e Bashkuara të
19 punonin bashkë me këtë ministër drejtësie?

20 PË. Nuk e di. Bëhet fjalë për 22 apo 29?

21 PY. 29.

22 PË. Më kujtohet në mënyrë shumë të mjegullt.

23 PY. Në rregull. Ju ka treguar Gjykatësi Mettraux një provë
24 materiale që mban numrin 1D0007.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të vendoset në ekran.

1 PY. Në ekran, ju lutem, shihni numrin 5, kjo është komunikata
2 që shpall anëtarët e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës. Numri
3 5 është ministri i drejtësisë Hydajet Hyseni nga LBD-ja.

4 A ju kujtohet, meqë keni qenë këshilltar juridik i
5 Kombeve të Bashkuara, a mbani mend ju t'i keni takuar një
6 person që ka qenë ministër i drejtësisë me emrin Hydajet
7 Hyseni?

8 PË. Nuk më kujtohet ta kem takuar këtë person. Edhe një herë,
9 sot nuk e mbaj mend më. Por më duket dhe ta lidh dhe me çfarë
10 kam shpjeguar dhe më herët, ne jemi këshilluar dhe kemi qenë
11 shumë të kujdesshëm për t'u takuar me ministrat e Qeverisë së
12 Përkohshme të Kosovës që ishte vetëstrukturuar që të cilën ne
13 nuk e njihnim në fakt ose e konsideronim që binte ndesh me
14 Rezolutën 1244.

15 Nëse do ta kem takuar këtë person, unë nuk e kam takuar
16 në cilësinë e ministrit të drejtësisë. Por mund ta kem takuar
17 në rrethana të tjera.

18 PY. Thelbi im është ky, UÇK-ja ju ka orientuar të takoheshit
19 me dikë që ka qenë anëtar i LBD-së, tjetër gjë është pastaj në
20 qoftë se Kombet e Bashkuara nuk donin të takoheshin me të
21 sepse nuk njihnin këto poste zyrtare?

22 PË. Nuk e kam tekstin përpara të datës 29 qershor, por për
23 mua nuk ka rëndësi emri dhe përkatësia partiake, por për
24 faktin që ishte emëruar një ministër drejtësie. Pra, ju thashë
25 edhe një herë, unë nuk e kam pasur shumë të qartë se cilat

1 parti apo cilët persona kanë qenë pjesë e qeverisë së asaj
2 kohe.

3 PY. Në fakt do flas për një pyetje tjetër. Ishte pyetja që
4 jua bëri Gjykatësi Barthe dje dhe ju thatë:

5 "Për ne, nuk ka pasur vazhdimësi, vijimësi të Rambujesë
6 që krijoi 1244 dhe zhvillimet e mëpasshme. Për ne, 1244 ishte
7 ajo që e ndryshoi të gjithë lojën. Për ne nëse shtetet anëtare
8 donin që vendimi i Rambujesë të materializohej, atëherë do të
9 kishin bërë një rezolutë tjetër, që në fakt nuk e bënë ..."

10 E kujtoni përgjigjen që dhatë dje?

11 PË. Po.

12 PY. Mirë atëherë. Shohim 1244.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, do të doja të vendosnim
14 në ekran 1D78.

15 PY. Ju bëri dhe një pyetje Gjykatësi Mettraux për
16 ligjshmërinë e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës që lidhet po
17 me dokumentin që do shohim në ekran.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Është në listën e Prokurorisë, ju
19 lutem.

20 Kjo është Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të
21 Kombeve të Bashkuara. Shkojmë në faqen 3, pika 11.

22 PY. Këshilli i Sigurimit:

23 "Vendos që përgjegjësitë kryesore të pranisë civile
24 ndërkombëtare të përfshinin:

25 "(a) Promovimin e krijimit derisa të merrej një vendim

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 24

1 përfundimtar të një autonomie substanciale dhe vetëqeverisje
2 në Kosovë, që merr parasysh tërësisht Shtojcën 2 dhe kushtet e
3 Rambujesë ...”

4 Shkojmë në faqen tjetër:

5 “(e) Të lehtësojë procesin politik që synon të përcaktojë
6 statusin e ardhshëm të Kosovës duke marrë parasysh kushtet e
7 Rambujesë ...”

8 Ua lexova dhe paragrafin e mëhershëm që thoshte në këtë
9 marrëveshje që dhe prania ndërkombëtare duhet të marrë
10 parasysh Shtojcën 2.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim faqen 6 të dokumentit që
12 është Shtojca 2, shkojmë në fund të paragrafit 8 të Shtojcës
13 2.

14 PY. “Procesi politik për krijimin e një kornize të ndërmjetme
15 politike për krijimin e një vetëqeverisje thelbësore për
16 Kosovën, duke marrë parasysh tërësisht kushtet e Rambujesë dhe
17 parimet e sovranitetit dhe të integritetit territorial të
18 Republikës Federale të Jugosllavisë edhe vendet në rajon dhe
19 demilitarizimin e UÇK-së.”

20 Tani, propozimi i parë për ju, z. Strohmeier, është kjo
21 që në fakt në kundërshtim me atë që po thoni ju, Këshilli i
22 Sigurimit në terren ju detyronte ju të merrnit parasysh
23 kushtet e Rambujesë sepse ju ishit prani ndërkombëtare, po?
24 PË. Jo, nuk është e saktë kjo, z. Avokat. Këshilli i
25 Sigurimit na merrte ne parasysh, sigurisht, na merrnin

1 parasysh Rambujenë në tërësinë e vet, po jo kushtet e

2 Rambujesë.

3 PY. Jo, po nuk jua bëra këtë pyetje. Ju thashë të merrnit

4 parasysh kushtet e Rambujesë, apo jo?

5 Dje ju tregova dhe një kabllogram ku është diskutuar edhe
6 përbërja e Këshillit Tranzitor të Kosovës ku do të kishte
7 përfaqësues - më falni - Përfaqësuesit e Posaçëm të Sekretarit
8 të Përgjithshëm kishin vendosur që formula për përbërjen e
9 shqiptarëve të Kosovës do të bazohej në vendimet që do të
10 merrte qeveria provizore e Kosovës në Rambuje.

11 Pra, në thelb, SRSG-ja, në fakt, po merrte parasysh
12 marrëveshjen për qeverinë provizore që do të krijohet dhe ka
13 qenë detyrim për ta bërë këtë sipas Rezolutës 1244, apo jo?

14 PË. Absolutisht po.

15 PY. Domethënë, e kuptoj që nuk është kaq bardhë e zi kjo
16 situatë sa i takon kushteve të Rambujesë që do të zbatoheshin
17 dhe që nuk do të zbatoheshin dhe se si do të bashkëpunonte
18 prania ndërkombëtare me apo sesi do të ndërliqej kjo me
19 kushtet e Rambujesë. A pajtoheni ju me mua?

20 PË. Nuk pajtohem domosdoshmërisht me këtë që thatë ju.

21 Unë mendoj që KTK-ja ka qenë në fakt pikërisht reflektimi
22 i kësaj që ne e kemi marrë parasysh. Po rezoluta sidomos në
23 paragrafin 11 e bën shumë të qartë detyrat që kishim ne, një
24 dhe formulimi i paragrafit 11 nuk thotë në vetvete që duhet të
25 bazoheshim ne në kornizën institucionale që ishte përgatitur

1 në Rambuje.

2 E dyta, në të njëjtin paragraf që më lexuat ju, thuhet që
3 të merret parasysh integriteti dhe sovraniteti i Republikës
4 Federale të Jugosllavisë dhe unë ju thashë që një nga pikat
5 kryesore ka qenë që cilat ligje do të zbatoheshin dhe në atë
6 kohë, konsiderohej ende pjesë e Serbisë, por thjesht nën
7 administrimin ndërkombëtar dhe nuk mund të pranohej kaq
8 thjesht një qeveri e ndarë apo paralele për Kosovën që ishte
9 vendosur në Rambuje.

10 Po të gjitha implikimet politike, sigurisht, duhet të
11 merreshin parasysh, të mbaheshin parasysh, siç e përmendët dhe
12 ju dhe SRSG-ja, në fakt, i mori parasysh.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë një faqe më përpara në
14 dokument, ju lutem. Dhe shohim paragrafin 8.

15 PY. Këshilli i Sigurisë thotë këto që ju duhet të ndërmerrenit
16 "procesin politik për krijimin e një kornize politike të
17 ndërmjetme që të ndihmonte vetëqeverisjen e Kosovës dhe që do
18 merrte parasysh kushtet e Rambujesë dhe parimet e sovranitetit
19 ..." e kështu me radhë.

20 Pra, çfarë thuhet këtu, thuhet që në këtë periudhë të
21 ndërmjetme përpara se të gjendet një zgjidhje përfundimtare
22 për statusin e Kosovës, ju duhet të ofronit një kornizë
23 politike të ndërmjetme e cila do të merrte parasysh kushtet që
24 ishin dakordësuar në marrëveshjen e Rambujesë, apo jo?

25 PË. Thotë "kornizë politike të ndërmjetme që merr parasysh

1 kushtet e Rambujesë dhe parimin e sovranitetit dhe
2 integritetit territorial të Republikës Federale të
3 Jugosllavisë ... " e kështu me radhë.

4 Pra, është çështje interpretimi.

5 PY. Ju jeni jurist dhe jeni gjykatës edhe ndodh që një
6 dokument e lexojnë dy avokatë dhe bëjnë një interpretim të
7 ndryshëm, apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Atëherë ne i pamë dispozitat bashkë, mbase ju i keni
10 interpretuar ndryshe atëherë dispozitat e rezolutës nga UÇK-ja
11 apo nga Qeveri Përkohshme e Kosovës, mbase sipas interpretimit
12 të tyre marrëveshja e Rambujesë për krijimin e Qeverisë së
13 Përkohshme të Kosovës ishte e ligjshme, ishte pjesë e procesit
14 dhe ishte integruar në Rezolutën 1244. Kjo është një çështje
15 interpretimi, domethënë dhe ju mund të jepni interpretimin
16 tuaj për këtë.

17 PË. Ua thashë, që në takimet e para kemi shprehur qëndrimin
18 tonë. Dhe ua kemi shpjeguar sepse krijimi i institucioneve dhe
19 veprime të tilla binin ndesh me mënyrën se si interpretonim ne
20 Rezolutën 1244, që në atë kohë mbështetej gjerësisht nga
21 Kombet e Bashkuara, përfshirë Këshillin e Sigurimit.

22 PY. Po gjatë kohës që ju bënit këto konsultime në të njëjtën
23 kohë UÇK-ja atëherë vetë filloi të bënte tranzicionin dhe të
24 kthehej në KTK, apo jo?

25 PË. Po. E kam thënë disa herë gjatë dëshmisë sime që ata po

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeyer (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 28

1 pajtoheshin me faktin që nuk do të kishin dot një Qeveri të
2 Përkohshme të Kosovës por në vend të Qeverisë së Përkohshme të
3 Kosovës qendra politike do të ishte KTK-ja.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Po shoh kohën.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
6 bëjmë dhjetë minuta pushim.

7 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë
9 minuta pushim.

10 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

11 --- Seanca rifillon në orën 10.11

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I lutem
13 Sekretares ta sjellë dëshmitarin në sallë.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
16 Mund të vazhdoni, z. Misetiç.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

18 PY. Z. Strohmeyer, dje Gjykatësi Barthe ju pyeti:

19 "... a ju kujtohet FARK-u ose sjellja e anëtarëve të
20 FARK-ut si një arsye, jo si arsye kryesore, por si një arsye
21 për shqetësimet të lidhura me sigurinë në Kosovë."

22 A ju kujtohet kjo pyetje, Dëshmitar?

23 PË. Nuk më kujtohet ekzaktësisht formulimi, domethënë, e di
24 që më bënë një pyetje lidhur me FARK-un po formulimi ekzakt i
25 pyetjes nuk më kujtohet.

1 PY. A e dini në qoftë se FARK-u ka veshur uniforma të UÇK-së?

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] E kundërshtoj, shkojnë përtej
3 fushës së veprimit të pyetjeve.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Askush nuk e
5 përmendi, ose jo, kam përshtypjen që kolegu e përmendi FARK-
6 un.

7 Rrëzohet kundërshtimi. Mund të vazhdoni.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund ta përsërisni dhe një herë
9 pyetjen, Avokat?

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. A ju kujtohet në qoftë se FARK-u ka veshur uniformat e
12 veta apo ka veshur uniformat e UÇK-së?

13 PË. Nuk më kujtohet.

14 PY. Në qoftë se anëtarët e FARK-ut do kenë veshur uniforma të
15 UÇK-së, a do keni qenë në gjendje juve të bënit dallimin në
16 qoftë se ata ishin ushtarë të FARK-ut apo të UÇK-së?

17 PË. Jo, personalisht nuk kisha qenë në gjendje të bëja
18 dallimin.

19 PY. Dje në faqen 153 apo 152 të transkriptit ju është bërë
20 një pyetje dhe pyetja është si më poshtë.

21 "PY. Në paragrafin 92 të deklaratës tuaj regjistrohet
22 ose ju keni thënë që z. Thaçi 'premtoi të bënte çfarë mundej,
23 përfshirë këtu edhe nxjerrjen e deklaratave zyrtare për të
24 shpërbërë ose për të mbyllur qendrat e ndalimit të UÇK-së'." A
25 është e saktë? Ju kujtohet?

1 Ju thoni:

2 "Po."

3 Tani kjo lidhet me një kabllogram që ju e keni parë. Ju
4 kujtohet kjo?

5 PË. Po.

6 PY. Informacioni në këtë kabllogram -- më lejoni një moment
7 ju lutem.

8 [Mbrojtja këshillohet]

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Do kërkoj që të paraqitet një
10 tjetër dokument atëherë. Dokumenti është SITF00172903 deri në
11 0017294. Është në listën e re të dokumenteve.

12 PY. A e shikoni është një kabllogram që mban datën 13 korrik
13 1999.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja e dytë e
15 këtij dokumenti.

16 PY. Incidenti për të cilin është informuar z. Thaçi kishte të
17 bënte me serbë dhe romë që po liroheshin në një qendër ndalimi
18 në afërsi të Prishtinës. Në qoftë se do shikojmë nëntitullin
19 "Aspektet ushtarake" në këtë dokument, këtu thuhet që:

20 "KFOR-i me kërkesën e UNMIK-ut është përpjekur që të
21 gjejë pesë vende ku UÇK-ja pretendohet që të mbajë të burgosur
22 të ndaluar. Tre vende nuk mund të gjendeshin për mungesë
23 informacioni. Megjithatë në një vend u gjendën trupa të cilët
24 kanë qenë aty prej të paktën dy javë. Në një vend të pestë në
25 Prishtinë u gjetën tre serbë, katër magjypë, si dhe persona të

1 tjerë. Personat që i kanë ndaluar ata nuk kanë qenë në
2 uniformë, nuk kanë qenë të veshur në uniformë dhe i kanë
3 liruar të ndaluarit të cilët nuk kanë dëshmuar kundër tyre.”

4 A ju kujtohet që personat që i kanë ndaluar këta persona
5 nuk kanë qenë të veshur me uniformë, Dëshmitar?

6 PË. Jo, nuk më kujtohet.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkojmë që të pranohet në prova
8 ky dokument.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
10 kundërshtim?

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, kundërshtojmë sepse
12 dëshmitari nuk komentoj asgjë lidhur me përmbajtjen e këtij
13 dokumenti.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vendimi që
15 merret është që dokumenti do pranohet në prova gjyqësore.
16 Dokumenti është SITF00172903 deri në 00172904.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
18 Gjykatës. Dokumenti do të marrë numrin e provës 1D00242 dhe
19 klasifikohet si konfidencial.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

21 PY. Të flasim për pyetjet të cilat ju janë bërë nga Gjykatësi
22 Gaynor. Bëhet fjalë për pyetjen që ju bëri Gjykatësi Gaynor
23 për komandantin e UÇK-së. I thatë Gjykatësi Gaynor në
24 transkript në faqen 159 që ishit befasuar që z. Thaçi
25 nënshkroi angazhimin ose marrëveshjen në emër të komandantit

1 të UÇK-së, a është e saktë kjo?

2 PË. Po.

3 PY. Po pse u befasuat juve?

4 PË. Sikurse e thashë dhe sot në mëngjes, për neve ose të
5 paktën për mua personalisht, por mendoj që për të gjithë ne në
6 aspektin civil, ne e shikonim z. Thaçi si udhëheqësin politik
7 me të cilin ndërvepronim. Për mua personalisht, sikurse e kam
8 thënë dhe më herët gjatë dëshmisë, z. Çeku ishte personi që
9 ishte përgjegjës për çështje operative. Kështu që kur pashë që
10 jo që z. Thaçi e kishte nënshkruar si marrëveshje ose si
11 dokument, nuk është se u befasova për këtë, por për faktin që
12 ai e kishte nënshkruar si komandant, për këtë, kjo më bëri
13 përshtypje sepse prisja që të ishte dikush tjetër që ta
14 nënshkruante, ndërkohë z. Thaçi e konsideroja si udhëheqës
15 politik, pra, të ushtronte funksione të udhëheqjes politike.
16 Kjo është arsyeja që pse unë u ndjeva si i habitur ose i
17 befasuar.

18 Megjithatë sikur dhe e kam shpjeguar dhe sot paradite, ka
19 pasur një perspektivë specifike ose një lloj avantazhi në atë
20 kohë që ka qenë i ndryshëm ose perspektiva ime, si me thënë,
21 ka qenë diçka e ndryshme nga gjenerali Jackson ose mbase edhe
22 nga SRSG-ja.

23 PY. A do ishte e drejtë që të thuhej që befasia juaj ishte
24 për shkak të faktit që ju kishit pasur përvojë me z. Thaçi dhe
25 përvoja me z. Thaçi nuk ju sugjeronte që ai kishte funksion

1 politik që nuk luante ndonjë rol politik?

2 PË. Unë nuk kam ndërvepruar me të në atë mënyrë, pra, nuk kam
3 bërë diskutime politike me të që në fillim. Unë nuk ka arritur
4 në përfundimin që për shkak të ndërveprimeve ose bisedave që
5 kam pas me z. Thaçi mund të ishte e mundur për të që roli i
6 tij të ishte në fushën ushtarake.

7 PY. Keni thënë në transkript në faqen 160 të transkriptit të
8 përkohshëm të ditës së djeshme se z. Çeku nuk ju ka thënë
9 asnjëherë në takimet e KIP-së se ju duhet që të kontrolloni
10 informacionin me z. Thaçi, a është e saktë kjo?

11 PË. Është e saktë.

12 PY. Ai asnjëherë nuk ju ka thënë që ju duhet që t'i
13 konfirmoni aspektet e ndryshme që ju diskutoni me të me z.
14 Thaçi, apo jo?

15 PË. Jo, nuk më kujtohet që të ketë ndodhur kjo.

16 PY. Pyetja e fundit ka të bëjë me një pyetje që ju bëri
17 Gjykatësi Mettraux lidhur me informacionin që mund të keni
18 pasur, ose jo, lidhur me emërimin e gjeneralit Çeku që mund të
19 tregonte se mbi kishte autoritet ose kompetenca ai.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do i lutesha Sekretarisë
21 që të paraqesë në ekran dokumentin DHT04009 deri në DHT04017-
22 ET. Versioni në shqip ka numrin SPOE00053060 deri në 00053071.

23 PY. Teksti është një intervistë me Agim Çekun. Ai aty
24 diskuton sesi është emëruar shef i Shtabit të Përgjithshëm.
25 Ndërkohë që Zëri është një gazetë në Kosovë. Dhe pyetja që i

1 bëhet atij është si më poshtë:

2 "Procedura për emërimin tuaj si shef i Shtabit të
3 Përgjithshëm në UÇK është bërë në Kosovë apo është bërë më
4 herët?

5 Z. Çeku përgjigjet --"

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë po presim për
7 shqipen ndërkohë që vazhdojmë me intervistën. Është në faqen
8 68 në versionin në shqip.

9 PY. Do t'jua lexoj dhe një herë tjetër. Pyetja që i bëhet z.
10 Çeku është:

11 "Procedura për zgjedhjen tuaj si shef i Shtabit të
12 Përgjithshëm të UÇK-së është bërë në Kosovë apo më herët?"

13 Z. Çeku përgjigjet:

14 "Gjatë kontakteve që kishim, është përmendur një gjë e
15 tillë. Kishte tendenca që unë të angazhohesha në një post
16 drejtues edhe pa qenë në Kosovë. Por këtë nuk e kam pranuar.
17 Edhe aktiviteti im kurrë nuk ka qenë publik. Për të dinte
18 vetëm një rreth shumë i ngushtë. Nuk doja që këtë ta bëja
19 publike se jam në kontakt me UÇK-në e të qëndroja jashtë
20 Kosovës. Kam insistuar që vendimet për angazhimin tim konkret
21 të merren në Kosovë. Pastaj disa ditë kemi qëndruar në Shtabin
22 e Përgjithshëm dhe është diskutuar puna ime gjërë e gjatë dhe
23 vendimi që unë të emërohesha shef i Shtabit të Përgjithshëm të
24 UÇK-së është bërë nga i gjithë Shtabi i Përgjithshëm jo nga
25 një person i vetëm."

1 Në bisedat që keni pasur me gjeneral Çekun, a ju kujtohet
2 në qoftë se ai ju ka informuar ju lidhur me këtë, domethënë,
3 që ai është emëruar nga një organ i tërë, pra, nga të gjithë
4 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm jo nga një person i vetëm?
5 PË. Nuk më kujtohet në qoftë se më ka thënë apo jo që është
6 emëruar nga i gjithë Shtabi i Përgjithshëm. Por tani duke e
7 lexuar këtë paragraf, më erdhën në mendje disa prej këtyre
8 gjërave, më kujtohet që në një prej bisedave që kam pasur me
9 të, ai më ka thënë që nuk ka qenë gjithmonë në Kosovë e kështu
10 me radhë dhe kemi biseduar për gjëra të tjera të lidhura, pra,
11 të kësaj natyre, megjithatë mesa kam dijeni unë nuk kam
12 biseduar me të lidhur me proceset e brendshme të UÇK-së.

13 Në përgjithësi, unë personalisht, nuk kujtoj dhe nuk
14 besoj, domethënë, që të kemi pasur ndonjë bisedë me z. Çeku
15 ose me ndokënd tjetër që ka të bëjë me strukturat e brendshme
16 të komandimit dhe të kontrollit të UÇK-së. Përfundimet e
17 nxjerra prej meje ose prej nesh, mbështeteshin te bisedat e
18 ndërveprimet që kemi patur ose te informacioni që ne kemi
19 ndarë me njeri-tjetrin.

20 Megjithatë, tani, 25 vite më pas, nuk mund të përjashtoj
21 me siguri që mbase në një moment und të kem dëgjuar lidhur me
22 aspekte të emërimit ose kush është emëruar në çfarë,
23 megjithatë për momentin nuk më kujtohet asnjë gjë lidhur me
24 këtë.

25 PY. Ky emërim a do ishte në përputhje me mënyrën se si e keni

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 36

1 kuptuar ju që z. Çeku ka vepruar në aspektin ushtarakë të UÇK-
2 së ndërkohë që z. Thaçi ka vepruar në aspektin politik?
3 PË. Këtë e thashë dhe më përpara, këtë lloj përshtypje kishim
4 dhe ne.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj që ky
6 dokument edhe ballina, domethënë, kjo faqe përkatëse e
7 dokumentit dhe ballina të pranohen në prova gjyqësore.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Faqja e parë që është ballina
10 është DHT04009 dhe ndërkohë që faqja që pamë të gjithë është
11 DHT04013 në anglisht dhe në shqip ballina është SPOE00053060
12 në faqen SPOE00053068.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
14 kundërshtime?

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
17 DHT04009 dhe 04013 në shqip dhe anglisht pranohen në prova
18 gjyqësore.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Këto dy
20 faqe në anglisht dhe faqet përkuese në shqip do të marrin
21 numrin e provës 1D00243 dhe klasifikimi është konfidencial.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetiç, kam një pyetje
23 për ju unë, në qoftë se më lejoni. Ju nuk po propozoni që t'i
24 tregoni dëshmitarit dekretin e 28 prillit 1999 në këtë pikë,
25 apo jo?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, jo. Unë preferoj më tepër që
2 të mbështetem tek intervista që ka dhënë vetë z. Çeku.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Më thonë kolegët që artikulli
5 është publik, kështu që për këtë arsye duhet të klasifikohet
6 si publik.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
8 kundërshtim. Mund të klasifikohet si publik.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.
10 PY. Faleminderit, z. Strohmeier, faleminderit që ishit me ne
11 për tre ditë dhe faleminderit për kohën dhe përgjigjet e dhëna
12 ndaj pyetjeve tona.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon,
14 keni ju pyetje.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Po, faleminderit, të nderuar
16 Gjykatës.

17 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon:

18 Z. DIXON: [Përkthim]

19 PY. Z. Strohmeier, kam disa pyetje, pak pyetje të tjera
20 plotësuese. Së pari, kam një pyetje lidhur me një pyetje të
21 bërë nga Gjykatësi Mettraux dhe më konkretisht pyetja është si
22 më poshtë:

23 "Tani, sipas Rezolutës 1244, UÇK-ja a ishte autorizuar që
24 të kishte një institucion informativ apo një agjenci
25 informative?"

1 Dhe ju shpjeguat që nuk duhet të kishte asnjë institucion
2 që kishte funksione *quasi* shtetërore ose thujse shtetërore.

3 A mund të na e shpjegoni pak më tepër këtë përgjigje që
4 dhatë që kjo rezolutë, siç e dinë të gjithë, nuk është se e
5 ndalon krijimin e një shërbimi informativ civil kombëtar që të
6 lidhej si me shërbimet e brendshme në Kosovë po gjithashtu
7 edhe me shërbimet si motra në vende të tjera jashtë Kosove?
8 Ata mund të vazhdonin që të bashkëpunonin dhe të kishin
9 kontakte, të ndanin informacion. A është kështu, apo jo?

10 PË. E keni fjalën për shërbimet ndërkombëtare të shteteve
11 anëtare?

12 PY. Po, me personat që ishin në Kosovë dhe ishin të përfshirë
13 në sektor. Domethënë, pak a shumë në të njëjtën mënyrë që ju
14 keni bërë ndërlidhjen me aspektin ose anën civile me ata në
15 Kosovë ose agjencitë ndërkombëtare informative, domethënë, nuk
16 është se kishte ndonjë pengesë lidhur me këtë, apo jo,
17 Dëshmitar?

18 PË. E keni fjalën për t'u angazhuar ose për t'u përfshirë me
19 individë në Kosovë?

20 PY. Po.

21 PË. Jo, jo.

22 PY. Nuk ka asgjë në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të
23 Kombeve të Bashkuara që të ndodheshin ose të zhvilloheshin
24 trajnime. Në fakt, ky ishte synimi. Synimi ishte që të
25 ofroheshin trajnime në mënyrë të tillë që të ndërtoheshin

1 kapacitetet për të ardhmen. Pra, duke fol këtu konkretisht për
2 sektorin e informimit. Pra, kjo është diçka e cila ndodh në të
3 gjithë sektorët dhe në sektorin civil dhe në atë ushtarak.
4 PË. Për mua është një përfundim i ndryshëm, z. Avokat. Dua të
5 them trajnimi, për sa i takon kuadrit institucional sigurisht
6 që angazhimi me individë për sa i takon informacionit ose
7 konstatimeve është një histori e ndryshme. Gjithsesi,
8 domethënë, secili funksionon në atë fushën e vet dhe gjithsesi
9 për sa i takon angazhimit me individë duhet që të
10 identifikoheshin individët për të kryer një funksion ose për
11 të pasur një autoritet të caktuar.

12 Do kisha qenë shumë i befasuar që trajnimi për sa i takon
13 krijimit të një shërbimi inteligjent ose informative të kryhej
14 jashtë kornizës së Rezolutës 1244.

15 PY. E kuptoj atë se çfarë po thoni, po pyetja ime është paksa
16 ndryshe. Unë po them që Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të
17 Kombeve të Bashkuara nuk e përjashtonte procesin për krijimin
18 e organeve të përkohshme në të ardhmen. Në fakt, formulimi ose
19 gjuha e përdorur nga rezoluta është ekzaktësisht kjo që po
20 përdor unë. Domethënë, ideja ishte që të trajnoheshin apo të
21 ndihmoheshin personat në Kosovë në mënyrë të tillë që të
22 krijoheshin organe të përkohshme dhe pastaj të bëhej kalimi i
23 kompetencave në të ardhmen pasi të ndërtoheshin kapacitetet.

24 PË. Po përmes UNMIK-ut dhe përmes një procesi transparent ose
25 një procesi. Në qoftë se ka pasur një proces nga UNMIK-u për

1 sa i takon krijimit të një shërbimi informativ kosovar,
2 sigurisht, duhet që të kishte trajnime për mbështetjen e
3 personave dhe për arritjen e këtij objektiv.
4 PY. Rezoluta në vetvete nuk ishte për të parandaluar një
5 proces të tillë, apo jo, në fakt ishte për të lehtësuar
6 krijimin e institucioneve me kalimin e kohës, pra, krijimet e
7 institucioneve të përkohshme fillimisht edhe pastaj të
8 institucioneve përfundimtare, kështu ka qenë, apo jo,
9 Dëshmitar?

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] E kundërshtojmë, u bë kjo pyetje
11 dhe mori përgjigjen.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
13 kundërshtimi.

14 Ju lutem përgjigjuni pyetjes.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Rezoluta e Këshillit të Sigurimit
16 nuk sugjeron ndonjë krijim institucional ose në struktura
17 institucionale konkrete. Në këtë rezolutë nuk thuhet që duhet
18 që krijohen këto lloje të caktuara institucionesh ose lloje të
19 tjera institucionesh. Kështu që mendoj që në fazën e
20 përkohshme, pra, në fazë tranzitore e thënë ndryshe, ne ishim
21 përgjegjës për të bërë administrimin. Dhe ne kishim rënë
22 dakord dhe negociu për formimin e një shërbimi ose një
23 institucioni apo një organi që ishte i pranueshëm për ne.

24 Pra, diskutimi nuk ka të bëjë në qoftë se në rezolutën e
25 Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara është thënë

1 shprehimisht, apo jo, ose lejohej ose pengohej krijimi i
2 shërbimit informativ. Por duhej që të kishte procese të cilat
3 do duhet të shikoheshin në kornizën e kryerjen e punëve më
4 pas.

5 PY. Këtë pyetje kam edhe unë. Domethënë, kjo është pyetja
6 ime. Domethënë, situata ishte e tillë që ishte e mundur që të
7 krijoheshin institucione të tilla. Besoj që edhe ju pajtoheni
8 me mua lidhur me këtë?

9 PË. Jo, nuk pajtohem. Nuk ishte qëllimi kryesor që të
10 inkurajohej ose kur dua të them, domethënë, ishte UNMIK-u
11 përgjegjësi që të mund të vazhdohej me një proces të tillë të
12 ndërtimit të institucioneve.

13 PY. Nuk po thoja të njëjtën gjë.

14 PË. Jo, unë po them dhe një herë tjetër që UNMIK-u nuk po
15 merrej me krijimin dhe me zhvillimin e shërbimit informativ,
16 për rrjedhojë, ishte në rregull që të mos përjashtohej dikush
17 nga bërja e një gjëje të tillë. Do thoja që kjo nuk është në
18 përputhje me mënyrën sesi e kemi kuptuar ne Rezolutën 1244.

19 PY. Këtë e kuptoj. Megjithatë argumenti im është që në
20 kuadrin e rezolutës të institucioneve ndërkombëtare, në
21 veçanti UNMIK-ut, shtetet anëtare të Asamblesë së Përgjithshme
22 do të mbikëqyrnin procesin e lëvizjes drejt institucioneve të
23 përkohshme me kalimin e kohës. Jo se kjo do bëhej veçmas
24 përmes një procesi që nuk ishte nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut?

25 PË. Shtetet anëtare e kanë mbikëqyrur përmes Këshillit të

1 Sigurimit dhe shtetet anëtare kanë kontribuar drejt këtij
2 qëllimi. Tani edhe një herë nuk e kam shumë të qartë se për
3 çfarë po pyesni dhe cili është qëllimi i pyetjes tuaj.

4 Megjithatë edhe në qoftë se shtetet anëtare
5 individualisht do kishin ndjerë nevojën që duhej që të
6 ndihmonim dhe të mbështesnim ne për krijimin e aftësive ose
7 kapaciteteve të shërbimit informativ brenda Kosovës, të paktën
8 sipas këndvështrimit tim, kjo do të kishte qenë në
9 pajtueshmëri vetëm me shtetet anëtare përkatëse dhe duhej që
10 të ishte e rëndësishme që sikurse kishim rënë dakord, pra, i
11 gjithë procesi të mund të mbikëqyrej nga UNMIK-u dhe e gjithë
12 gjëja të bëhej nën ombrellën ose nën mbikëqyrjen e Rezolutës
13 1244.

14 PY. Domethënë, ky është thelbi i pyetjes sime, në fakt është
15 një proces për të cilin ishte rënë dakord. Ishte një proces i
16 cili po ndodhte. Sepse sikur ta dini, këto ishin procese të
17 cilat mund të shikohen si pjesë e kuadrit të përgjithshëm të
18 fazës tranzitore.

19 PË. Nuk jam i sigurtë që jam dakord me këtë se në pjesën e
20 fundit të përfundimit tuaj sepse nuk ishte e ndaluar. Por se
21 si nuk ishte e ndaluar ajo -- ndoshta nuk e kuptoj pyetjen
22 tuaj. Por ju po i referoheni një vendi anëtar sepse nuk ishte
23 shprehimisht e ndaluar kjo gjë që apo një grupi vendas
24 anëtare që mund të thjesht të shkonin ta ndihmonin në
25 zhvillimin e marrëdhënieve të tyre për asetet, kapacitetet,

1 mundësitë brenda Kosovës dhe unë do të thoja që kjo nuk është
2 në përputhje me Rezolutën 1244.

3 PY. Dhe, në fakt, ju nuk e dini nëse njëri nga ato procese
4 është zhvilluar apo në qoftë se ka ndodhur?

5 PË. Siç e thashë më parë, nuk më kujtohet një gjë e tillë

6 PY. Dhe mendoj që pajtohem me faktin që rezoluta nuk e bën
7 shumë të qartë që ju jeni përgjegjës për procesin tranzitor.
8 Pra, ju thatë dje që kjo ishte -- nuk kishte precedentë të
9 tillë në këtë nivel ekzekutiv. Pra, nuk ka mospajtim sa i
10 takon përmbajtjes së rezolutës.

11 Pra, ajo që dua të them është që në këtë kontekst që ia
12 ka procesi që zhvillohen dhe kjo ka ndodhur në anën civile,
13 për sa i përket pjesës civile, ushtarake dhe anës së
14 inteligjencës për të ndërtuar, pra, strukturat e përkohshme në
15 të ardhmen, provizore, që pastaj do të bëheshin përfundimtare.
16 Kjo ishte përmbajtja e rezolutës, apo jo?

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Është bërë pyetja dhe përgjigjur.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
19 kundërshtimi. Është bërë kjo dhe ai është përgjigjur tre herë.

20 Është përgjigjur duke mohuar këtë.

21 Z. DIXON: [Përkthim]

22 PY. Mund të pajtohem që roli juaj në pjesën civile,
23 sigurisht, nuk do të ishte aty për gjithmonë? Ju ishit aty për
24 të mundësuar krijimin e proceseve të përkohshme që të
25 zhvillohen pastaj në vend me kalimin e kohës?

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtim.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

3 Përgjigjuni pyetjes.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Z. Avokat, roli jonë mendoj që
5 ishte rol tranzitor. Pra, na ishte bërë e qartë që ne ishim
6 aty për të krijuar kornizën, institucionet dhe kështu me
7 radhë, për të zhvilluar institucionet, natyrisht me idetë dhe
8 propozimet e realitetit në Kosovë që do të ishte natyrisht
9 duke punuar me vendet anëtare, Bashkimin Evropian, organizata
10 ndërkombëtare për ta bërë këtë të mundur.

11 Nuk mendoj që e kishim një ide të sigurtë në fillim se sa
12 do zgjaste ky tranzicion dhe nuk është që ne mendonim që po
13 bëjmë këtë dhe pas gjashtë muajsh ata do të marrin përsipër,
14 vendorët do marrin përsipër këtë proces. Gjerat do merrnin
15 shumë vite, ishte proces që do zgjaste me vite, nuk e kam
16 fjalën këtu për një ose dy vite e kam fjalën një afat më të
17 gjatë, proces më afatgjatë.

18 PY. Do t'i vij periudhës kohore më vonë, por kam edhe një
19 pyetje lidhur me pyetjen e bërë nga Gjykatësi Mettraux. Juve
20 ju bënë shumë pyetje lidhur me vendimet e Shtabit të
21 Përgjithshëm në atë kohë, pra.

22 Ju qartësuat më duket që nuk kishit informacion të saktë
23 se kush ishte i përfshirë në këto vendime dhe si janë arritur
24 këto vendime?

25 PË. Ju e keni fjalën për vendimet e brendshme të UÇK-së?

1 PY. Po.

2 PË. Jo, nuk kam dijeni.

3 PY. Dhe nuk keni informacion ju vetë se si njerëzit në
4 Shtabin e Përgjithshëm apo rreth tyre komunikonin me njëri-
5 tjetrin në atë kohë lidhur me vendimet mbi këto çështje?

6 PË. Jo, ndonjë gjë që është ndarë apo bashkëndarë apo
7 komunikuar neve nga bashkëbiseduesit tanë, por nuk kam patur
8 ndonjë njohuri të hollësishme për strukturat e komunikimit dhe
9 hierarkinë përveç atyre që na janë prezantuar vetë. Dhe
10 përshtypjet që kemi patur përmes ndërveprimeve të tyre.

11 PY. Do t'i kthehem pyetjeve të bëra nga Gjykatësi Barthe në
12 faqen 144, rreshti 7, juve ju bënë pyetje për procesin e
13 pretenduar të organizuar të shkeljeve të drejtave të njeriut
14 ku u përqendruam dhe ju u përgjigjët në faqen 148. Dhe thatë
15 që nuk ishte domosdoshmërisht politikë e deklaruar, por ishte
16 një ambient që favorizonte këtë gjë.

17 Pastaj juve ju bënë pyetje lidhur me aktorë jo shtetëror,
18 pra dhe u përgjigjët në një pjesë të përgjigjes tuaj që UÇK-ja
19 ishte e vetmja atje që përpiqej të krijonte struktura
20 paralele.

21 Ju kujtohen këto përgjigje?

22 PË. Po.

23 PY. Tani disa pyetje që burojnë nga kjo.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Do të doja të shfaqnim në ekran

25 SITF40009162 deri në 163.

1 PY. Kjo është një intervistë e bërë me kreun e misionit, z.
2 Daan Everts, nga OSBE-ja në qershor, fund të qershorit kur ju
3 ishit aty. Kjo ishte pak përpara që ai të merrte funksionet e
4 tija. E shikoni këtë?

5 PË. Po.

6 PY. Titulli aty është: "Lufta kundër ndjenjës së hakmarrjes"
7 dhe pastaj paragrafi:

8 "Hakmarrja. Kjo është rreziku i madh në Kosovë tani ..."

9 "'Mendoj që mund të ndërtojmë, të krijojmë garanci të
10 mjaftueshme kundër kësaj në një nivel institucional', tha Daan
11 Everts, diplomat holandez që do të çojë në rindërtimin e një
12 shoqërie të re në Kosovë. 'Por në nivelin individual duhet të
13 jetë sigurisht jo e lehtë që të kontrollohen ndjenjat e
14 hakmarrjes që kanë ekzistuar pas 100 vjet shtypjeje'."

15 E shikoni këtë?

16 "Megjithatë ai vazhdon ... e merr këtë post në ndjenjën
17 pozitive."

18 E shikoni këtë?

19 PË. Nuk e shoh pjesën "ndjenjë pozitive".

20 PY. Është tek rreshti në vijim, tani do shfaqet.

21 Ky është vlerësimi i tij. Ju e di që e keni ulur
22 rëndësinë, zvogëluar rëndësinë e hakmarrjes në një farë mase
23 dhe dje u përqendruat në përgjigjet tuaja duke thënë që kishte
24 një kontekst favorizues apo një kulturë që favorizonte këtë
25 gjë.

1 E pranoni që ajo që ai thotë këtu, pra, që në nivelin
2 individual ishte shumë e vështirë të kontrolloheshin ndjenjat
3 e hakmarrjes në terren?
4 PË. Ky është mendim, pikëpamje e z. Everts që ai shpreh për
5 vete dhe nuk besoj që më takon mua të bëj komente mbi
6 konstatimet e tija. Ajo që thashë dje është që ne kuptuam që
7 edhe individualisht nuk është që njerëzit urrenin njëri-
8 tjetrin tërësisht. E kuptoj që kishte individë a veprime
9 individuale në përgjithësi për hakmarrje. Megjithatë
10 përshtypja jonë nuk ishte që këto ishin akte dhune të
11 izoluara, sporadike. Unë po flas vetëm për atë që kam vërejtur
12 unë. Përshtypja ime në atë kohë kur isha aty ishte që këto nuk
13 ishin thjesht akte sporadike dhune.

14 Nuk kam më tepër të shtoj për z. Everts apo konstatimet e
15 tija, ato që ai ka vëzhguar më herët, po këtu duket që ai
16 sugjeron që të dyja ekzistojnë, pra, në nivelin institucional
17 që mund të trajtojmë dhe në nivelin individual.

18 Po gjithashtu, duhet të jem i qartë, që nuk kam
19 kundërshtuar asnjëherë që ka patur ndjenja individuale
20 hakmarrjeje e kështu me radhë. Por ajo që më kujtohet nga
21 ndërveprimet nga ato javët e para me shqiptarët e Kosovës nuk
22 krijova përshtypjen që të gjithë personat me të cilët biseduam
23 ishin të etur për hakmarrje, bilës disa prej tyre ishin të
24 kënaqur, që edhe pse disa prej tyre, ata ishin të kënaqur të
25 shihnin serbët që largoheshin e kështu me radhë. Por nuk kisha

1 përshtypjen që të gjithë edhe problemi më i madh ishte që të
2 gjithë -- nuk kisha përshtypjen që problemi më i madh ishte që
3 të gjithë njerëzit në Kosovë ishin të etur për hakmarrje, pra.
4 PY. Tani të shohim pak atë që thotë gjenerali Jackson lidhur
5 me këto. Do t'ju lexoj një pjesë të deklaratës së tij që dua
6 ta shfaqim në ekran. Paragrafi 76 i dokumentit 087358 deri --
7 dhe thotë, do ta lexoj këtë ngadalë:

8 "Por ka disa sjellja të pakënaqshme, shumë të pakënaqshme
9 tek disa serbë kundër shqiptarëve, përfshirë në disa raste
10 duket u besojnë që ata janë qenie, nuk janë qenie njerëzore,
11 nuk janë njerëz. Ndërsa kjo, ndërsa nga njëra anë nuk mund të
12 mbështetet apo të pranohet reagimi i shqiptarëve të Kosovës,
13 siç janë shprehur në kohë të tmerrshme, mund të kuptohet
14 dëshira për hakmarrje. Megjithatë kjo dëshirë mund të
15 kuptohet. Mos mendoni që unë po e mbështes këtë kur them këtë
16 gjë. Nuk e mbështes. Larg nga kjo. Por po i jap një kontekst,
17 Kouchner", ai i referohet Përfaqësuesit Special, "ndihmoi,
18 pra, për të larguar ndjenjën tek shqiptarët jo detyrimisht
19 UÇK-ja, vetë UÇK-ja që hakmarrja e dhunshme ishte përgjigje
20 legjitime ndaj asaj që u kishte ndodhur atyre."

21 Pra, e shihni që vlerësimi i gjeneralit Jackson ishte i
22 njëjti, ishte për të njëjtën periudhë kohore. Ne kemi fjalën
23 këtu "në vetvete" edhe këtu. Më kujtohet që ju e keni përdorur
24 atë lidhur me serbët, jo të gjithë të këqij në vetvete. Ai
25 thotë këtu që "jo detyrimisht UÇK-ja *per se*", pra, "në

1 vetvete". Pra, që të mos bëhet një përgjithësim lidhur me atë
2 se kush është përgjegjës, por duke thënë që në mesin e
3 shqiptarëve kishte një ndjenjë të thellë hakmarrjeje duke
4 patur parasysh të kaluarën dhe kontekstin. A pajtoheni me këtë
5 vlerësim për këtë periudhë kohore?

6 PË. Gjenerali Jackson ka patur perspektivën e tij dhe
7 pikëpamjen e tij të gjërave. Unë pajtohem, siç e thashë, që
8 kjo ishte situata në atë kohë, gjendja emocionale ishte,
9 njerëzit ishin emocionalisht të rënduar për arsye shumë të
10 kuptueshme. Por që të jemi të sigurtë, nuk ishim detyrimisht
11 aty për të kuptuar motivet e disa veprimeve që po ndodhnin çdo
12 ditë, e kam fjalën, ishte e rëndësishme për ne të kuptonin por
13 ne ishin aty për të gjetur masat për të parandaluar dhe për të
14 ndaluar këtë gjë dhe për të trajtuar këtë problem kur ndodhte.

15 Pra, ne kemi patur shumë diskutime mes vete, mes nesh dhe
16 disa prej pikëpamjeve që janë shprehur nga disa kolegët e mi,
17 kanë shprehur pikëpamje të caktuara, të tjerë kishin pikëpamje
18 të tjera. Dhe ne po përpiqeshim të thonim se nga aty, nga
19 pozicioni im, nga ndërveprimet e mia, sipas asaj që më
20 kujtohet, ne e dinim që kishte vepra, veprime individuale. E
21 kuptoj që nuk është që kishte vetëm urrejtje, njerëzit aty në
22 shumë raste festonin çlirimin, ishte pas një regjimi shtypës
23 që kishte ekzistuar përpara. Ne e kuptonim të gjithë këtë
24 kontekst.

25 Dhe, megjithatë edhe për arsye që u përpoqa të shpjegoj

1 dje, përshtypja ime, përshtypja e disa prej kolegëve të mi
2 ishte sigurisht që këto nuk ishin thjesht akte dhune
3 sporadike. Dhe ju referohem këtyre gjërave që kemi parë në
4 disa raporte që m'u treguan këto ditët e fundit.
5 PY. A është e drejtë që nuk ishin sporadike në kuptimin që
6 njerëzit po ktheheshin dhe gjenin shtëpi të shkatërruara,
7 kufoma dhe në disa raste veprimi si hakmarrje dhe vepronin si
8 hakmarrje për shkak të asaj që konstatojmë që e shihnim? Pra,
9 dukej sikur ishte diçka e organizuar për shkak se kjo po
10 ndodhte në shumë vende ku njerëzit u vendosën të merrnin
11 ligjin në duart e tyre. Po a nuk është kjo një interpretim, po
12 dhe ky interpretim i gabuar i asaj që po ndodhte në terren?

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtim, argumentative.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ai e ka
15 thënë, e dha qëndrimin e vet dhe mendimin e vet, ju po
16 vazhdoni në këtë drejtim duke debatuar me të.

17 Z. DIXON: [Përkthim]

18 PY. Mund ta them ndryshe. Ju flisni për një karakteristikë
19 apo tipar të organizimit që ishte diçka e organizuar, sulmet
20 apo hakmarrje nga njerëzit mund të jenë, mund të shihen
21 gjithashtu që kanë ndodhur sipas një tipari apo
22 karakteristike. Dhe e njëjta gjë ka ndodhur në vende të
23 ndryshme. Nuk është kështu sipas përvojës tuaj?

24 PË. Mbrojtje, e kam thënë disa herë, nuk e përjashtoj që
25 kishte veprime, akte dhune sporadike, hakmarrjeje, dhunë në

1 çfarëdolloj forme. Nuk e kam përjashtuar kurrë. Megjithatë,
2 natyrisht, këto gjëra kanë ndodhur dhe ka patur një numër të
3 madh të këtyre me siguri.

4 Por gjithashtu u përpoqa të shpjegoj se mënyra se si
5 është bërë kjo në disa raste duke identifikuar në mënyrë
6 sistematike apo ata që -- informacioni që ne merrnim ishte që
7 ishte, për shembull, një lagje ku kishte aktivitet të madh
8 brenda natës, brenda ditës. Pastaj një tjetër lagje ku serbët
9 po largoheshin. Jo unë personalisht, po kolegët e mi kanë
10 biseduar me disa prej këtyre njerëzve që po merrnin plaçkat e
11 po largoheshin apo kanë biseduar, kanë ardhur tek ne kanë
12 thënë, "Mbrëmë na kanë thënë që duhet të largohemi. Nesër kemi
13 ditën e fundit duhet të largohemi". Pra, këto nuk kanë tiparet
14 e veprimeve apo akteve sporadike, spontane dhe hakmarrjeje.
15 Këto kanë, këto janë karakteristika të një lloj organizimi në
16 këtë aspekt.

17 Dhe për neve dhe mendoj që e përmendëm edhe dje, ne nuk
18 kishim -- ne kishim patëm një diskutim më të gjatë mbi
19 rregullat e përdorimit të forcës dhe kryerjen apo përdorimin e
20 kontingjenteve të ndryshëm ushtarakë aty apo masa -- marrjen e
21 disa masave ushtarake aty. Për këtë ne patëm këtë diskutim.
22 Shkuam tek KFOR-i disa herë dhe thamë, "Ne na duhet një prani
23 në rrugë, prani ushtarake. Na duhen më shumë patrulla gjatë
24 natës në veçanti", sepse ka shumë prej këtyre, këto gjëra po
25 ndodhin me shumicë. Dhe si rezultat i kësaj pastaj pamë

1 veçanërisht në Prishtinë, që më kujtohet më shumë, një pranim
2 të shtuar të KFOR-it që patrullonte kryesisht gjatë natës.

3 Kjo është përshtypja e asaj që ka ndodhur, që kishte,
4 pra, një lloj forme, plani apo organizimi pas kësaj që po
5 ndodhte.

6 PY. Nuk do të shkoj më larg lidhur me këtë, mendoj që ju e
7 thatë dje, po kjo ka qenë njëra prej përshtypjeve tuaja dhe ju
8 nuk e keni, nuk keni bërë hetime vetë lidhur me këtë?

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Pyetja është bërë dhe përgjigja
10 është marrë.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Kjo del nga ajo që tha tani. Ai
12 përmendi një incident.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
14 përgjigjet.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Personalisht nuk kam bërë ndonjë
16 hetim.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është
18 përgjigja e tij.

19 Z. DIXON: [Përkthim] *Thank you.*

20 PY. Kalojmë shumë shpejt. Kam vetëm pak pyetje që më kanë
21 ngelur. Duke u kthyer tek intervista e OSBE-së mund të shohim
22 pjesën tjetër, z. Strohmeyer, ku lexohet në mes të faqes:

23 "Ai përmend shpejt atë listën."

24 Dhe thotë "ndërtim", flet për "ndërtimin e një force të
25 policisë që është e besueshme" që kjo është e rëndësishme dhe

1 që "përgatitja për zgjedhje".

2 Pra, këtu kemi pra një konstatim të asaj që po përmendja
3 dhe theksoja më herët, që në të ardhmen do të duhet të
4 bëheshin zgjedhjen dhe të krijoheshin institucionet vendore. A
5 është e saktë? Përgjigje të shkurtër ju lutem.

6 PË. Po, natyrisht. E kam -- ajo që dua të them është që plani
7 ishte që të përgatiteshin zgjedhjet. Nuk jam i sigurtë nëse po
8 flasim për një afat kohor konkret, por kjo do të ndodhte
9 brenda -- që kjo do të ndodhte brenda disa javëve, por ato do
10 bëhen.

11 PY. Do t'i kthehem kësaj. Kalojnë në faqen tjetër.

12 "Everts ka qenë në mënyrë të shpeshtë në kontakt me
13 udhëheqësit kosovarë."

14 E shihni këtë?

15 "I vetmi që ai njih shumë mirë është Rugova dhe pse të
16 cilin e njih shumë mirë është Rugova dhe pse kam biseduar me
17 shumë persona të tjerë. Sipas mendimit tim mendoj që duhet të
18 jetë një qasje e barabartë në raport me tre partitë kryesore,
19 Rugova në mënyrë të pajustificueshme është zgjedhur -- është
20 trajtuar në mënyrë të veçantë më të favorshme. Ka vizituar
21 Papën dhe është pranuar në -- ka qenë zyrtar dhe është takuar
22 me Mbretin e Spanjës."

23 Ai ishit juve i informuar se OSBE-ja kishte këtë
24 pikëpamje në fakt, që Rugova ishte dikush që po trajtohej në
25 mënyrë më të favorshme krahasuar me të tjerët?

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtim. Kjo është përtej
2 pyetjeve të Gjykatësve.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Ka të bëjë me strukturat paralele --

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

5 Z. DIXON: [Përkthim] -- dhe UÇK-ja ishte organi kryesor
6 dhe askush tjetër rreth tyre.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

8 Mund të përgjigjeni.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk e dija që Rugova ishte takuar
10 me Papën apo me Mbretin e Spanjës. Ndoshta në fakt vizita e
11 Papës tani që e shoh më kujtohet disi. Nuk isha i informuar në
12 hollësi për vendndodhjen e tij gjatë apo aktivitetin e tij
13 jashtë Kosovës.

14 Z. DIXON: [Përkthim]

15 PY. "Kjo krijon, kjo nënkupton një lloj mungese të trajtimit
16 të barabartë apo baraspeshe' dhe vazhdon "sepse njëri bëhet
17 më i anshëm, nuk duhet të harrojmë që lufta e ka ndryshuar
18 situatën në mënyrë drastike. UÇK-ja, për shembull, është bërë,
19 ka fituar popullaritet'."

20 Dhe kjo duket të sugjerojë që duhet të marrim parasysh
21 dhe UÇK-në, jo të bëjmë të kundërtën. A ishit ju, e njihnit
22 këtë analizë në atë kohë, analizë të bërë nga OSBE-ja?

23 PË. Edhe një herë, këtu Everts ka shprehur pikëpamjen e tij.

24 Nuk mendoj që kam thënë ndonjëherë që UÇK-ja nuk kishte fituar
25 popullaritet dhe nuk kishte mbështetje. Nuk kam arsye që të

1 mos pajtohem me këtë në thelb. Por ky ishte -- ajo që mund
2 t'ju them është si kontekst është që marrëdhënia mes z. Everts
3 dhe udhëheqjes së UNMIK-ut nuk ka qenë gjithmonë e lehtë në
4 disa momente të caktuara. Këto ishin vëzhgime të
5 përgjithësuara që ai ka të drejtën të bëjë, por kemi patur
6 pikëpamje të ndryshme për sa i përket pjesëve të caktuara.
7 PY. Ndoshta, por mund të pajtohem me këtë. Dhe ai thotë:

8 "Kur mund të mbahen zgjedhjet kjo do të varet edhe nga
9 çështja se si do vazhdojë, do vijojë më tej krijimi, formimi i
10 partive politike."

11 Dhe pastaj i referohet marrëveshjes së Rambujesë që
12 thotë, "një periudhë nëntë mujore është përmendur aty', thotë
13 Everts. Preferoj të mendoj të caktohet një kalendar një kohë
14 rreth dy vjet, pas dy vjetësh'."

15 Pra, në fakt ai po kthehet tek krijimi i institucioneve
16 dhe i gjithë qeverisë në një kohë të caktuar, me pushtet
17 vendor. Është kështu, apo jo?

18 PË. Kjo është ajo që thotë në intervistë apo në deklaratat
19 për shtyp. Nuk mund të them nëse kjo ishte pikëpamja e
20 përgjithshme në atë kohë në UNMIK që të gjithë mendonin këtë.
21 Nuk jam i sigurtë që ai përfaqëson këtë pikëpamje. Ajo, dhe
22 siç e thashë, ka pasur në momente të caktuara deklarata që
23 kanë krijuar një lloj, disa lloj tensionesh me z. Everts
24 lidhur me këto deklarata.

25 Pra, nuk duhet të jap ndonjë gjykim lidhur me këto. Ajo

1 që po them unë është që nuk mund të them që kjo pasqyron, sa i
2 përket zgjedhjeve apo kalendarit për zgjedhje, për shembull,
3 kjo reflekton atë pikëpamjen e përgjithshme të udhëheqjes së
4 UNMIK-ut në atë kohë.

5 PY. Po ju nuk e dini pikëpamjen apo mendimin e UNMIK-ut në
6 atë kohë? E kam fjalën --

7 PË. Sa i takon zgjedhjeve?

8 PY. Sa i takon zgjedhjeve.

9 PË. Nuk më kujtohet kjo. Nuk kam qenë i përfshirë në këtë.

10 PY. Në rregull.

11 PË. Sepse nëse nuk gaboj, mënyra e organizimit e Kombeve të
12 Bashkuara, prania e UNMIK-ut mendoj, jepte një pjesë të madhe
13 të përgatitjes së zgjedhjeve dhe zhvillimit të zgjedhjeve,
14 përgjegjësi të kësaj i jepte OSBE-së dhe mund të ketë qenë e
15 kuptueshme që ata kanë bërë punë në këtë drejtim që ishte
16 pjesë e mandatit të tyre.

17 PY. Dhe në fund, pa hyrë në hollësi të tepërta, pajtoheni që
18 kjo është pikëpamja e përgjithshme që duhet të lëviz, të eci
19 përpara dhe sepse ju nuk do qëndronit aty përgjithmonë?

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Pyetje e bërë dhe përgjigjur.

21 Z. DIXON: [Përkthim] A pajtoheni me këtë?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
23 përgjigjet.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Siç e thashë më parë ne e quajtmë,
25 i referoheshim kësaj si tranzitore. Z. Everts është shumë i

1 qartë në atë që ne nuk do të qëndronim aty përgjithmonë dhe
2 përjetësisht duke administruar Kosovën dhe në një moment të
3 caktuar duhet të transferonim pushtetin tek pushteti vendor
4 dhe kjo zakonisht bëhet përmes organizimit të zgjedhjeve. Dhe
5 zgjedhjet ishte e qartë që nga fillimi që ishin pjesë e planit
6 të punës.

7 Z. DIXON: [Përkthim]

8 PY. Faleminderit. Kjo ishte pyetja e fundit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
10 Dixon.

11 Koha për pushimin e drekës.

12 Z. TULLY: [Përkthim] E dëgjova këtë nga Gjykatësi

13 Mettraux. Kam pesë minuta pyetje, mund të kem.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 Z. TULLY: [Përkthim] Do të përpiqem që të jem dhe më i
16 shkurtër se kaq.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit për pushimin tani. Do
18 të më ndihmojë që të qartësojë këtë pikë më vonë.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 --- Pauza fillon në orën 11.01

22 --- Seanca rifillon në orën 11.30

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni

24 dëshmitarin, ju lutem.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Ndërkohë që sillni dëshmitarin a

1 mund të kërkoj pranimin e intervistës së OSBE-së, të lutem.

2 Besoj se ju e keni në fakt këtë numrin e dokumentin. Thjesht
3 dy faqet që përdora me dëshmitarin, ju lutem.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
5 kundërshtime?

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
8 kundërshtime. Dokumenti me numër 40009162-9163 pranohet.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti pranohet dhe
10 merr numrin 2D0040 edhe ka klasifikim konfidencial.
11 faleminderit.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi dhe disa
14 pyetje, Strohmeyer. Jemi duke iu afruar fundit.

15 Dëgjoni z. Tully me vëmendje.

16 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit.

17 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Tully:

18 Z. TULLY:

19 PY. [Përkthim] Jemi shumë afër fundit, z. Strohmeyer. Kam
20 vetëm pesë minuta pyetje për ju. Besoj se mund t'u përgjigjeni
21 me "po" ose "jo". Nëse keni nevojë të shpjegoni më thoni, por
22 përpigemi të përgjigjemi me "po" ose "jo".

23 Unë kam pyetje që lidhet me një pyetje që ju bëri
24 Gjykatësi Barthe dje në faqen 134 të transkriptit të djeshëm.
25 Kishte lidhje me atë kërcënimin se forcat serbe dhe jugosllave

1 mund të rifuteshin në Kosovë. Po ju lexoj pjesërisht ose po
2 bëj një përmbledhje të pyetjes dhe do ju bëj unë një pyetje
3 pastaj.

4 Pra, në transkriptin e ditës së djeshme Gjykatësi Barthe
5 iu lexoi Shënimin Përgatitor numër 2, paragrafi 2, ku kishit
6 thënë ju se ju kujtohet që:

7 "... nuk ka pasur qëndrueshmëri, ka pasur shumë
8 shqetësime nga aspekti i sigurisë se ekzistonte frika se
9 forcat serbe mund të përpiqeshin të rifuteshin në Kosovë në
10 kufirin jug-lindor. Ka pasur gjithmonë tensione në Mitrovicë
11 mes forcave serbe. Dhe kur mbërritën ndërkombëtarët askush nuk
12 besonte që forcat serbe do të largoheshin kaq kollaj."

13 Ju pyeti Gjykatësi Barthe, "A e mbani mend që e keni
14 thënë këtë?, dhe ju u përgjigjët dhe thatë:

15 "Mbase kjo mund të ketë ndodhur sepse Milosheviqi mund të
16 jetë shprehur që do të merrnin pasuritë që u takonin në atë
17 vend edhe mund të kishte elementë të tillë që operonin atje,
18 po unë thashë jo."

19 Dhe më pas Gjykatësi Barthe shtjelloi më tej pyetjen dhe
20 tha:

21 "Z. Strohmeier, gjithmonë duke marrë parasysh ato që i
22 keni parë dhe keni dëgjuar ju vetë, ju vetë ishit personalisht
23 të shqetësuar se ishte ushtria ish-jugosllave mund të
24 rikthehej në Kosovë? A shqetësoheshin, pra, ndërkombëtarët?"

25 Pastaj do kaloj disa rreshta, dhe ju thatë që nuk ju

1 kujtoheshin -- nuk ju kujtoheshin diskutime lidhur me këto
2 aspekte dhe supozoj se nuk mund të thonit nëse keni qenë të
3 shqetësuar apo jo vërtetë që forcat serbet mund të
4 riktheheshin në Kosovë apo jo.

5 Më pas keni thënë:

6 "Nuk ka qenë ky shqetësimi ynë kryesor. Ekzistonte një
7 shqetësim që mund të ekzistonin ende xhepa me serbë, sidomos
8 ditët e para. Mund të kishte elementë të mbetur nga ish-Armata
9 Jugosllave dhe mund të kishte sulme, por për këtë grupim."

10 Ju kujtohet kjo përgjigje?

11 PË. Po.

12 PY. Nuk keni -- ta përsërisni përgjigjen që i keni dhënë
13 Gjykatësit, por a keni thënë ju që përgjithësisht ekzistonte
14 frika mes komunitetit ndërkombëtar se mund të riktheheshin
15 forcat serbe në Kosovë?

16 PË. Frikë apo shqetësim?

17 PË. Shqetësim, frikë. Pra, edhe vetë ndërkombëtarët e
18 mendonin dhe shqetësoheshin se mund të kishte rikthim të
19 forcave serbe në Kosovë. Kjo është thënë në faqen 136 të
20 transkriptit të ditës së djeshme. Ju keni thënë:

21 "... nuk ka qenë shqetësimi kryesor, por ka pasur
22 shqetësime se mund të kishte ende -- mund të kishte ende disa
23 xhepa të ish-Armatës Jugosllave që mund të kishin elementë të
24 Armatës Jugosllave që mund të kishin mbetur atje. Kështu?

25 PË. Po ditët e para ekzistonte ky shqetësim. E thashë edhe

1 dje, ne kemi parë me sytë tonë se si u qëllua një person. Po
2 nuk më kujtohet, dhe unë prandaj e shtjellova kaq shumë
3 përgjigjen time. Nuk më kujtohet a ka pasur grupime të
4 organizuara apo ka pasur plane nga ana e Serbisë që të
5 rikthehej në Kosovë. Kjo nuk më kujtohet.

6 PY. Në fakt kjo do të ishte dhe pyetja ime e radhës. Kur
7 thoni që nuk keni pasur dijeni për raste të tilla, a kam të
8 drejtë unë kur them që ju, në fakt, në dispozicion nuk kishit,
9 nuk kishit në dispozicion informacion se sa e lartë ishte
10 mundësia që këto forca të riktheheshin në terren që të
11 materializohej kjo frikë?

12 PË. Po.

13 PY. A pajtohem me mua që Mike Jackson, Gjenerali Jackson
14 ishte personi që do ta kishte këtë informacion dhe që mund të
15 ofronte një analizë të plotë lidhur me këtë?

16 PË. Po, shpresoj që po.

17 PY. Duhet të kalojmë në seancë private, ju lutem, për këtë
18 sepse është një dokument i rregullës 107.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
20 seancë private.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 63

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

25 Faleminderit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Z. Strohmeyer, e përfunduat dëshminë tuaj. Faleminderit
3 që ishit këtu, që ndatë informacionet që kishit. Ishin dy ditë
4 e gjysmë të gjata. Ju faleminderit për durimin tuaj dhe ju
5 urojmë gjithë të mirat për të ardhmen. Tani mund të largoheni
6 nga salla e gjyqit. Keni përbushur detyrimet përpara këtij
7 Trupi Gjykues.

8 DËSHMITARI: Faleminderit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më thanë që
10 dëshmitari i radhës është gati të fillojë. Bëjmë dhjetë minuta
11 pushim dhe rikthehemi në sallën e gjyqit. Bëjmë vetëm dhjetë
12 minuta pushim.

13 --- Seanca ndërpritet në orën 11.42

14 --- Seanca rifillon në orën 11.30

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do fillojmë
16 me dëshminë e dëshmitarit të Prokurorisë W04874.

17 Ju lutem, silleni dëshmitarin në sallë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Tavakoli do t'i bëjë pyetjet,
19 kështu që mos kini pritshmëri se do t'i bëj unë.

20 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita, z.
22 Clark.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëdita.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretarja e
25 seancës do t'ju japë tekstin e betimit solemn të cilin duhet

1 ta bëni në bazë të Rregullores së procedurës, rregulla 149(5).

2 Lexoni me zë tekstin që keni përpara.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
4 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
5 solemnisht se do të kryej detyrën time -- deklaroj solemnisht
6 se do të kryej analizën si ekspert në mënyrë të ndërgjegjshme
7 dhe me aq sa di, dhe do të jap përfundime dhe mendime të sakta
8 dhe të plota.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
10 mund të uleni.

11 DËSHMITARI: JOHN CLARK

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të
13 fillojmë me dëshminë tuaj që mendohet se do të zgjasë rreth dy
14 ditë. Sikurse e dini, fillimisht do t'jua bëjë pyetjet
15 Prokuroria, më pas ekipet e Mbrojtjes kanë të drejtë t'ju
16 bëjnë pyetje, por edhe Gjykatësit e Trupit Gjykses mund të
17 kenë pyetje.

18 Prokuroria ka kërkuar dy orë për pyetjet e veta. Ekipet e
19 Mbrojtjes së bashku kanë kërkuar rreth pesë orë. Inkurajoj të
20 gjitha palët të jenë sa më të kujdesshme në shfrytëzimin e
21 kohës së tyre. Trupi Gjykses mund të lejojë pyetje shtesë nëse
22 plotësohen kushtet përkatëse.

23 Dëshmitar, përgjigjuni qartë, me fjali të shkurtra. Nëse
24 nuk kuptoni një pyetje lirisht kërkoni që pyetja të
25 përsëritet, ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që ta

1 sqarojmë për ju.

2 Ju lutem, na thoni bazën e fakteve, të rrethanave dhe të
3 njohurisë për të cilën do t'ju bëjnë pyetje.

4 Në qoftë se Prokuroria ju flet, ju kërkon të flisni për
5 korrigjimet që i keni bërë deklaratave tuaja, ju lutem thoni
6 me zë për procesverbal që deklarata me shkrim bashkë me
7 korrigjimet përkatëse pasqyron saktësisht dëshminë tuaj.

8 Ju lutem, flisni pranë mikrofonit, dhe prisni pesë
9 sekonda përpara se të përgjigjeni. Dhe ju lutem, flisni
10 ngadalë për përkthyesit.

11 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit, nuk
12 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
13 jashtë ambienteve të Gjykatës. Nëse dikush jashtë Gjykatës ju
14 bën pyetje për dëshminë tuaj, menjëherë na informoni për këtë.

15 Ju lutem, ndërprisni fjalën nëse jua kërkoj unë, dhe ju
16 lutem mos flisni më nëse më shihni që të kem ngritur dorën.
17 Kjo do të thotë se unë duhet t'ju jap një udhëzim.

18 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na thoni dhe do
19 të bëjmë organizimin përkatës.

20 Fillojmë tani me pyetjet e Prokurorisë që janë ulur në të
21 majtën tuaj. Dëgjojini me vëmendje.

22 Z. Pace, fjala është për ju.

23 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

24 Pyetje nga z. Pace:

25 PY. Dhe mirëdita, Dr. Clark.

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 67

1 PË. Mirëdita.

2 PY. Jemi takuar dhe më herët, por do prezantohem sërish. Jam
3 James Pace, jam Prokurori i Prokurorisë që do t'ju bëj pyetje
4 për këto dy orët në vijim.

5 Ju lutem, për procesverbal, jepni emrin dhe mbiemrin.

6 PË. Quhem John Clark.

7 PY. Datëlindja juaj?

8 PË. 5 shtator 1951.

9 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem, të vendosim në ekran
10 materialin që mban numër 103133-103135. Ky material dhe
11 materialet që do të kërkoj që të paraqiten sot, nuk janë për
12 publikun.

13 PY. Dr. Clark, a është ky jetëshkrimi juaj në ekran?

14 PË. Po.

15 PY. Përmbajtja a është e saktë me aq sa mund të thoni?

16 PË. Po. Është hartuar para katër vjetësh, por nuk ka
17 ndryshuar gjë, është e njëjta.

18 PY. Ka ndonjë gjë shtesë që doni ta theksoni?

19 PË. Jo, asgjë me rëndësi.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë
21 pranimin e jetëshkrimit njësoj si me dëshmitarin e fundit
22 ekspert dhe në përputhje me vendimin F2787 propozojmë që të më
23 jepet një numër provizor dhe të diskutohet pranimi i të gjitha
24 këtyre në fund të dëshmisë së këtij dëshmitari.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 68

1 Jepni numrin provizor dhe do të marrim vendim në fund të
2 dëshmisë së dëshmitarit.

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti
4 me numër 103133-103135 do të marrë numrin provizor që është
5 numri P01989 dhe klasifikimi është konfidencial. Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Mund ta heqim
8 dokumentin nga ekрани dhe të vendosim në ekran dokumentin që
9 mban numrin 103108-103132.

10 PY. Dëshmitar, në ekran tani mund të shihni dy dokumente. Në
11 të djathtë në anglisht dhe në të majtë në shqip. Ju fokusoheni
12 tek anglishtja. A e keni përgatitur ju këtë raport?

13 PË. Po, unë e kam përgatitur.

14 PY. A e keni përgatitur këtë raport në përputhje me letrën e
15 udhëzimeve që ju dërgoi ZPS-ja?

16 PË. Po.

17 Z. PACE: [Përkthim] E heqim shqipen dhe vendosim në vend
18 të versionit në shqip materialin 102430-102442. Faleminderit.

19 PY. Dëshmitar, shohim dokumentin në të majtë. Është letra me
20 udhëzime që ju është dërguar ju. Dhe mban datën 30 korrik
21 2021. A është kjo letra me udhëzime që shërbeu si bazë për ju
22 që të përgatisni raportin në të djathtë të ekranit?

23 PË. Po.

24 PY. A ju kujtohet që ju dhamë disa dokumente bashkëngjitur
25 letrës së udhëzimeve?

1 PË. Po. Më kujtohen që m'u dhanë disa dokumente.

2 PY. A është e saktë, është e vërtetë që letra e udhëzimeve
3 përmbante si pyetje të përgjithshme për patologjinë
4 mjekoligjore, dhe pyetje konkrete për disa nga dokumentet që
5 ju kishin dhënë?

6 PË. Po.

7 PY. A ju kujtohet që i lexuat dokumentet edhe i përmendët
8 këto dokumente në akt-ekspertizën tuaj?

9 PË. Po.

10 PY. Akt-ekspertiza a përmban opinionin tuaj të pavarur për
11 çështjet që trajtohen në të?

12 PË. Po.

13 PY. A ju kujtohet që kohët e fundit ju dhamë mundësinë ta
14 lexonit dhe njëherë akt-ekspertizën dhe të bënit sqarime?

15 PË. Po.

16 PY. A ju kujtohet që theksuat që ishte një çështje në raport
17 që donit ta trajtonit?

18 PË. Po, ka qenë një diçka që desha ta trajtoja.

19 PY. A ishte kjo çështje me, që lidhej me mospërputhjen, që
20 kishte një mospërputhje lidhur me autopsinë e një personi a më
21 shumë personash?

22 PË. Po. Ka pasur -- paqartësi për një raport *post-mortem*.

23 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani,
24 dokumentin në të majtë.

25 Dhe të nderuar Gjykatës, ju lutem të kalojmë në seancë

Dëshmitari: John Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 70

1 private për mirëqenien e anëtarëve të familjes së viktimës,
2 por besoj thjesht për pesë minuta do më duhet të jem në seancë
3 private.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
5 seancë private.

6 [Seancë private]

7 [Seancë private teksti i fshirë]

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 71

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 73

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 jemi në seancë të hapur. Faleminderit.

21 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

22 PY. Tani, Dëshmitar, duke lënë mënjanë çështjen që ne
23 diskutuam në seancë të mbyllur. Informacioni që keni dhënë në
24 akt-ekspertizën tuaj dhe që keni përpara në ekran, a është
25 informacion i saktë dhe i vërtetë me aq sa dini ju?

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 76

1 PË. Po.

2 PY. Akt-ekspertiza a pasqyron me saktësi atë çfarë do thonit
3 në qoftë se do të pyeteshit në lidhje me çështjet e trajtuara
4 në këtë raport?

5 PË. Po.

6 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që të
7 pranohen në prova gjyqësore letra e udhëzimeve të ZPS-së dhe
8 akt-ekspertiza, dhe përderisa Trupi Gjykues do të vendosë
9 lidhur me pranimin e dokumenteve më pas, ne kërkojmë që të
10 caktohet një numër provizor prove për secilin prej dokumenteve
11 të cituara më sipër, dhe gjithashtu kërkojmë që të ofrojmë për
12 provë gjyqësore materialin e burimit që lidhet me akt-
13 ekspertizën. Këto janë dokumente që kanë ERN-të, së pari është
14 Shtojca 1 e shënimit përgatitor të dëshmitarit 4874, që është
15 124449-124455.

16 Dhe së fundi, ne gjithashtu e kuptojmë se vendimi do të
17 merret më vonë, megjithatë siç e thashë kërkojmë që të
18 caktohet një numër provizor prove.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A doni që të
20 regjistrohet dhe shënimi përgatitor? Kërkoni që të
21 regjistrohet edhe shënimi përgatitor?

22 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
24 kundërshtim?

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk kemi gjë për të shtuar për

1 momentin, megjithatë duam që të shprehemi në qoftë se do jetë
2 e nevojshme, në momentin kur të vendoset për pranueshmërinë e
3 këtyre dokumenteve.

4 Z. TULLY: [Përkthim] E njëjta gjë është e vërtetë edhe
5 për ne.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
7 në qoftë se ka kundërshtime të tjera, dokumenti 102430 deri në
8 102442, do të marrin një numër provizor prove.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do jetë numri P01990, me
10 klasifikimin konfidencial.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe më pas
12 raporti i patologjisë që është 103108-103132, do të marrë një
13 numër provizor prove përsëri.

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Numri që do i caktohet
15 këtij dokumenti është P01992, dhe klasifikimi është
16 konfidencial. Ju falënderoj, të nderuar Gjykatës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
18 vazhdoni më tej.

19 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta mbajmë akt-ekspertizën në
20 ekran, dhe dua që përbri këtij dokumenti të mund të shfaqet
21 gjithashtu edhe dokumenti SITF00414169-SITF00414223-ET. Të
22 kalojmë në faqen që përfundon me 41478 [Sipas përkthimit].
23 Faleminderit. Ndërkohë që në akt-ekspertizën që është
24 dokumenti në të djathtë, do i kërkoja Sekretarit të paraqesë
25 faqen 103114.

1 PY. Dëshmitar, jemi në seancë të hapur, kështu që nuk është e
2 nevojshme që të përmendni emrin e viktimës. Sikurse mund ta
3 shikoni në këtë faqe të raportit tuaj, ju i referoheni
4 dokumentit që është në të majtë të ekranit. Domethënë, emrat e
5 viktimave janë të njëjta, dhe numrat e regjistrimit janë të
6 njëjta. A i shikoni këto ngjashmëri në ekran në të dy
7 dokumentet që keni përpara, Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Në këtë pjesë të raportit, në fillim të faqes ju thoni si
10 më poshtë:

11 "Përshkruhen jashtë plagë të bëra përmes të shtënit me
12 armë --"

13 Dhe në qoftë se mund të vazhdojmë më tej në dokumentin në
14 të djathtë. Në përgjigje të pyetjes 1, ju thoni që:

15 "Pavarësisht sa ka qenë numri ekzakt i plumbave, dhe
16 pjesëve të trupit ku -- që janë përshkuar prej tyre nuk ka
17 asnjë lloj pyetje që vdekja e personit ka ardhur si rezultat i
18 traumës së shkaktuar nga të shtënat me armë."

19 A mund të na shpjegoni, Dëshmitar, se nuk -- pse e keni
20 thënë këtë, që nuk ka asnjë dyshim që vdekja është shkaktuar
21 nga trauma e të shtënave me armë pavarësisht që juve
22 trajektoren e konsideroni si shumë të dyshimtë? Si keni
23 mbërritur në këtë përfundim?

24 PË. Në rastin e parë, në rastin e të shtënës së parë, plaga
25 ishte shumë e drejtpërdrejtë. Në kuptimin që ishte e qartë që

1 kishte përshkuar plumbi pjesën e majtë të kraharorit dhe
2 kishte dalë nga shpina. Pra, ishte një plagë e cila ishte
3 goxha e qartë, pra ishte një plagë që ishte shkaktuar përmes
4 armës së zjarrit dhe përshkimit të plumbit në trupin e
5 viktimës. Kështu që personi ka vdekur nga plaga në kraharor,
6 domethënë, kjo plaga e drejtpërdrejtë që sapo ju shpjegova.

7 Sa u takon dy plagëve të tjera, domethënë, njëra prej
8 tyre është në shpinën e trupit të pajetë dhe për secilin prej
9 këtyre plagëve ka pasur një pikë hyrëse dhe një pikë dalëse
10 shumë afër, dhe të dyja pikat dalëse kanë qenë në shpinë, gjë
11 e cila është shumë e pazakontë, domethënë, shumë e pazakontë
12 që të kishte shenja të tilla, me përjashtim të rasteve kur
13 tyta e armës ka qenë shumë sipërfaqësore, dhe këndi ka qenë i
14 tillë që të ketë shkaktuar një dëmtim të tillë. Pra, në qoftë
15 se, i takon që për të shpjeguar këto dy lloj plagësh i takon
16 që viktima ndoshta duhet të kishte qenë i shtrirë, dhe pastaj
17 të kemi këto lëndimet e plagët të cilat janë tangjentale me
18 njëri-tjetrën. Nuk kam fotografi që mund të më ndihmonin për
19 të dhënë më shumë përshkrim, megjithatë pavarësisht situatës,
20 të paktën kemi një rast ku plumbi ka qenë i drejtpërdrejtë,
21 domethënë, ka pasur një pikë dalëse dhe një pikë hyrëse shumë
22 të qartë.

23 PY. Në rregull. Dëshmitar, shikoj që keni disa dokumente të
24 shtypura, të printuara, përpara në tavolinën tuaj, kështu që
25 në qoftë se doni t'i përdorni ato, ose na thoni shkurtimisht

1 se çfarë dokumentesh janë këto.

2 PË. Kam akt-ekspertizën e kryer prej meje që sapo u prezantua
3 prej jush, por kam kopje gjithashtu edhe versione të
4 përkthyer të raporteve *post-mortem*. Kam gjithashtu edhe disa
5 diagrame të trupit të cilat i kam përgatitur për dëshminë sot
6 dhe thjesht, domethënë, është një përshkrim rreth këtij
7 ilustrimi i lëndimeve.

8 PY. Për sqarime, diagramet e trupit që keni përpara, janë të
9 njëjtat diagrame që m'i keni dorëzuar mua dhe ekipit tim të
10 hënën?

11 PË. Po.

12 Z. PACE: [Përkthim] Tek raporti në të majtë, do i kërkoja
13 Sekretarit që të kalojmë tek faqja që përfundon me 414189. Në
14 akt-ekspertizën që është në të djathtë të ekranit, të shkojmë
15 tek faqja 103177. Të kalojmë drejt fundit të faqes në
16 dokumentin që kemi në të djathtë të ekranit.

17 PY. Edhe një herë, Dëshmitar, nuk është e nevojshme që të
18 përmendim emrin e viktimës, megjithatë sikurse mund ta shikoni
19 në faqen e akt-ekspertizës të shkruar prej jush në të djathtë
20 të ekranit, ju i referoheni viktimës të përmendur tek raporti
21 në të majtë. A është e vërtetë kjo?

22 PË. Po.

23 PY. Si pjesë të akt-ekspertizës tuaj, në dy pikat të theksuar
24 në fund të faqes, ju thoni si më poshtë:

25 "... disa prej trajektoreve duken jo të qarta". Pra, të

1 bëjnë të dyshosh.

2 Dua t'ju pyes, fakti që trajektoret duken si të
3 dyshueshme, a kanë ndikim kjo gjë mbi përfundimin që keni
4 nxjerrë ju?

5 PË. Jo, domethënë është e qartë që viktimi ka vdekur si
6 rezultat i të shtënave me armë zjarri. Dhe kjo është e
7 verifikueshme përmes pikave hyrëse dhe dalëse të plumbave.

8 PY. Sipas përvojës tuaj, sa e lehtë apo sa e vështirë është
9 për të gjurmuar ose për të hartëzuar, ose përcaktuar
10 ekzaktësisht se cila është trajektorja e armëve të zjarrit, e
11 plumbave që përshkuan trupin?

12 PË. Nuk është punë e lehtë për të përcaktuar, sigurisht
13 domethënë në momentin kur ka shumë plagë, veçanërisht është më
14 e vështirë për t'u identifikuar arsyeja, gjithsesi tendenca
15 kryesore e plumbave është të futen në trupin e njeriut dhe të
16 dalin në të njëjtin drejtim. Megjithatë, ka raste ku disa
17 plumba, pra, të mund të hasin një lloj pengese në trupin e
18 njeriut edhe pika dalëse të mos jetë një trajektore e
19 drejtpërdrejtë, domethënë të ketë një lloj ndryshimi rrugëtimi
20 ose trajektore të plumbit.

21 Megjithatë, në raste të tilla, raste të tilla nuk janë
22 shumë të zakonshme. Megjithatë, në fund të ditës nuk është
23 shumë e rëndësishme, nuk bën ndonjë dallim për të përcaktuar
24 se cili është shkaku i vdekjes, për shkak të faktit që sikurse
25 e thashë, domethënë, të paktën në një rast pika hyrëse dhe

1 dalëse ishte e qartë.

2 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull. Le t'i heqim dokumentet
3 nga ekрани.

4 PY. A mund t'i thoni Trupit Gjykues se çfarë do të thotë
5 *livor mortis*?

6 PË. Është një term të cilin unë nuk e përdor zakonisht,
7 megjithatë është një term i cili është -- reflekton ndryshimet
8 standarde që ndodhin në trupin e personit, domethënë në
9 veçanti i referohet ndryshimeve fizike sepse me -- në momentin
10 kur ndryshon temperatura e gjakut në trup, atëherë, trupi
11 juaj, trupi, domethënë, i vdekur, arrin pikën më të ulët të
12 gravitetit. Domethënë, me fjalë të tjera është një lloj
13 shterimi i trupit ose një lloj, për shembull, në qoftë se bie
14 dikush me shpinë i takon që pjesa e shpinës do të nxihet si
15 rezultat i forcës së rëndesës dhe si rezultat i dekompozimit
16 dhe ndryshimit të temperaturës së trupit.

17 PY. A mund të na thoni në përgjithësi se ky proces që ju sapo
18 na përshkruat, për shembull, hipostazat, lividiteti e të
19 tjerë, domethënë, kur ndodh, sa kohë kalon nga momenti kur
20 vdes personi deri në momentin kur ndodhin këto procese?

21 PË. Tre ose katër orë pas vdekjes. Nuk është një proces që
22 ndodh menjëherë. Domethënë, duhet të kalojnë disa orë për të
23 ndodhur këto procese. Pra, zakonisht shoqërohet me humbjen e
24 ngjyrës së lëkurës, që lëkura mund të marrë ose ngjyrë kështu
25 si rozë të thellë, ose mund të marrë ngjyrë të purpurt.

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 83

1 PY. Si patologjist forensik, a mund të na thoni se kur ndodh,
2 kur ndodhin këto shenjat e zeza, ose të purpurta, a mund të --
3 cilat janë ato shenja të cilat mund të ndodhin përpara
4 vdekjes?

5 PË. Përgjithësisht mund të ndodhë për shkak të shpërndarjes
6 rastësore që mund të ketë, për shembull, një enjtje ose një
7 mavijosje në trupin e një personi. Është një proces i cili
8 vjen, është i drejtpërdrejtë si proces.

9 Z. PACE: [Përkthim] Tani do të -- ju lutem transmetoni në
10 ekran dokumentin P00858. Nuk është e nevojshme që t'i jepni
11 përkthimin anglisht, mjafton ky dokument dhe të fillojmë së
12 pari me faqen SITF00189124.

13 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dua që të përfitoj nga
14 rasti që të korrigjoj atë çfarë thashë më përpara. Dokumenti
15 me ERN 103108 deri në 103132, duhet të kishte marrë numrin e
16 provës provizore P01991 në vend të numrit P01992. Ju
17 falënderoj.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E mbajtëm
19 shënim, faleminderit.

20 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

21 Ndërkohë në dokumentin që kemi përpara në ekran dëshiroj
22 të kalojmë në faqen SITF00189124. Mund ta zmadhojmë pamjen.
23 Ose ta zvogëlojmë pak në mënyrë të tillë që të mund ta
24 shikojmë të plotë fotografinë. Në rregull. Faleminderit.

25 PY. Dëshmitar, për momenti do ju kërkoj që t'i hidhni një sy

1 fotografive ashtu siç do të shfaqen në ekran. Do t'i kalojmë
2 njëra pas tjetrës dhe pastaj do t'ju bëj ca pyetje konkrete
3 për disa prej fotografive.

4 Kjo është fotografia e parë.

5 Z. PACE: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretarit të
6 kalojmë te faqja tjetër, që është faqja 189125. Në rregull.
7 PY. Ju lutem, shikoni dhe këtë dhe këtë fotografi për
8 momentin, dëshmitar.

9 Z. PACE: [Përkthim] Tani le të kalojmë tek faqja tjetër,
10 që ka numër 189126.

11 PY. Kjo është fotografia e parë që duket, kështu që mund të
12 kalojë Sekretari ngadalë nga njëra faqe te tjetra, në mënyrë
13 të tillë që të mund t'i shikojmë të gjitha fotografitë e të
14 gjitha imazhet deri në fund të dokumentit.

15 Z. PACE: [Përkthim] Po ashtu, do kërkoja që të zmadhohet
16 pamja e viktimës që është në fotografinë që keni përpara.
17 Ndërkohë, le të vazhdojmë tek faqja tjetër, faqja tjetër është
18 189127. Fillojmë me fotografinë në fillim të faqes. Të kalojmë
19 nëpër faqe ngadalë, do ju kërkoja që ta zmadhoni pak. Ju
20 lutem, vazhdoni më poshtë drejt faqes, dhe tani shikojmë
21 fotografinë që është në fund të faqes.

22 Dhe faqja e fundit që do kërkoja të shfaqej -- është
23 faqja që përfundon me 189128. Janë dy fotografi në këtë faqe,
24 kështu që do i kërkoja Sekretarit që të filloj së pari me
25 imazhin e parë dhe gradualisht të kalojë tek pjesa e dytë e

1 faqes ku jepet fotografia e dytë.

2 Atëherë, të ndalojmë tek kjo fotografi. Për qartësi për
3 procesverbal, është fotografia e dytë që është në pjesën,
4 gjysmën e dytë të faqes që kemi në ekran, që ka numrin 189128.
5 PY. A mund të na tregoni se çfarë shikoni në këtë fotografi,
6 dëshmitar?

7 PË. Së pari është lividiteti *post-mortem*, domethënë mund të
8 shikoni humbjen e ngjyrës, ose kthimin e ngjyrës në të purpurt
9 brenda dhe në të dyja anët, në fakt. Domethënë është një, siç
10 mund ta shikoni, ngjyra ka ndryshuar, është bërë si në të
11 purpurt, në të kuqërremtë. Përveç kësaj, në të majtë mund të
12 shikojmë që ka një zonë të purpurt që, më e thellë, që në fakt
13 është mavijosje, është e qartë kjo. Dhe kjo ka ndodhur gjatë
14 kohës kur personi ka qenë, jetonte domethënë, ka qenë i
15 gjallë. Është një zonë e gjerë pra, siç mund ta shikoni është
16 një sipërfaqe e konsiderueshme që është mavijosur, e personit,
17 ka edhe disa si viza të vogla që mund t'i shikoj aty. Ndoshta
18 mund të jetë goditur me një instrument disi të gjatë.

19 Megjithatë, me fjalë të tjera, e thashë dhe një herë
20 mavijosja është e madhe, sipërfaqja që ka qenë i mavijosur
21 është e madhe dhe duket qartë që ka dallim ndërmjet ngjyrës së
22 mavijosjes dhe ngjyrës së trupit të vdekur, me lividitetin,
23 pra, në pjesë të tjera të trupit.

24 PY. Do i kërkoja Sekretarit që t'ju japë një gjë për të bërë
25 shënim, do të doja të bënit dallimin ju në fotografinë që keni

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 86

1 përpara ndërmjet, pra lividitetit, ngjyrës së purpurt që thoni
2 juve, dhe ngjyrës së dëmtimit që ka pasur.

3 PË. [Shënon].

4 PY. Faleminderit. Kjo është e qartë.

5 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kur të vijë
6 momenti do ju kërkojmë që edhe ky dokument të mund të pranohet
7 në prova gjyqësore për sqarim ose qartësi procesverbali. Mbase
8 për momentin duhet t'i caktohet një numër provizor prove.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
10 jepini një numër provizor prove dokumentit 189128.

11 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument do të ruhet
12 me numrin REG01199, dhe për momentin do i caktoj numrin e
13 provës P01992. Faleminderit.

14 Z. PACE: [Përkthim] T'i lë pak kohë Sekretarit që të
15 përfundojë punën e tij dhe pastaj do të vazhdojmë më tej.

16 Në të njëjtën faqe, le të kalojmë tek fotografia që është
17 në krye të faqes. I shohim shënimet.

18 PY. Ju lutem, na duroni një moment, Dëshmitar, domethënë do
19 duhet që të hapim dokumentet. Një çast vetëm.

20 Z. PACE: [Përkthim] Faqet 189128. Faleminderit.

21 PY. Atëherë, për momentin duhet të përqendrohemi në këtë
22 fotografi. Për momentin mendoj që kemi pamje të qartë.

23 Dëshmitar, a mund të na thoni çfarë shihni në këtë fotografi?

24 PË. Dalloj dy gjëra kryesore në këtë fotografi. Së pari, janë
25 ndryshimet pas vdekjes, për shembull, tek këmbët që është

1 lividiteti, dhe në pjesën e pasme të kofshëve, po ashtu kemi
2 edhe thyerjen e këmbëve në pjesën e poshtme, dhe këto janë siç
3 e thashë dhe më përpara, janë ndryshime që kanë ndodhur pas
4 vdekjes së personit.

5 Ndërkohë që sa i takon shpinës së tij, mbase do ishte më
6 mirë që të kalojmë tek pjesa e shpinës sepse mendoj që kam
7 parë një fotografi më të mirë.

8 PY. Po, do ta tregojmë edhe atë.

9 PË. Po. Gjithashtu kemi një përzierje të lividitetit në
10 shpinën e personit të vdekur, kemi mungesë ngjyre ose kemi
11 shpërndarjen e ngjyrës së purpurt. Por, mbi atë shikojmë të
12 paktën disa mavijosje. Në qoftë se nuk është, nuk janë
13 gërvishtje, quhen më tepër duken si mavijosje. Dhe kemi
14 gjithashtu dhe gërvishtje të lëkurës në pjesën e sipërme të
15 shpinës, që është me ngjyrë më të errët se sa zonat e tjera.

16 PY. Nga e dalloni ju që është mavijosje kjo?

17 PË. E dalloj që është mavijosje, dhe jo vetëm kaq, por ka dhe
18 një lloj gërvishtjeje apo abrazioni të lëkurës që shkaktohen
19 zakonisht nga trauma, domethënë, zakonisht shkaktohet kur
20 dikush qëllohet me diçka, me një instrument të fortë. Pra, nuk
21 është shkaktuar nga një thikë ose nga plumb, por është
22 shkaktuar nga një instrument i fortë, pra është gjuajtur
23 viktima.

24 PY. Në të njëjtin dokument --

25 Z. PACE: [Përkthim] Nuk është e nevojshme që të tregojmë

1 një tjetër fotografi të të njëjtit trup, por do kërkoja që të
2 kalonim në dokumentin 189126. Le të shikojmë këtë fotografi në
3 fillim të faqes.

4 PY. Dëshmitar, ju lutem na tregoni ose na përshkruani se
5 çfarë shihni këtu. E kuptoj që ndoshta mund të jetë pak a
6 shumë situata siç pamë në rastin e mëparshëm, por do të doja
7 që të na e shpjegonit edhe këtë fotografi.

8 PË. Është diçka shtesë që mund të shohim këtu. Pjesa e
9 sipërme e trupit, shpinës, kryesisht në pjesën e djathtë,
10 është e çngjyrosur, pra shihet qartë mavijosja. Në pjesën e
11 mesme të shpinës, dy anët, ka vija diagonale. Dy vija paralele
12 diagonale dhe dy në anën e majtë, në mënyrë diagonale. Këto
13 janë ato që ne i quajmë mavijosje, vijat e mavijosjes. Pra, që
14 janë të shkaktuara nga -- shkaktuar kur dikush goditet nga një
15 objekt i gjatë, për shembull, tyta e një arme, send i gjatë i
16 hollë që shkakton vija paralele mavijosjeje.

17 PY. Me ndihmën e -- ndihmës së Asistentes së Gjykatës, a mund
18 të shënoni aty atë që ju përkufizoni që -- pra, dhe shkruani
19 në ekran, pjesët i përshkruani si vijat e mavijosjes, pra.

20 PË. Do të vizatoj rrethet, t'i fus në rreth aty. Ky është
21 njëri, dhe tjetri është këtu.

22 Z. PACE: [Përkthim] Do të dorëzojmë këtë dokument për
23 praninë si provë, dhe fotografinë e marrë nga ekрани.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A dëshironi
25 që t'i jepet një numër provizor?

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 89

1 Z. PACE: [Përkthim] Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 189126 t'i
3 jepet një numër provizor.

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Këto
5 shënime të bëra do të ruhen si REG01200 dhe do t'u jepet numër
6 provizor provës P01993. Faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne e kemi një
8 1993 [Sipas përkthimit], do t'i vendosni së bashku? Do t'i
9 bashkoni?

10 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
11 këshillohen]

12 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Në qoftë se mund të
13 kalojmë tani tek, të rishohim një imazh përsëri nga i njëjti
14 dokument në faqen 189124.

15 Z. PACE: [Përkthim] Po, faleminderit. Të zmadhojmë
16 imazhin. Pak më poshtë. Në rregull.

17 PY. Dëshmitar, a mund të na thoni çfarë shihini në këtë
18 imazh?

19 PË. Gjëja kryesore që shoh janë të paktën dy mavijosje
20 lineare, që kalojnë përmes pjesës së sipërme të gjoksit. Janë
21 pjesë të errëta.

22 Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, a mund ta zmadhojmë
23 pak pjesën e gjoksit? Faleminderit.

24 PY. Mund të vazhdoni, Dëshmitar.

25 PË. Shihen këto zonat e errëta. Vijat janë me shumë gjasa

1 vija të shkaktuara nga goditje, pra trauma, shkaktuar nga një
2 objekt i gjatë që ka goditur trupin. Kemi dhe një më të vogël,
3 një shenjë në hundën e tij.

4 PY. Duke u përqendruar tek plaga që përshkruat në zonën e
5 gjoksit, sipas jush, plagë të tilla a mund t'i shkaktojnë dëme
6 organeve të brendshme të viktimës?

7 PË. Ka shumë pak gjasa, ka pak gjasa. Mund të ketë plagë të
8 tjera që ne nuk i shohim poshtë, por mund të jetë, më së
9 shumti mund të shkaktojë ndonjë brinjë të thyer, por nuk ka --
10 ka shumë pak gjasa që të dëmtojë organet e brendshme.

11 PY. Në fotografinë që shohim, dhe zmadhuam, shohim që viktimia
12 është ulur. A mund të na thoni diçka lidhur me këtë viktimë më
13 shumë se sa me fotografitë e viktimave të tjera? Nëse viktimia
14 mund të ketë i ulur kur ka vdekur, apo më vonë?

15 PË. Duke menduar tani për mënyrën se si janë pjesët livide
16 dhe *rigor mortis* është tërësisht e mundur që ai ka qëndruara
17 në atë karrige pas vdekjes. Pra, po, në qoftë se nuk ka vdekur
18 i ulur në karrige, ka qëndruar aty pas vdekjes, duke pasur
19 parasysh zhvillimet e *post-mortem*.

20 PY. Pra, nuk ka vdekur -- nëse nuk ka vdekur në karrige do të
21 thotë që e kanë zhvendosur në karrige pak kohë më pas?

22 PË. Kjo është shpjegimi i logjikshëm.

23 PY. Bazuar në fotografitë e ndryshme të kësaj viktime që pamë
24 sot, a ka diçka që patë ju që mund të tregojë që viktimia ka
25 vdekur, kur ka vdekur viktimia që është, mund të, krahasuar me

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 91

1 momentin kur janë marrë, bërë këto fotografi?

2 PË. Për disa orë besoj që viktima ka qenë e vdekur, jo
3 menjëherë. Mund të jenë disa orë, nuk mendoj që bëhet fjalë
4 për ditë. Sepse nuk kemi shenja të kalbëzimit.

5 Z. PACE: [Përkthim] Ta heqim këtë dokument.

6 PY. Dëshmitar, a mund të shpjegoni shkurtimisht, kur flisni
7 për çfarë do të thotë predhë e shtuar -- e goditur.

8 PË. Nuk jam i sigurt që mund ta shpjegoj këtë. Imagjinoj që
9 është një predhë që shkon tek një pikë. Shkon në drejtim të
10 një pike.

11 PY. Tani kur bëhet fjalë për terma që ju përdorni në
12 praktikën tuaj, a ka ndonjë term të veçantë që përdorni kur
13 përshkruani një predhë që shkon drejt një pike të caktuar?

14 PË. Predhë me një majë të mprehur, kaq.

15 PY. Faleminderit.

16 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me sa kuptoj,
18 znj. Rowan do jeni e para. Do filloni ju.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po. Mendoj që do të vazhdojmë
20 sipas të njëjtin rend siç bëmë me dëshmitarin ekspert të
21 fundit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

23 Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan:

24 PY. Z. Clark, mirëdita.

25 PË. Mirëdita.

1 PY. E di që kur jeni takuar me ZPS-në javën e kaluar, një
2 prej gjërave të para që keni pyetur ZPS-në ishte që nëse
3 Mbrojtja do bënte pyetje apo jo. Ndoshta mund të filloj me
4 këtë.

5 PË. Po, ishte thjesht interes i përgjithshëm, kështu.

6 PY. Ajo që do të doja të bisedoj, diskutoj, me ju sot, është
7 që së pari të shohim udhëzimet që keni marrë nga Prokuroria,
8 ajo që ju është kërkuar të bëni, dhe ajo që nuk ju është
9 kërkuar të bëni. Dhe pak lidhur me patologjinë si shkencë, për
10 të kuptuar terminologjinë, gjërat që ju ka bërë, pyetjet që ju
11 ka bërë dhe Prokuroria, dhe pastaj të shohim pak raportin
12 tuaj, të shohim më në hollësi gjetjet, konstatimet që keni
13 bërë, dhe të hymë më në hollësi të komenteve që keni bërë dhe
14 konstatimeve. Së pari, sa i përket udhëzimeve, a është e saktë
15 që fillimisht jeni udhëzuar nga Prokuroria në këtë lëndë në
16 2021?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe në karrierën tuaj profesionale keni përvojë shumë të
19 gjatë në Ballkan, nuk jeni përfshirë megjithatë në raste të
20 cilat ju është kërkuar të ekzaminoni nga Prokuroria?

21 PË. E saktë.

22 PY. Siç u bë pyetja dhe nga Prokuroria, është e saktë që juve
23 ju janë dhënë, është dhënë një paketë materialesh për të
24 plotësuar udhëzimet?

25 PË. Po.

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 93

1 PY. Dhe kjo paketë materialesh kishte të bënte me dhjetë
2 persona të vdekur, dhe raportet lidhur me ta?

3 PË. Po. Mendoj që ishin dhjetë.

4 PY. Jemi marrë edhe me -- u morëm sot edhe me një person të
5 njëmbëdhjetë të vdekur, sot. Tani për qartësi të
6 procesverbalit, nuk keni bërë asnjërin prej atyre autopsive
7 origjinale?

8 PË. Jo.

9 PY. Nuk keni qenë i pranishëm kur janë bërë ato autopsi?

10 PË. Jo.

11 PY. Nuk keni patur asnjë rol mbikëqyrës kur janë bërë këto
12 autopsi apo prapa?

13 PË. Jo.

14 PY. Kjo do jetë një prej paralajmërimeve që do marrë shpesh -
15 - besoj se duhet të ngadalësoj, të flas më ngadalë.

16 A ju është bërë e qartë juve, z. Clark, sa u përket
17 udhëzimeve se Prokuroria në këtë çështje do të thërrisnin
18 patologun, por ju kërkuan juve që të shihni këto raporte, se
19 nuk do të thërrisnin patologun të jepte dëshmi?

20 PË. Kështu e kam kuptuar.

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim letrën
22 me udhëzime që ju është dërguar, jo për publikun. Pra, me
23 numër provizor 1990. Ta shfaqim në ekran.

24 PY. Z. Clark, pyetjet që do t'ju bëj lidhur me këtë letër
25 përqendrohen kryesisht në letrën e zezë të vetë letrës. Kuptoj

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 94

1 që ju i jeni përgjigjur pyetjeve në raportin tuaj, kur keni
2 menduar që është e nevojshme të bëhet kjo punë. Keni dhënë
3 mendimin tuaj që ju është kërkuar. Do të doja të
4 përqendroheshim saktësisht në atë që ju është kërkuar nga
5 Prokuroria.

6 E keni një kopje të kësaj letre me juve, me vete apo
7 shikoni në ekran?

8 PË. Nuk e kam këtu, por e shoh në ekran.

9 PY. Në rregull. Këtu e shihni që është letra ku janë dhënë
10 udhëzimet fillestare dhe mban edhe datën aty në anën, sipër në
11 anën e majtë?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe në terma të përgjithshëm, pika II ju kërkohet mendimi
14 juaj i pavarur lidhur me pyetjet që ju përmban Shtojca 1.

15 PË. Po.

16 PY. A ju është shpjeguar juve në ndonjë fazë të shkëmbimeve
17 tuaja me Prokurorinë që roli juaj në këtë procedurë është si
18 ekspert i pavarur.

19 PË. Kjo është, kjo kuptohet.

20 PY. Dhe ju e kuptuat që kështu ishte?

21 PË. Po.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
23 do të shkoni më ngadalë.

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

25 PY. Meqenëse po flasim anglisht, po harroj që të bëj pak

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 95

1 pushim mes pyetjeve dhe përgjigjeve tuaja, që t'ju jap kohë
2 përkthyesve për të përkthyer.

3 PY. Z. Clark --

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] A mund të shfaqim tani, faqen 3?

5 PY. Këtu shohim, detyra e parë që ju është dhënë juve nga
6 Prokuroria, është që të ndihmoni të gjejmë, të ndihmoni në
7 kuptimin e disa termave mjekësorë dhe të ndihmoni në mënyrën
8 se si funksionon patologjia në përgjithësi.

9 PË. Po.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Dhe pastaj kalojmë në faqen
11 tjetër. Faleminderit.

12 PY. Pastaj juve ju është kërkuar sa i takon, kjo referuar
13 materialit që ju është dhënë, që të përgjigjenit pyetjeve të
14 caktuara nga Prokuroria.

15 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër. Shohim
16 një shembull të këtyre.

17 PY. Këtu shohim një shembull të disa pyetjeve konkrete që ju
18 janë bërë nga Prokuroria. Është kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Pastaj shohim raportin tuaj, raporti juaj ndjek këtë
21 strukturë, strukturën e pyetjeve të bëra nga Prokuroria.

22 PË. Po.

23 PY. Pra, ajo që keni bërë në raportin tuaj, i jeni përgjigjur
24 pyetjeve që ju ka bërë Prokuroria?

25 PË. Po.

1 PY. Tani, lidhur me atë që Prokuroria nuk ju ka kërkuar të
2 bëni, në këtë raport a është e saktë që juve nuk ju është
3 kërkuar nga Prokuroria që të jepni komente lidhur me cilësinë
4 e punës mbi të cilën mbështeten këto?

5 PË. Në qoftë se kthehemi te faqja 1 e udhëzimeve --

6 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Z. Sekretar, në qoftë se mund të
7 na ndihmoni, është versioni PDF, përfundon me 430. Pak më
8 poshtë. Ta zmadhojmë, dhe pak më poshtë.

9 PY. Z. Clark, na tregoni ku duhet të shikoni. A është rreshti
10 i fundit i këtij paragrafi pas pikës së zezë? Ku thotë që:

11 "Në qoftë se ka diçka, informacion shtesë, përtej këtyre
12 pyetjeve, që ju mendoni është i, mund të sjellë qartësi, mund
13 ta përfshini."

14 PË. Po.

15 PY. Ajo që po ju bëj pyetje unë, janë pyetjet që janë dhënë
16 sipas udhëzimeve, krahasuar me përgjigjet që keni dhënë ju.

17 PË. Po.

18 PY. Duhet të jem e qartë që në -- ajo që ju është kërkuar
19 shprehimisht të bëni, këtë dua të jetë në procesverbal.

20 PË. Po. Por, unë kam kuptuar nga kjo, që në qoftë se ndjeja
21 që kishte çështje të tjera që meritonin të jepja komente,
22 kisha të drejtë ta bëja këtë gjë.

23 PY. Dhe e keni bërë këtë?

24 PË. E kam bërë.

25 PY. Sa u takon pyetjeve që ju janë bërë, lidhur me analizën e

1 raporteve mbështetëse -- raportet që janë, analizat që janë
2 bërë nga të tjerë, një gjë që nuk ju është kërkuar juve të
3 bëni është që të komentoni mbi cilësinë e këtyre raporteve.

4 Z. PACE: [Përkthim] Kjo pyetje u bë dhe u përgjigj, dhe
5 Mbrojtja po bën një dallim artificial mes asaj që është
6 kërkuar dhe nuk është kërkuar.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbështetet.

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

9 PY. Nuk ju është kërkuar që të bëni një autopsi të dytë të
10 këtyre personave?

11 PË. Jo.

12 PY. Nuk ju është kërkuar na pajtoheshit apo nuk pajtoheshit
13 me konstatimet dhe përfundimet që ishin në ato autopsi?

14 PË. Jo.

15 PY. Nuk ju është kërkuar të konfirmoni saktësinë, vërtetësinë
16 e këtyre gjetjeve?

17 PË. Jo, konkretisht.

18 PY. Nuk ju është kërkuar nëse do të arrinit ju të njëjtat
19 përfundime apo konstatime, është kështu? Që ju do t'i
20 konsideronit, që ju do të arrinit në të njëjtin përfundim?

21 PË. Në kuptimin që më është kërkuar që të bëj komente mbi
22 konstatimet, gjetjet, dhe çështjet e tjera që më janë, ishin
23 të rëndësishme, sipas pikëpamjes time, kisha të drejtën të
24 bëja komente siç i kam bërë.

25 PY. Po. Dhe kur keni menduar që është e nevojshme të

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 98

1 shprehnit mendimin tuaj mbi konstatimet dhe gjetjet, e keni
2 bërë siç është në raport?

3 PË. Po.

4 PY. Sa i takon nëse -- ta filloj dhe një herë pyetjen.

5 Prokuroria nuk ju ka kërkuar shprehimisht nëse ju kundërshtoni
6 konstatimet në raport?

7 PË. Jo.

8 PY. Nuk ju kanë kërkuar që të përshkruani për ta në raportin
9 tuaj ndonjë gabim apo probleme që ju keni identifikuar në
10 raportin e analizës?

11 PË. Jo.

12 PY. Në fakt e keni bërë këtë gjë, por nuk ju është kërkuar që
13 ta bëni?

14 PË. E kam bërë.

15 PY. Unë po përpiqem të kuptoj se çfarë ju është kërkuar dhe
16 çfarë nuk ju është kërkuar.

17 PË. Më lejohej të bëja një gjë të tillë, dhe kam menduar që
18 ndihmoj duke e bërë këtë gjë, dhe për këtë e kam bërë.

19 PY. Pyetja ime është ajo që ju është kërkuar apo jo për të
20 bërë, dhe ajo që nuk ju është kërkuar për të bërë.

21 PË. Në rregull.

22 PY. Tani --

23 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mund ta heqim këtë nga ekrani.

24 PY. Në raportin tuaj ju keni ndjekur të njëjtin, rendin e
25 pyetjeve siç është parashtruar nga Prokuroria. Dhe në fillim

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 99

1 të secilës pjesë për personin e vdekur, ju keni dhënë një
2 përmbledhje, keni bërë një përmbledhje të konstatimeve?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe tani, që të jemi të qartë, kjo përmbledhje, a e
5 kuptoj mirë, a është e saktë që nuk është përmbledhja e
6 konstatimeve tuaja, është konstatimi, është përmbledhja e
7 konstatimeve të autopsive që ju janë dhënë juve?

8 PË. Është interpretimi im -- përmbledhje e interpretimit tim
9 të konstatimeve.

10 PY. Përmbledhja e konstatimeve që keni kuptuar ju në raport.

11 PË. Po.

12 PY. Sa i takon materialit që ju është dhënë nga Prokuroria,
13 shoh -- kur shohim fotografitë, fotografitë janë diçka që
14 zakonisht shoqërojnë një raport të shkruar të autopsisë?

15 PË. Po.

16 PY. Si pjesë e materialit që ju është dhënë, ju janë dhënë
17 fotografitë, pjesë e materialit?

18 PË. Jo. Për pesë, gjashtë raste kur kishte të shtëna me armë
19 zjarri, aty ishte, kishte fotografi të vendngjarjes, por jo të
20 autopsisë.

21 PY. Ju sapo -- kjo ishte pyetja ime e radhës. Për disa prej
22 atyre fotografive cilësia e disa fotografive është e dobët.

23 PË. Në çështjet e dyta që i kam parë, cilësia e fotografive
24 është shumë e dobët. Janë dy gjëra, cilësia e fotografisë, apo
25 cilësia e kopjes së fotografisë që janë bërë disa fotokopje.

1 PY. Shumë prej fotografive që ju janë dhënë nuk ishin imazhe
2 digjitale apo origjinale, por ishin fotokopje të shumta të
3 imazheve origjinale.

4 PË. Unë i kam kushtuar pak vëmendje fotografive në fakt.

5 PY. Dhe sepse nuk ju ndihmonin shumë.

6 PË. Ashtu është.

7 PY. Dhe siç e përmendët, në këtë rast kemi një koleksion, një
8 paketë, kemi disa persona të vdekur që janë ekzaminuar së
9 bashku. Dhe për ta nuk kemi fotografi të autopsisë?

10 PË. Kështu e kuptoj edhe unë.

11 PY. Juve nuk ju janë dhënë?

12 PË. Jo.

13 PY. Dhe ju janë dhënë disa fotografi e vendngjarjeve?

14 PË. Po.

15 PY. Për një numër të raporteve të autopsisë, që ishin të
16 kufizuara në përmbajtje, sa i takon përmbajtjes?

17 PË. Nuk ishin raporte autopsie të dobët. Natyrisht ka
18 standarde të ndryshme të raporteve, përmbanin shumë
19 informacion. Nuk është detyrimisht mënyra se si, ose stili që
20 unë do i -- si do i përpiloja, por ishin të arsyeshëm. Kishte
21 informacion, mungonte disa -- ajo që mungonte si informacion,
22 mendoj unë, ishte interpretimi.

23 PY. Ju keni identifikuar një numër problemesh që është -- dhe
24 i keni shprehur këto në raportin tuaj të interpretimit.

25 PË. Konstatimet ishin të tilla, gjetjet ishin të dokumentuara

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 101

1 mjaftueshëm, në mënyrë të arsyeshme.

2 PY. Për analizën tuaj, ju keni arritur në përfundimin se aty
3 kishte informacion të mjaftueshëm për ju, që ju të bëni
4 komente lidhur me përmbajtjen e tyre.

5 PË. Po.

6 PY. Për aq sa ju kërkohej juve.

7 PË. Po.

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ndoshta mund të bëjmë pushimin
9 tani.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
11 t'ju japim pushim në drekës tani. Do kthehemi në orën 14.30.
12 Mos diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj në
13 Gjykatë.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pushim deri
16 në orën -- bëjmë pushimin e drekës deri në orën 14.30.

17 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

18 --- Seanca rifillon në orën 14.33

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi pasur
20 një debat për orën e konferencës së ditës së sotme, 4.00 apo
21 4.30. Unë synoja që ta fillonim në orën 4.30. juve si ju
22 kujtohen?

23 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në fakt dhe ne kuptuam në orën
24 4.00 dhe ne menduam që do fillojmë Konferencën për Ecurinë e
25 Çështjes në orën 4.00. Unë nuk e di kush e ka çuar këtë

1 njoftim. Mua kështu më kanë thënë që fillojmë në orën 4.00.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, do ta
3 bëjmë në orën 4.00 atëherë.

4 Z. PACE: [Përkthim] Dhe në kështu e kuptojmë, ju thatë në
5 orën 4.00. Dëshmitari tjetër, sidoqoftë, nuk mund të japë
6 dëshmi sot, do japë dëshmi vetëm nesër. Kemi marrë përkthyes
7 apostafat për dëshmitarin tjetër. Do të ishte mirë mbase --
8 mirë do ishte në fakt t'i kërkonim këtij dëshmitarit që të
9 bënim gjysmë ore më shumë sot.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ne nuk kemi asnjë pyetje për
11 dëshmitarin e nesërm ose mbase shumë pak. Sidoqoftë jemi në
12 duart tuaja.

13 Z. PACE: [Përkthim] Jo, problemi është që me dëshmitarin
14 aktual kemi ende dhe një katër orë e gjysmë.

15 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në qoftë se mbarojmë në orën 4.00
16 sot, unë ju premtoj që nesër do i përfundojmë të dy
17 dëshmitarët.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kur do
19 përfundoni?

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Unë do përfundoj para orës 4.00.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më mirë
22 punojmë deri në 4.30 atëherë sot. Ju kërkoj ndjesë për
23 ngatërresën që paskam shkaktuar unë, po unë jam i moshuar në
24 fund të fundit.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po në 2.30 atëherë do bëjmë

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 103

1 pushimin?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Si zakonisht? Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
5 sillni dëshmitarin në sallë.

6 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
7 këshillohen]

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Z. Clark, fjalën e ka ende znj. Rowan me pyetjet e saj.

11 Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan:

12 PY. Mirëdita, z. Clark.

13 PË. Mirëdita.

14 PY. Z. Clark, ju jeni patologu i parë që ka ardhur për të
15 dhënë dëshmi këtu dhe do të doja të na ndihmonin me çështjet
16 më bazike të kësaj fushe, ju lutem, të kuptojmë qoftë dhe
17 terminologjinë që do të përdorim. Ju mund të na ndihmoni për
18 këtë. Patologët sigurisht që janë mjekë?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe specialiteti juaj është mekanika e lëndimeve apo
21 vdekjes?

22 PË. Patologu në përgjithësi është një person që studion
23 sëmundjet e ndryshme dhe veçanërisht pse vdesin njerëzit. Edhe
24 ka pastaj nëndarje në patologjinë forensike që është një
25 fushë, një disiplinë që trajton mënyrën se si vdesin njerëzit

1 dhe rrethanat se si kanë vdekur.

2 PY. Ky është nënspecialiteti juaj?

3 PË. Po, ky është nënspecialiteti im.

4 PY. A mund të na shpjegoni çfarë është mekanizmi i vdekjes?

5 PË. Është mënyra fizike se si vdes dikush, shkaku i vdekjes.

6 Besoj që ju doni të kuptoni pak për mënyrën e vdekjes. Mënyra

7 e vdekjes dallon dhe kjo nuk është detyrë e patologut. Ka

8 mjekë të tjerë që e përcaktojnë këtë.

9 Shkaku i vdekjes, për shembull, mund të jetë lëndim në
10 kokë, lëndim me armë zjarri në kraharor. Mënyra e vdekjes mund
11 të thuhet, për shembull, ka qenë aksident, ka qenë vrasje, ka
12 qenë aksident.

13 PY. Ju fakt iu përgjigjët tri prej pyetjeve të mia dhe
14 faleminderit që e zbërthyet kaq mirë. Pra, mekanizimi i
15 vdekjes -- kemi pra, mekanizmin e vdekjes dhe mënyrën e
16 vdekjes.

17 PË. Po.

18 PY. Mekanizmi i vdekjes është specialiteti juaj si patolog,
19 apo jo?

20 PË. Po, shkaku i vdekjes.

21 PY. Në fakt kjo është -- ne na intereson shkaku i vdekjes.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po flisni
23 njëkohësisht dhe po flisni shumë shpejt. Nuk dua t'ju ndërpres
24 gjithë kohën. Ju lutem, ngadalësoni dhe bëni një pazë.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] E kuptoj këtë gjë.

1 PY. Sikurse dhe ju thatë, zakonisht mënyra e vdekjes është
2 një fushë që trajton një mjek, një person tjetër, një
3 specialist tjetër.

4 PË. Po.

5 PY. Çfarë është raporti i autopsisë? Çfarë përmban një raport
6 autopsie?

7 PË. Autopsia është thjeshtë ekzaminimi i trupit të dikujt pas
8 vdekjes dhe bazuar në këtë, patologët shohin pastaj gjetjet e
9 jashtme dhe gjetje të brendshme, edhe bazuar në këto
10 përgatisin një raport ku pasqyrojnë të gjitha gjetjet.

11 Zakonisht në fund të raportit përfshihen edhe konkluzionet.

12 PY. Sa i takon dy aspekteve që sapo përmendët, raporti i
13 autopsisë sipas jush, duhet të përmbajë gjetjet dhe
14 përfundimet e një patologu?

15 PË. Po.

16 PY. Të gjitha këto janë opinione të një eksperti, specialisti
17 apo jo? Opinione të një patologu.

18 PË. Gjetjet jo domosdoshmërisht, nuk janë gjetje të një
19 specialiteti, janë thjesht opinione. Pjesa bazike e raportit
20 të një patologu është të koordinojë apo të zbardhë gjetjet. Më
21 pas merren ekspertë të cilët duhet të analizojnë këto gjetje.

22 PY. Pra, ju do të hidhnit faktet, do të komentoni bazuar në
23 ekspertizën tuaj dhe nxirrni konkluzione bazuar në këto
24 gjetje?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe këto si rregull duhet të jenë të përfshira në një
2 raport autopsie?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe ky është qëllimi i këtij raporti?

5 PË. Po.

6 PY. Ne kemi parë dhjetë raporte autopsie deri tani dhe
7 lëndimet kryesore që pamë ne janë ose lëndime për shkak të
8 traumës që është shkaktuar me forcë ose plagë me armë zjarri.

9 PË. Po.

10 PY. Mbase mund të duket shumë pyetje e kuptueshme kjo, por
11 çfarë është një plagë me armë zjarri?

12 PË. Plagë me armë zjarri është një plagë që shkaktohet nga
13 një plumb apo nga baruti që hyn në trup dhe shkakton lëndim.

14 PY. Tani sa i takon traumës që shkakton forca. Është diçka që
15 e godet trupin apo trupi godet një send, një objekt.

16 PË. Po.

17 PY. Kur një objekt godet trupin, për shembull, mund të jetë
18 goditur me grusht, mund të shkaktojë kjo trauma të kësaj
19 lloji?

20 PË. Po.

21 PY. Ose për shembull, mund -- kur godet dikë me një vazo me
22 një shishe a mund të quhet dhe kjo traumë e shkaktuar nga
23 forca?

24 PË. Po.

25 PY. Nëse bie në dysHEME, edhe kjo mund të shkaktojë trauma?

1 PË. Po.

2 PY. Pra, ekzistojnë mënyra të ndryshme se si trupi mund të
3 pësojë trauma?

4 PË. Po.

5 PY. Në mënyrë që të bëhen përfundime në lidhje me këtë, një
6 person që është ekspert i fushës tuaj duhet të analizojë
7 lëndimet dhe të dalë në përfundimin pse janë shkaktuar këto
8 lëndime?

9 PË. Nuk ka tamam një përgjigje për këtë. Një mavijosje është
10 një -- mavijosje mund të shkaktohet nga qindra mënyra, por ne
11 shohim a është mavijosje e freskët, a është tri, katër ditë e
12 vjetër, a mund të jetë shkaktuar, mund të jetë shkaktuar në
13 mënyra të ndryshme kjo mavijosje.

14 PË. Mavijosja është një nga treguesit, por jo treguesi i
15 vetëm i forcës së ka pësuar një trup, apo jo?

16 PË. Jo. Më lejoni t'ua shpjegoj. Ne njohim tre lloj lëndimesh
17 që i shkakton kjo lloj force. Një është goditja me një me --
18 është goditja e një sipërfaqeje dhe hiqet sipërfaqja e
19 lëkurës.

20 PY. Ndalojmë këtu. Ju thatë "gërvishtje e lëkurës". Si mund
21 të shkaktohet kjo gërvishtje? Kjo mund të shkaktohet kur një
22 objekt bie në kontakt me lëkurën, apo jo?

23 PË. Zakonisht është një sipërfaqe e ashpër që fërkohet pas
24 lëkurës.

25 PË. Një shembull i mirë mbase mund të kishte qenë kjo: Jemi

1 në Holandë, njerëzit këtu janë me biçikleta gjithë kohën,
2 dikush rrëzohet dhe i gërvishtet lëkura. Pra, kemi gërvishtje
3 të lëkurës nga kontakti me asfaltin, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. E dyta është mavijosja. Është shkulje ose është dëmtim --
6 dëmtim i indeve të gjakut nën lëkurë edhe për shkak të
7 dëmtimit të enëve të gjakut - më falni - shkaktohet mavijosja.

8 Dhe e treta është lacidim [Sipas përkthimit]. Quhet --
9 është momenti kur hapet lëkura. Edhe zakonisht shkon e çara
10 deri në eshtra, për shembull, nëse e godet dikë në krah,
11 atëherë dëmtohet lëkura. Nëse godet dikë në kokë, po ashtu,
12 hapet lëkura derisa duken eshtrat e kokës.

13 PY. Ju në fakt një shembull shumë të mirë e dhatë dhe me
14 vetullat. Një shembull i mirë kur shikon boksierët, për
15 shembull, boksierët janë një shembull më i mirë për të
16 ilustruar faktin se si një goditje në fytyrë mund ta çajë
17 lëkurën deri në dukjen e eshtrave.

18 PË. Në qoftë se, për shembull, në qoftë se godasim dikë në
19 krah, kjo shkakton vetëm mavijosje, po aty ku ka eshtra, ka
20 çarje më të thellë të lëkurës.

21 PY. Pra, kemi tre opsione -- kemi tre alternativa, thamë.

22 PË. Këto mund të ndodhin në *de facto* në të njëjtën kohë me të
23 njëjtin ndikim.

24 PY. Mund të kemi një, mund t'i kemi të gjitha.

25 PË. Po.

1 PY. Po mund të kemi dhe një katërt ama, që mund ta shkaktojë
2 nga kjo lloj traume, që është lëndimi i eshtrave?

3 PË. Po, është edhe kjo. Ka lëndime të brendshme, dhe lëndime
4 të jashtme. Po, keni të drejtë.

5 PY. A mund të na tregoni si mund të ndodhi kjo? Një traumë e
6 këtij lloji, si mund ta shkaktojë këtë lloj lëndimi?

7 PË. Duhet të jetë forcë shumë e madhe, shumë e madhe. Për
8 shembull, nëse dikush bën një aksident rrugor, mund t'ju
9 thyhen brinjët apo eshtrat apo gjymtyrët nëse dikush, për
10 shembull, goditet në kokë me diçka të rëndë, me një objekt të
11 rëndë kjo mund të çajë kafkën e kokës. Për shembull, dikush që
12 rrëzohet me kokë pas me pjesën e pasme të kokës, dhe kjo mund
13 të krijojë një çarje të kokës, po flasim pjesë -- që është
14 pjesë më e thellë.

15 PY. Po lëndimi i eshtrave si rregull tregon që trauma ka qenë
16 e një shkalle shumë më të lartë sa që ka shkaktuar atë lloj
17 lëndimi?

18 PË. Po, po. Nuk mund të arrihet ai lloj dëmtimi me një
19 grusht. Duhet të jetë diçka shumë herë më e fortë, goditje
20 shumë herë më e fortë.

21 PY. Faleminderit.

22 Tani mbetjet e skeletit. Shumica, por jo të gjitha,
23 gjysma e trupave që ju patë ju ishin vetëm skeleta -- skelete,
24 më falni, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. A është e mundshme -- a është e mundshme t'i bëhet
2 autopsi një skeleti?

3 PË. Absolutisht, po.

4 PY. Dhe patologët merren edhe me trupa me freskët edhe me
5 skelete, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Por kur vjen puna për kufizimet, a pajtoheni ju me mua që
8 si patolog, i keni më të pakta mundësitë me një skelet,
9 krahasuar me një trup të sapovdekur, sa i takon gjetjeve që
10 mund të bëni?

11 PË. Po, keni të drejtë.

12 PY. Sepse sigurisht kur ke një trup të porsavdekur ka, ja --
13 është ende lëkura, janë ende indet e buta, dhe kjo të jep
14 mundësinë ta ekzaminosh më thellë për t'u kuptuar lëndimet dhe
15 sëmundje se ç'ke me një skelet që ka thjesht eshtrat.

16 PË. Po.

17 PY. Cilat janë pasojat për ju si patolog në një rast të
18 tillë, kur doni të përcaktoni shkakun e vdekjes dhe kur do të
19 duhet të analizoni organet e brendshme?

20 PË. Shumica e personave që vdesin ose vdesin nga sëmundje të
21 natyrshme ose kushte që prekin indet e buta të trupit.

22 Sigurisht që ne duam të marrim dhe mostra gjaku për t'i bërë
23 analiza dhe procedura të tjera, për këtë na duhen indet e
24 buta. Nëse mungojnë të gjitha këto, atëherë nuk kemi shumë
25 informacion për të përcaktuar shkakun e vdekjes.

1 Por, nëse fokusohemi tek trauma, shpesh trauma prek
2 eshtrat edhe eshtrat mbeten. Indet e buta zhduken, por eshtrat
3 mbeten. Edhe ne mund të gjejmë traumën që kanë pësuar eshtrat
4 dhe mund të bëjmë një analizë.

5 PY. Në rregull. Kur shikoni mbetjet skeletore, ju fokusoheni
6 për të gjetur traumë në eshtra me aq sa të keni mundësi?

7 PË. Vetëm kaq mund të bëjmë. Duhet të shohim eshtrat.

8 PY. Nëse ky person kur ka qenë në jetë ka pësuar lëndime që
9 nuk kanë prekur eshtrat, ju nuk jeni në gjendje të përcaktoni
10 shkakun për shkak të skeletit?

11 PË. Nuk ju kuptova.

12 PY. Faji im, mënyra se si e formulova pyetjen. Atëherë, edhe
13 një herë. Në qoftë se ju do të keni thjesht një skelet, ju nuk
14 e bëni dot analizën të plotë në qoftë se nuk ka dëmtim të
15 eshtrave?

16 PË. Po.

17 PY. Ju thatë vdekje nga shkaqet natyrore. Për shembull, ju
18 thatë që një person mund të ketë vdekur për shkak të një sulmi
19 në zemër, dhe ju nuk e ekzaminoni dot zemrën, përmasat e
20 zemrës, kohën e vdekjes, dhe ju në këtë rast nuk e përcaktoni
21 dot shkakun e vdekjes se mungojnë indet e buta, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Atëherë, sa i takon autopsive skeletore, fokusohemi tek
24 eshtrat. A pajtoheni ju me mua që analizimi i eshtrave në
25 situata të tilla është shumë i vështirë sepse është e

1 rëndësishme edhe jetëgjatësia e eshtrave sepse ndonjëherë edhe
2 eshtrat degradojnë me kalimin e kohës?

3 PË. Në fakt eshtrat nuk -- nuk ndryshojnë shumë gjatë --
4 shumë -- me përjashtim të rasteve kur janë mijëravjeçare apo
5 shumëjavjeçare. Shumë shekullore, më falni. Vështirësia me
6 traumën e eshtrave është trauma e shkaktuar prej goditjeve.
7 Për shembull, mund të ketë qenë aksident, mund të jetë rrëzuar
8 personi, apo mund të ketë pasur lëndim për shkak të goditjes
9 me armë zjarri që ka shkaktuar një çarje të eshtrave.

10 Në shumicën e rasteve ne e bëjmë këtë dallim. Jemi në
11 gjendje. Kur hyn një plumb në eshtra apo godet eshtrat,
12 zakonisht krijon një model karakteristik, dhe ne arrijmë ta
13 dallojmë këtë. Nëse eshtra ka pasur një goditje apo një
14 rrëzim, zakonisht dëmtimi është i pastër, nuk është i
15 vështirë, dhe në këtë rast ne e kuptojmë dhe e bëjmë dallimin
16 mes lëndimit nga goditja me armë zjarri dhe nga goditja.

17 Po sigurisht që nuk është kaq e thjeshtë.

18 PY. Edhe sigurisht që është shumë herë më e vështirë kur nuk
19 e ke trupin të plotë?

20 PË. Po, sigurisht.

21 PY. Veshjet, veshjet po ashtu janë të rëndësishme për gjetjet
22 patologjike, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. A ndodh kjo sepse ndonjëherë veshjet, për shembull, kur
25 dikush është goditur me thikë apo me armë zjarri, veshjet të

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 113

1 ndihmojnë për shkak të shenjave që kanë lënë këto goditje, apo
2 jo?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe sigurisht veshjet jo gjithmonë, por shpesh mungojnë
5 tek mbetjet skeletore, apo jo?

6 PË. Ose janë të dëmtuara pas vdekjes dhe kjo krijon probleme.

7 PY. Mbase mund të jenë kaq të degraduara, kaq të dëmtuara
8 saqë nuk ju ndihmojnë fare për të nxjerrë konkluzione?

9 PË. Po.

10 PY. Mbase kjo edhe për shkak të mënyrës se si është varrosur
11 një trup?

12 PË. Po.

13 PY. Z. Clark, do të doja të fillonim me raportin tuaj në
14 faqen 14.

15 Z. Clark, do të doja të vazhdonim në seancë publike për
16 aq sa është e mundur, kështu që ju lutem të mos përmendim me
17 emër personat që do të trajtojmë së bashku. Dhe nëse është e
18 nevojshme që ta përmendim emrin, atëherë kalojmë në seancë
19 private dhe i referohemi personit me emër.

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në fakt numri i provës. Ju lutem
21 vendosim në ekran faqen 14 të provës që ka numrin provizor
22 1991.

23 PY. Z. Clark, keni kopjen fizike përpara, kopjen në letër.
24 Është përmbledhja juaj kjo që do të shohim tani.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është për

1 publikun kjo?

2 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mesa kuptoj unë Prokuroria nuk do
3 që ta ndjekë publiku këtë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit. Ju lutem të mos
6 shfaqet kjo për publikun.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ky është një dokument
8 konfidencial kështu që sidoqoftë ne nuk do ta transmetonim
9 këtë publikisht.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit. Shohim në ekran
11 faqen 14.

12 PY. Z. Clark, që ta kuptoni çfarë do të shohim. Ju keni
13 përmendur një nga aspektet e raportit tuaj që është një
14 grumbullim pesë trupash, thatë ju, që u gjetën dhe u
15 ekzaminuan së bashku.

16 PË. [Nuk ka përkthim].

17 PY. Në këtë faqe të raportit keni bërë disa komente të
18 përgjithshme që lidhen me këto trupat të marrë së bashku.

19 Është pra, një punë patologjike për të pesë trupat.

20 PË. Po.

21 PY. Shkurtimisht të flasim pak për komentet tuaj. A është e
22 vërtetë që për këta trupa për të cilat i keni marrë raportet e
23 autopsisë -- ju i keni marrë raportet e autopsisë, por jo
24 fotografitë?

25 PË. Po.

1 PY. Keni marrë disa fotografi, por këto fotografi kanë qenë
2 fotografi të vendngjarjes që përmbanin vetëm veshjet -- vetëm
3 trupat e veshur, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. A pajtoheni me mua që kjo të kufizon dhe nuk mund të
6 ekzaminosh lëndimet që kanë pasur këto persona duke mos pasur
7 fotografitë?

8 PË. Po, kështu është.

9 PY. Mbase përgjigja është e qartë, por, thjesht duke parë
10 disa trupa me veshjet ju nuk keni mundësi -- me rroba
11 domethënë, ju nuk keni mundësi që t'i bëni një ekzaminim
12 plagëve, vendndodhjes, përmasave, ngjyrës?

13 PË. Po.

14 PY. Lëndimet e këtyre trupave ishin përshkruar në raportin e
15 autopsisë, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Ju thatë edhe pak më herët, ju u mbështetët në
18 përshkrimet me shkrim që ua dhanë paraprakisht duke qenë se ju
19 nuk kishit fotografi, apo jo?

20 PË. Po kaq mund të bëja unë.

21 PY. Këto pesë raporte ishin përgatitur nga i njëjti patolog,
22 z. Dobricanin, apo jo?

23 PË. Mendova se ishte femër.

24 PY. Në fakt dhe unë mendova se ishte e gjinisë femërore, por
25 më thanë që ishte mashkull.

- 1 PË. Unë nuk e di, s'ka rëndësi, po mendova se ishte femër.
- 2 PY. Mua më informuan që ishte mashkull. Është z. Dobricanin.
- 3 PË. Nuk ka asnjë ndryshim, në fakt.
- 4 PY. Në fakt, Dr. Dobricanin, të përdorim këtë titull. Pra,
- 5 Dr. Dobricanin është personi që ka bërë këto pesë autopsi?
- 6 PË. Po.
- 7 PY. Dhe janë bërë në prill të '98-s në Kosovë nga autoritetet
- 8 serbe, apo jo?
- 9 PË. Po.
- 10 PY. Në këto momente ende s'ka pasur ndërhyrje ndërkombëtare,
- 11 nga ndërkombëtarët në fushën patologjike?
- 12 PË. Po.
- 13 PY. Shohim faqen 14. Nuk do shohim të gjitha pikat që
- 14 paraqiten këtu, por sidoqoftë, kur keni bërë këto konstatime
- 15 të përgjithshme, në këtë pikë ju keni theksuar disa
- 16 parregullsi që kishit vendosur, kishit konstatuar ju në
- 17 raporte?
- 18 PË. Po.
- 19 PY. Shohim pikën 4, pika që thotë "Kur i kthehesh plagëve
- 20 ..."
- 21 Ta trajtojmë pak këtë. Z. Clark, a është e vërtetë që një
- 22 nga pikat që keni ngritur ju në këtë pikë është që gjurmët e
- 23 lëndimeve nga armët e zjarret kanë qenë -- një nga punët që
- 24 keni bërë, janë gjurmët e armëve të zjarrit?
- 25 PË. Po.

1 PY. Ju e përmendët shkurtimisht sot paradite dhe një nga
2 gjërat që vutë re ju kur patë këto trupa të marra së bashku,
3 për mendimin tuaj disa nga gjurmët në autopsi, duket sikur
4 janë të palogjikshme, ka diçka të pazakontë?

5 PË. Po.

6 PY. Ju po ashtu keni thënë që nuk ka pasur një diagramë,
7 domethënë, diagramë dhe fotografi mbështetëse ku të
8 mbështeteni ju për gjetjet tuaja?

9 PË. Po.

10 PY. Ju keni dhënë dy shembuj të elementëve të palogjikshme që
11 keni konstatuar ju, që do t'i trajtojmë më në hollësi së
12 bashku. Por, shembulli që keni dhënë ju është për një nga
13 personat e vdekur. Është plaga që ka hyrë dhe ka dalë në ballë
14 edhe një nga plagët është në shpinë. Këtë e keni theksuar ju.

15 PË. Po, për pjesën në shpinë ka pasur dy.

16 PY. Çfarë synoj të bëj unë është kur ta shikojmë me hollësi
17 të shohim dhe diagramën tuaj sa i takon gjetjeve. Megjithatë,
18 për momentin po bëjmë një përmbledhje.

19 Sa i takon formulimit tuaj, ju keni thënë që ka gjetje të
20 palogjikshme. Si ta kuptojmë ne këtë "të palogjikshme" sipas
21 jush? Ju thoni se janë të palogjikshme sepse gjetjet nuk janë
22 të sakta? Mungon logjika në arritjen e këtyre gjetjeve, sipas
23 jush, kjo e bën të pasaktë?

24 PË. Duken të palogjikshme sepse plaga në hyrje dhe në dalje
25 janë shumë afër. Plaga për -- e hyrjes dhe e daljes është

1 shumë e pazakontë. Kjo mund të ndodhë ndonjëherë, jo se nuk
2 ndodh, por më është -- habitem pse s'ka bërë asnjë koment
3 patologu.

4 Nëse unë do shikoja një rast të tillë dhe do thoja që
5 këtu ka hyrë dhe këtu ka dalë plumbi, unë do mendoja me vete
6 që kjo është e pazakontë dhe unë do bëj një shpjegim për këtë,
7 do bëj një shpjegim. Mbase patologu ka pasur të drejtë në
8 gjetjet e veta. Por, jam i befasuar pse nuk është theksuar,
9 pse nuk është thënë pse është e pazakontë. Pse nuk ka asnjë
10 shpjegim për këtë.

11 PY. Dhe është e drejtë dhe sigurisht që mund të shikoni
12 raportet dhe fotografitë pak në më tepër detaje, megjithatë,
13 diçka që mund t'ju duket juve si diçka shumë e pazakontë, kur
14 patologu shikon diçka të tillë në konstatimet e veta kjo duhet
15 të konstatohet dhe të thuhet me fjalët e veta, domethënë, që
16 kjo është një situatë e cila është e pazakontë. Dhe ju prisnit
17 që një gjë e tillë të mund të konstatohej nga patologu, apo
18 jo?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, është normale që të jepet një shpjegim dhe të jepet
21 edhe një konstatim përkatës?

22 PË. Gjithsesi, ka patologë të cilët funksionojnë në sisteme
23 të ndryshme dhe ndoshta nuk e kanë si praktikë të zakonshme
24 për ta bërë këtë gjë, por gjithsesi në këndvështrimin tim
25 duhej të ishte bërë kjo gjë.

1 PË. A është pra, sigurisht që është e mundur që këto
2 konstatime të jenë të sakta, megjithëse mund të duken shumë të
3 pazakonta dhe jo logjike?

4 PË. Po.

5 PY. Megjithatë, është po ashtu e mundur që këto konstatime të
6 jenë të pasaktë dhe për rrjedhojë shpjegimi është jologjik,
7 apo jo?

8 PË. Edhe kjo është mundësi.

9 PË. Kalojmë tek pika 5.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Më thonë që nuk e kemi në ekran
11 këtë çfarë duhet të shohim, kështu që do i thoja Sekretarit të
12 kalojmë tek pika 5. Pika 5, dokumenti që kemi në ekran, në
13 ekran duhet të ulet, duhet të vazhdohet më tej në drejtim të
14 fundit të faqe.

15 PY. Pra, kjo pjesa ka të bëjë me kohën e realizimit të
16 autopsisë, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Diçka që na keni shpjeguar pak më përpara që duhet të
19 gjurmohen gjurmët e të shtënave me plumba, dhe ju thatë që nuk
20 ishte një proces i thjeshtë ky, apo jo?

21 PË. Ndonjëherë mund të jetë i vështirë.

22 PY. Do të duhet domethënë që të bëhen shumë testime dhe duhen
23 të bëhen shumë prova për të konstatuar që hyrjet dhe daljet
24 janë të sakta?

25 PË. Po.

1 PY. Ju keni vënë re që në këtë rast, për këto pesë trupat, në
2 mendimin tuaj është shumë e pazakontë që Dr. Dobriçin [Sipas
3 përkthimit] i ka kryer të pesë autopsitë, domethënë, të pesë
4 personat dhe këto autopsi i ka kryer brenda gjysmë dite.
5 Domethënë, sipas pikëpamjes tuaj kjo ishte e pazakontë, apo
6 jo?

7 PË. Po. Unë personalisht do mendoja që në këto raste, të
8 paktën, për një trup do të duheshin disa orë. Dhe pra, me
9 thënë të drejtën, që patologu ta bëjë këtë punë njëra pas
10 tjetrës, pra, të bëjë vlerësimin e trupave njëri pas tjetrës,
11 mbase mund të ketë mundësi që dikush të bëjë gjëra të
12 shkëlqyera. Megjithatë, çështja është që kur ekzaminon më
13 shumë se dy, tre trupa, atëherë fillon edhe harron gjërat dhe
14 bëhet më e vështirë, domethënë, për të bërë konstatimet e
15 duhura.

16 Me ç' duket, ai ia ka dalë që ta bëjë këtë punë këqyrse,
17 megjithatë, mua personalisht më bën përshtypje, duhet ta
18 pranoj.

19 PY. Ju thatë tre, katër orë. Domethënë, ju për një autopsi të
20 kësaj natyre mendoni që mjaftojnë tre, katër orë? Kaq do të
21 duhet që të përdoret, kaq kohë?

22 PË. Mendoj se po. Atëherë, duke marrë parasysh faktin që nuk
23 janë bërë fotografi, do ishte më e thjeshtë sepse bërja e
24 fotografive e ngadalëson procesin. Do kohë që të bëhen
25 fotografi. Për mua është e nevojshme, por në qoftë se nuk bën

1 fotografi procesi do të jetë më i shkurtër.

2 PY. Megjithatë, në të cilën janë kryer këto autopsi, ju
3 mendoni që koha që ka shpenzuar mjeku ka qenë e pamjaftueshme,
4 apo jo?

5 PË. Po. Mesa kam kuptuar unë, domethënë kanë qenë gjashtë
6 raste, megjithëse unë kam parë pesë raste, apo jo?

7 PY. Po, ju kërkoj ndjesë. Gabimi im.

8 PË. Po, në fakt, është habi, është befasi që e ka mbaruar
9 punën aq shpejt.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të shkojmë tek faqja 15 në të
11 majtë që është pika 6 e dokumentit. Ndërkohë që në versionin
12 në shqip duhet që të jemi një faqe më përpara se na nevojitet
13 dhe teksti në pikën drejt fundit të faqes. Ndërkohë që në
14 versionin në anglisht kalojmë tek faqja tjetër. Atëherë, në
15 anglisht është në fillim të faqes ndërkohë që në shqip është
16 drejt fundit të faqes.

17 PY. Pra, këtu po shohim diçka që thatë që ju ka befasuar sa i
18 takon raportit. Juve thonë që jeni befasuar që nuk ka plumba
19 ose copëza të plumbave që janë gjetur në trupat në
20 vendngjarje. Thoni që kjo është disi e çuditshme, veçanërisht
21 duke pasur parasysh një numër prej tyre kanë prekur kockat.
22 Keni thënë këtë apo jo?

23 PË. Po. Po, aq më tepër që kishte persona që kishin rreth nga
24 20 deri në 30 plumba që kishin përshkruar trupat e tyre.

25 Kështu që kjo është disi befasuese që duke pasur parasysh

1 numrin e madh të plumbave, nuk ka pasur as mbetje plumbash të
2 konstatuar në trupat e vdekur. Megjithatë, plumbat janë shumë
3 të vështirë për t'u gjetur në mënyrë fizike, dhe ndonjëherë
4 është e vështirë në qoftë se nuk është bërë një skanim i
5 trupit është i vështirë, domethënë, që të gjenden vendet që
6 kanë cekur plumbat.

7 PY. Megjithatë, në një rrethanë të tillë, të paktën duke
8 pasur parasysh numrin e madh të plumbave ju do prisnit që
9 kolegu të kishte gjetur të paktën rastin e një plumbi, apo jo?
10 A është e drejtë të thuhet që ju u befasuat nga fakti që nuk
11 ishte konstatuar asnjë rast plumbi i gjetur?

12 PË. Po, besoj se po, e thashë.

13 PY. Diku tjetër në raport ju keni komentuar dhe keni dhënë
14 edhe përgjigjen tuaj lidhur me këtë situatë. Dhe keni thënë që
15 ishte befasuese si gjetje që formulimi i dhënë prej jush në
16 anglisht ishte shumë i fortë, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. A është e saktë ose a e kam kuptuar unë siç duket --
19 duhet që fakti që bëhej fjalë për shumë plumba për, pra, për
20 një situatë që ishte e tillë që përfshinte shumë plumba ju
21 thoni që ka befasuese që patologu nuk ka bërë absolutisht
22 asnjë lloj konstatimi për gjetjen e pjesëzave të plumbave të
23 gjetura në eshtra.

24 PË. Po, është befasuese. Dhe mund ta them edhe sot këtë gjë.
25 Është shumë çuditëse, në fakt është shumë e çuditshme sepse

1 duket sikur nuk janë bërë as përpjekje për t'i kërkuar
2 pjesëzat e plumbave. Është e çuditshme, më duhet ta them dhe
3 një herë. Megjithatë, duke pasur parasysh numrin e
4 konsiderueshëm të personave që kam parë unë të qëlluar me armë
5 zjarri dhe duke marrë parasysh përvojën time, domethënë, dhe
6 plumbat janë barut që përshkruajnë trupin me një shpejtësi të
7 jashtëzakonshme, shpejtësi shumë të madhe dhe kështu që është
8 e çuditshme që nuk është identifikuar diçka e tillë.

9 PY. Të ndalojmë këtu për një moment. Ju përmendët përvojat
10 tuaja të mëparshme. Tani në qoftë se do shikojmë koleksionin e
11 autopsive të personave të vrarë me armë zjarri, a keni -- a
12 mund të na thoni se çfarë mund të -- cila është pritshmëria
13 juaj ose e thënë me fjalë të tjera, duke marrë parasysh
14 karrierën tuaj, dhe faktin që keni qenë të përfshirë në shumë
15 autopsi ose persona të cilët kanë gjetur vdekjen si rezultat i
16 qëllimit me armë, është kjo diçka e zakonshme që ju e keni
17 bërë?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe është befasi edhe sot e kësaj dite për juve që
20 raporti i kolegut është bërë në mënyrë të tillë që nuk ka
21 asnjë lloj konstatimi për copëzat e plumbërave, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Duke marrë parasysh patologun forensik, ju si ekspert,
24 pajtoheni besoj që plumbat shpesh bëjnë diçka -- bëjnë -- e
25 bëjnë të vështirë, domethënë, kanë vështirësi për sa i takon

1 qëllimit forensik të identifikueshëm. Megjithatë, nga
2 pikëpamja e patologut shpesh duket kërkuar në mënyrë të
3 qëllimshme për plumbin, pra, gjetja e plumbit dhe kërkimi e ka
4 një vlerë të caktuar forensike?

5 PË. Po, kështu është. Është e rëndësishme që të përcaktohet
6 vendi i plumbit dhe mbetjet e plumbit në qoftë se bëhet fjalë
7 për dëmtime me armë zjarri. Dhe së dyti, është e rëndësishme
8 të që kërkohet për plumbin, për copëzat e plumbit.

9 PY. A do të ishte e drejtë që të thuhet që në mënyrë të
10 zakonitë pritet që një patolog, i cili merret me dëmtimet nga
11 armë zjarri, zakonisht, në mënyrë të qëllimshme të kërkojë
12 plumba ose pjesëza të plumbave të mbetura në trupin e vdekur
13 të personit?

14 PË. Po, kjo do ishte procedura normale.

15 PY. Por, megjithatë, jo -- ne nuk e dimë, domethënë, në qoftë
16 se patologu ka përdorur skanerat apo jo?

17 PË. Nuk thuhet asnjë gjë lidhur me këtë.

18 PY. Megjithatë, në çdo rast, edhe në qoftë se përdoret skaner
19 ose jo për përcaktimin e prekjes me copëzat e plumbave,
20 domethënë, është praktikë e zakonshme që patologu ose
21 patologia të mund të caktojë ose të identifikojë vendet ku ka
22 mbetur plumbi ose ku ka përshkuat plumbi trupin e personit të
23 vdekur?

24 PË. [Nuk ka përkthim].

25 PY. Z. Clark, kam një pikë të fundit dhe pastaj do bëjmë

1 pushimin. Ju gjithashtu jeni marrë me këtë pikën e fundit për
2 plumbin në konstatimet e përgjithshme. Domethënë, në
3 konstatimet e përgjithshme në raportin tuaj, në akt-ekspertizë
4 keni përcaktuar prapë elementin e plumbit dhe keni bërë
5 dallimin këtu midis ndryshimeve të ngjyrës së lëkurës. A është
6 kështu?

7 PË. Po. Diçka që më ka shqetësuar mua pak është veçanërisht
8 në rastin e parë, që ja u shpjegova dhe këtu është një -- unë
9 kam dhënë një përshkrim të mungesës ose të ndryshimit të
10 ngjyrës përveç dëmtimeve ose lëndimeve të shkaktuar përmes
11 armës së zjarrit.

12 PY. Do ju kërkoj që të ndaloni këtu për një moment sepse kjo
13 është temë e gjerë. Besoj që kjo është një temë të cilën ju e
14 keni trajtuar me të gjitha trupat. Pra, gjithsesi, ju thatë që
15 duket sikur ka një konstatim të përgjithshëm në të gjitha
16 autopsitë e kryera ku gjithsecili prej personave që ju keni
17 këqyrur kishte në trup hematoma ose -- ose të ënjtura ose
18 mavijosje të cilat patologu i ka atribuar për -- si rezultat
19 i traumës, forcës së traumës.

20 PË. Po.

21 PY. A është ky një përshkrim i saktë i asaj çfarë ka thënë
22 patologu që ka konstatuar në atë rast?

23 PË. Kështu e kam kuptuar unë. Mendoj që këtë ka parë
24 patologu. Ajo çfarë është e çuditshme është -- më lejoni një
25 çast sa për ta gjetur se po kërkoj citimin.

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 126

1 PY. Mendoj që e di për çfarë citimi po pyesni. Aty thuhet që:

2 "... lëkura është me ngjyrë të purpurt edhe ka gjak në
3 indin subakuton [Sipas përkthimit]".

4 PË. Po.

5 PY. Po.

6 PË. Por nga ana tjetër, domethënë, pjesa e lividitetit kjo
7 është përcaktuar dhe diku tjetër raport, që do të thotë që
8 referenca këtu është ndryshe. Domethënë, i referohet diçkaje
9 tjetër. Edhe jo vetëm kaq, po ka edhe një koment këtu dhe kjo
10 --

11 PY. Domethënë, ka një lidhje shkak pasojë?

12 PË. -- dhe implikimi këtu ose nënkuptimi është që ka një
13 lidhje midis mungesës ose ndryshimit të ngjyrës dhe
14 mavijosjes.

15 PY. Ta bëjmë pak të qartë këtë. Nga raportet e dëgjjuara prej
16 jush, patologu ka bërë konstatime të lividitetit, ka bërë
17 konstatime gjithashtu edhe të ndryshimit të ngjyrës në të
18 purpurt, dhe ka arritur në përfundimin për sa i takon lidhjes
19 shkak-pasojë të ngjyrës së purpurt edhe identifikimit të dy
20 ngjyrave të ndryshme në trup, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Për këtë arsye ju nuk besoni se ky është një përshkrim i
23 lividitetit, se përndryshe do përshkruhej diku tjetër në një
24 pjesë tjetër të raportit?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe dikush nuk do bënte lidhjen ndërmjet traumës së

2 forcës si shkak të lividitetit, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Domethënë, ky është shpjegimi dhe kjo ka kuptim apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Unë do t'ju kërkoj të bëni një shpjegim, Dr. Clark, kur
7 të vijë momenti i përshtatshëm sa i takon këtij konstatimi në
8 një prej trupave. Megjithatë, gjuha që ju përdorni është shumë
9 -- ju thoni, që është shumë dyshuese. Dhe jo vetëm kaq, por ju
10 vazhdoni më tej në paragraf dhe thoni që:

11 "... duhet të ngrihen dyshime sa i takon mavijosjeve të
12 pretenduara dhe interpretimit të shkaktimit të mavijosjeve."

13 Të ndalojmë pak këtu për para sesa të trajtojmë pyetjen
14 pse. Por, përpara sesa të ngre këto dy çështje, a e kam
15 kuptuar drejt që shqetësimet tuaja janë të dyfishta?
16 Shqetësimi i parë është në qoftë se konstatimet e mavijosjeve
17 janë të vërteta apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe së dyti, në qoftë se janë reale apo të vërteta, çfarë
20 mund të thuhet sa i takon interpretimit dhe lidhjes shkak-
21 pasojë?

22 PË. Po.

23 PY. Domethënë, kemi këto dy lloj shqetësimesh konkurruese me
24 njëra-tjetrën për të trajtuar, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Atëherë, a është drejtë të thuhet që njëri prej këtyre
2 shqetësimeve, ose shqetësimi i parë është i drejtpërdrejtë dhe
3 a do ishte e drejtë që të thuhej që si rezultat i asaj çfarë
4 ju keni parë në raportin e autopsisë dhe analizës së vet, ju
5 pyesni veten në qoftë se këto trupa kanë pasur apo jo
6 mavijosje?

7 PË. Po.

8 PY. Domethënë, pyetja më e drejtpërdrejtë është që a kanë
9 ekzistuar apo jo mavijosjet?

10 PË. Po.

11 PY. Domethënë, kjo është një çështje që është pak më shumë e
12 drejtpërdrejtë, ndërkohë që shqetësimi i dytë ka të bëjë me
13 interpretimin. Në këtë paragraf juve shpjegoni hollësitë
14 përkatëse. Ju thoni, në paragrafin e parë këtu, që:

15 "Mavijosjet e dukshme të përshkruara këtu janë shumë për
16 t'u vënë në pikëpyetje ... edhe në qoftë se do të jenë të
17 vërteta nuk bëhet asnjë lloj interpretimi, nuk thuhet asnjë
18 lloj specifikimi në qoftë se ka pasur ndryshim të ngjyrës, dhe
19 shpërndarja ka qenë kryesisht tek pjesa e pasme e trupit dhe
20 tek gjymtyrët, me asgjë në kokë, me një numër të vogël në
21 krahë dhe me shumë pak shenja të tjera të cilat mund të
22 lidhen me mavijosjen, si për shembull, gërvishtjet dhe
23 mavijosja në pjesën e brendshme të duarve është
24 jashtëzakonisht e pazakontë."

25 Ajo çfarë dua që të bëni tani është që të na e shpjegoni

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 129

1 pak çfarë keni thënë këtu, Dëshmitar. Sigurisht të fillojmë me
2 elementin e dimensioneve. Ju thoni që dimensionet nuk janë të
3 pranishëm këtu.

4 PË. Po. Mbase nuk është shumë e rëndësishme kjo sepse kjo
5 është një pjesë e përgjithshme. Domethënë të shikosh
6 mavijosjet në pjesën e sipërme të trupit nuk është e nevojshme
7 të bëhen matje se ne mund ta shikojmë me sy se çfarë ka
8 ndodhur, për shembull, në shpinë.

9 PY. Megjithatë, nuk ka ndonjë përshkrim që ka të bëjë me
10 përmasën apo me sipërfaqen, me madhësinë?

11 PË. Po.

12 PY. Domethënë, me fjalë të tjera, domethënë, ju nuk e dini se
13 çfarë ka prekur mavijosja. Ka prekur gjithë shpinën, një pjesë
14 të saj, e të tjerë, e të tjerë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
16 prisni që të mbarojë pyetja pastaj jepni përgjigjen dhe flisni
17 me radhë sepse në të kundërtën është shumë e vështirë për
18 përkthyesit për t'ju kapur.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, ju nuk i keni këto lloj detajesh, këto lloj
21 hollësish, për të na bërë në gjendje ne që të kuptojmë
22 përmasën, vendin, sipërfaqen si dhe elementë të tjerë shumë
23 konkretë ose specifikë që kanë të bëjnë me mavijosje të tilla,
24 apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Po ashtu ne nuk kemi informacion që ka të bëjë me
2 ngjyrën. A është e vërtetë kjo?

3 PË. Po.

4 PY. Ngjyra është e rëndësishme sepse niveli, intensiteti i
5 ngjyrës i jep informacion patologut, apo jo, dhe ka të bëjë
6 edhe me datën e lëndimit?

7 PË. Po.

8 PY. Tani së dyti, sa i takon shpërndarjes. Pra, shpërndarjes
9 në trup të këtyre mavijosjeve të pretenduara, ju keni thënë që
10 është e pazakontë. Pra, ju e keni thënë më përpara këtë gjë,
11 domethënë, që është në pjesën -- në gjymtyrë, në pjesën e
12 shpinën e të tjerë?

13 PË. Po, se është e gjitha në shpinë, është simetrike.

14 Domethënë, nuk është se më duket shumë bindëse që është
15 mavijosje.

16 PY. Pse?

17 PË. Mavijosjet, siç e kemi parë dhe një fotografi të
18 mëhershme, ndodhin në zona të caktuara. Ka forma të ndryshme,
19 nuk është se ka forma uniforme. Pra, në qoftë se dikush
20 goditet në një pjesë të trupit, atëherë, mavijosja është e
21 lokalizuar në atë vend ku qëllohet personi. Kjo është e
22 përgjithshme. Ndërkohë që këtë thatë, domethënë, që nuk është
23 shumë e zakonitë që dikush të ketë mavijosje në shpinë.

24 PY. Pra, dhe kjo nuk është diçka që ju prisni që të shikoni,
25 apo jo?

1 PË. Jo. Dhe në qoftë se bëhet fjalë për një mavijosje reale,
2 atëherë bëhet fjalë për një mavijosje shumë të shtrirë me
3 sipërfaqe të madhe dhe në qoftë se bëhet fjalë për mavijosje
4 të dimensioneve të tjera, unë prisja që të kisha parë lëndime
5 të tjera si abrasione ose çjerrje, ndërkohë që këto nuk janë
6 të pranishme fare.

7 PY. Në qoftë se do të ishte e vërtetë që mavijosjet kanë
8 ndodhur, i takon që lëndimi ka qenë i madh mbi personin në
9 fjalë, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe kjo duhej që të ishte raportuar në raportin e
12 autopsisë, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Edhe një herë, domethënia është e konsiderueshme, pra,
15 përderisa nuk bëhet fjalë për shenja të zakonta, ose përderisa
16 mavijosjet ose ndryshimi i ngjyrës është i pazakontë, kjo
17 kërkonte që personi që ka bërë raportin, domethënë, patologu,
18 t'i kishte vënë në pah këto elementë, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe përsëri sa i takon gjurmimit të pazakontë të
21 plumbave, pra, kur një patolog shikon një situatë të tillë kaq
22 të pazakontë, duhet që të bëhet komenti përkatës në raport
23 duke shpjeguar se pse konstatimi është i pazakonshëm dhe duhet
24 që të jepen shpjegime përkatëse?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe ky shpjegim nuk është dhënë apo jo?

2 PË. E drejtë.

3 PY. Një prej mënyrave të tjera të shpërndarjes për të cilat
4 juve i keni komentuar dhe keni thënë se është shumë e
5 pazakontë, ose siç e thoni ju fjalë për fjalë, "është
6 jashtëzakonisht e pazakontë", janë mavijosjet në pjesën e
7 brendshme të dorës, në pëllëmbën e dorës?

8 PË. Po.

9 PY. Si pikë nisëse, kjo është absolutisht e pazakonshme qoftë
10 edhe për një person?

11 PË. Po.

12 PY. Aq më pak në pesë persona?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe në qoftë se ndodh një gjë e tillë, a është e zakonitë
15 që patologu ta ketë thënë që pavarësisht që ka mavijosje në
16 pëllëmbën e dorës, domethënë, arsyeja është kjo sepse siç e
17 thamë, domethënë, kjo është diçka e cila nuk ndodh zakonisht?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe në veçanti një patolog kur shqyrton një trup,
20 domethënë, jo një trup po pesë trupa apo gjashtë trupa, të
21 gjithë duken sikur kanë të njëjtin problem ose kanë të njëjtin
22 lloj mavijosje, aq më tepër e ka për detyrim patologu të japë
23 shpjegimet përkatëse, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Sikurse na e shpjeguar edhe pak më herët, pra, juve thatë

1 që pra, gërvishtjet mund të shkaktohen nga trauma e forcës së
2 madhe. Megjithatë, është e drejtë apo jo, që të gjitha
3 autopsisë për këto personat, pra, për të gjitha këto rastet e
4 mavijosjes të cilat janë pazakonta në asnjë prej këtyre
5 rasteve nuk jepet asnjë lloj shënimi që shpjegon gërvishtjet
6 apo le të themi proceset e tjera që ndihmojnë për mavijosjen?
7 PË. Po.

8 PY. Dhe kjo është e pazakontë, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Është e pazakontë qoftë edhe për një person, aq më tepër
11 është e pazakontë për një grup personash. A është kështu,
12 Dëshmitar?

13 PË. Po.

14 PY. Tani le të kalojmë tek ajo çfarë po flisnin pak më herët.
15 Domethënë, domethënien e këtyre lëndimeve. Sikurse na e thatë
16 edhe përpara një çasti, këto janë lëndime të cilat janë të
17 përshkruara si mavijosje në sipërfaqe të konsiderueshme të
18 trupit. Dhe sikurse e thatë dhe ju, në qoftë se do kishin
19 ndodhur me të vërtetë, do kishin përfshirë forcë domethënëse,
20 pra të madhe, dhe si rezultat ka të ngjarë që në këto lëndime
21 të jenë përfshirë një instrument ose disa instrumente?

22 PË. Po.

23 PY. Në këto rrethana, për pasojë, do kishte më pas -- do
24 kishte pasur më shumë të ngjarë që trauma e forcës e kësaj
25 natyre të kishte shkaktuar çarje, gërvishtje, abrazione, e të

1 tjerë?

2 PË. Po, të paktën disa.

3 PY. Po, të paktën disa. Dhe në këtë rast nuk kemi asnjë, apo
4 jo?

5 PË. E vërtetë, nuk kemi asnjë.

6 PY. Tani sa i takon paragrafit të dytë të cilën e cekëm dhe
7 më herët, por për ta mbyllur me këtë temë, atëherë dua që ta
8 lexoj për autopsinë:

9 "Pretendimi është që duket sikur mavijosjet janë
10 shkaktuar nga goditjet nga një objekt i rëndë. Megjithatë, nuk
11 ka asnjë lloj komenti sa i takon asaj çfarë ka ndodhur ose
12 domethënies së gjuajtjeve të tilla. Në qoftë se sugjerohet se
13 këta persona janë rrahur përpara sesa të jenë gjuajtur me
14 armë, ose në ditë përpara sesa ata të vriteshin, duket
15 mbresëlënëse që nuk ka absolutisht asnjë lloj lëndimi në kokë
16 apo në pjesë të tjera dhe se lëndimet janë të gjitha kaq
17 simetrike, me përjashtim të rasteve kur rrahja ka qenë e
18 sofistikuar dhe ka qenë e etiketuar dhe e planifikuar deri në
19 detaje."

20 PË. Po.

21 PY. A pajtoheni që në përgjithësi, zakonisht, domethënë këto
22 janë detaje për të cilat patologu duhej që të kishte bërë
23 komentet e veta kur të kishte identifikuar traumën përmes
24 forcës, përmes instrumenteve të ndryshme ose për shembull, të
25 kishte konstatuar se çfarë moshe ose kur është -- është

1 shkaktuar trauma ose mavijosja?

2 PË. Po, po, në përgjithësi, domethënë, përcaktohet sesa e
3 freskët ose jo është mavijosja ose shenja e traumës.

4 PY. Sa i takon kohës kur është bërë, në veçanti në qoftë se
5 bëhet fjalë për traumë force kjo ka shumë të ngjarë që të
6 trajtohet edhe si shkak vdekjeje, apo jo?

7 PË. Po, lidhet me shkakun e vdekjes.

8 PY. Ekzaktësisht [E pakuptueshme]?

9 PË. Po.

10 PY. Po për shkak -- në rastin, për shembull, të lëndimeve të
11 vjetra, kjo mund të jetë një faktor relevant kur shikojmë
12 shkakun e vdekjes?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe për këtë arsye duhet që të shqyrtohet, të këqyret i
15 gjithë trupi dhe të shikohet me vëmendje situata për të
16 përcaktuara shkakun e vdekjes dhe për pasojë nuk është e
17 pazakontë për trupa që të kenë edhe lëndime të vjetra në një
18 formë ose në një formë tjetër, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, një rol kryesor i patologut është që të identifikojë
21 kur ka pësuar personi i vdekur lëndimin në fjalë edhe çfarë
22 moshe ose kur ka ndodhur lëndimi dhe të bëjë konstatimet dhe
23 të thotë çfarë relevance ka lëndimi i tillë mbi vdekjen e
24 personit?

25 PË. Po, është relevante për shkakun e vdekjes.

1 PY. Në rregull. Tani për sa i takon një viktime e cila është
2 qëlluar me thikë dhe që bie, për shembull dhe bie në këmbë, në
3 gjunjë, dy, tre ditë përpara sesa të vdesë. A ka relevancë kjo
4 për sa i takon shkakut të vdekjes?

5 PË. Po.

6 PY. Tani le të vazhdojmë me zhvillimin e autopsisë dhe çfarë
7 prisni juve sa i takon lëndimeve dhe moshës së tyre. Ju prisni
8 pra, që të ketë një lidhje midis të dyjave?

9 PË. Po.

10 PY. Por, asnjë nga këto mavijosje nuk janë përcaktuar sa i
11 takon kohës kur ato kanë ndodhur, apo jo, në autopsi?

12 PË. Jo.

13 PY. Tani le të trajtojmë pak çështjen e simetrisë së
14 lëndimeve. Ju e thatë më përpara që është shumë e pazakontë që
15 simetria të jetë kaq e ngjashme nga njëri trup tek tjetri, apo
16 jo? E keni thënë këtë edhe në konstatimet tuaja.

17 PË. Po.

18 PY. Trupat, është thënë, kanë pasur lëndime në kokë. A është
19 e vërtetë kjo?

20 PË. Po, ashtu është.

21 PY. Tani të vazhdojmë pak me pretendimet që kanë të bëjnë me
22 përfundimet e këtij raporti që këto persona, ose këto burra që
23 kanë qenë subjekt ose i janë nënshtruar të rrahurit, ju keni
24 konstatuar se është shumë e pazakontë që në këto rrethana
25 rezultatet të jenë ato që janë konstatuar në raport?

1 PË. Nuk jam i sigurt që patologu në fakt ka thënë që personi
2 ka vdekur nga një rrahje ose ka -- nuk e di. Ndoshta do të
3 duhet që ta shikoj në raport. E gjeta. Thuhet në përfundim në
4 pikën 8, në autopsinë e parë, këtu përshkruhet që personi i
5 lënduar është përshkruar në paragrafët 11, 12, 13 të
6 konstatimeve dhe këtu përmenden dhe hematomet. Ka edhe një
7 implikim tjetër këtu që ka një mavijosje.

8 PY. Po.

9 PË. Po, që është shkaktuar nga një objekt i rëndë i mprehtë
10 mekanik. Pra, ai thotë që është qëlluar trupi me të. Por ai
11 nuk përdor ekzaktësisht, domethënë, patologu nuk përdor
12 ekzaktësisht fjalën "rrahje".

13 PY. Po. Është e qartë.

14 Atëherë juve e shikoni këtu përdorimin e termit
15 "hematomë". Pra, ne e dimë nga përdorimi i fjalës hematomë që
16 po flitet për një mavijosje, se në të kundërtën nuk do
17 përdorej kjo fjalë ose ky term, apo jo?

18 PË. Po. Është e qartë kjo. Bëhet fjalë për një mavijosje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
20 Do bëjmë 10 minuta pushim, Dëshmitar. Pastaj do kthehemi
21 përsëri për të vazhduar me dëshminë tuaj.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do kthehemi
24 përsëri në sallë për 10 minuta.

25 --- Seanca ndërpritet në orën 15.31

1 --- Seanca rifillon në orën 15.42

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
3 dëshmitarin në sallë.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
6 Z. Rowan, e keni fjalën.

7 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

8 PY. Z. Clark, që të përmbledhim çështjen e mavijosjes dhe
9 përmbledhjen. Siç e keni thënë në raport tuaj, rreshti i
10 fundit që shohim këtu, paragrafi i dytë i pikës së dytë:

11 "Në tërësi, duhet të ngrihen disa dyshime lidhur me
12 mavijosjet dhe interpretimin e tyre. Mungesa e fotografive dhe
13 këtu e bën shumë të vështirë që të zgjidhet kjo pikë apo kjo
14 çështje."

15 Pra, duke shikuar tani mendimi tuaj lidhur me këto
16 mavijosje, siç e diskutuam në fillim, është e drejtë të themi
17 që ju dyshuat që ky konstatim i mavijosjeve, nuk e dini nëse
18 ky është i saktë ky konstatim apo jo?

19 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Pyetja është bërë dhe
20 përgjigja është marrë. Dhe kjo është në procesverbal.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

22 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

23 PY. Po përpiqesha që të bëjmë një lidhje mes këtij koncepti
24 dhe për të cilin ju ngritët dyshimin. Pra, ju po flisni për
25 dyshim, dyshim që duhet të ngrihej?

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 139

1 PË. Po.

2 PY. Dhe duhet ta bëj, të sigurohem që e kemi të qartë në
3 procesverbal që ju dyshoni. Keni ca dyshime që janë ngritur, a
4 e kuptoj drejtë që dyshimi është lidhur me saktësinë e
5 konstatimeve?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe ky dyshim lind, buron nga të gjitha autopsitë që keni
8 parë dhe përvoja juaj në specialitetin tuaj si patolog?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe këtë e keni konstatuar këtë mungesën e fotografive
11 dhe a e kuptojmë drejtë që arsyeja që përmendet sepse nuk mund
12 të zgjidhet çështja e dyshimeve pa patur fotografitë dhe si të
13 tilla këto dyshime ngelin atëherë?

14 PË. Po të kisha patur fotografitë do të kisha qenë më i
15 bindur në njërin mënyrë për një gjë apo për tjetrën.

16 PY. Mund ta shfaqim në ekran, ju lutem, pesë kufomat e para
17 dhe e gjejmë atë te trupi i parë, pra, kufoma e parë në këto
18 pesë kufoma.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Z. Sekretari, kjo është në faqen
20 4.

21 PY. Nuk do të përdor emrin e personit që është përdorur në
22 autopsi, por mund ta shfaqim në ekran. Diku nga mesi i faqes.
23 Këtu.

24 Pyetja e parë që ju është bërë, z. Clark, lidhur me këtë
25 kufomë ishte për një temë tjetër. Pyetja e parë që iu bë juve

1 ishte për vdekje të dhunshme. Por për shkak që kemi -- fakti
2 që kemi biseduar, diskutuar temën e mavijosjes do të doja që
3 për këtë kufomë të mbesim me këtë term pra.

4 A është e drejtë të themi që në fillim që këto ishin
5 vlerësime apo konstatime të përgjithshme të cilat i kemi
6 trajtuar, pra, lidhur me këtë kufomë dhe këto zbatohen në këtë
7 autopsi të këtij individi?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe në këtë pjesë të raportit ju vazhdoni, siç ju është
10 kërkuar nga Prokuroria, që t'ju përgjigjeni pyetjeve konkrete,
11 a është e drejtë të themi që duhet -- se kur lexojmë përgjigjet
12 tuaja ndaj atyre pyetjeve, duhet të kemi parasysh këto
13 vërejtje të përgjithshme që keni bërë?

14 PË. Po.

15 PY. Vërejtje lidhur me mavijosjet a janë ato si një lloj
16 marrje jo si të sigurta, pra dhe përgjigjeve tuaja lidhur me -
17 - si rezervë lidhur me mavijosjen?

18 PË. Po.

19 PY. Pra, Prokuroria ju bën një pyetje lidhur me plagët, për
20 shembull, pyetjet që kanë -- pyetja numër 2:

21 "Çfarë informacioni në këtë raport mund të çojë patologun
22 që të arrijë në përfundimin se plagët janë shkaktuar nga 'një
23 objekt mekanik i fuqishëm që lëvizet, që bën lëvizje të
24 plotë'... A mund të na jepni një shembull të këtij objekti
25 çfarë objekti mund të ketë qenë ky, cili mund të ketë qenë ky

1 objekt?"

2 Tani, ky është përfundimi të cilit, konkludimi të cilit i
3 jemi referuar më herët në përgjigje. Dhe ju i jeni përgjigjur
4 pyetjes së dytë këtu duke thënë, pra, pyetja ishte:

5 "A ka ndonjë tregues në raport që tregon se plagët mund
6 të jenë shkaktuar dhe pastaj kur mund të ketë ndodhur vdekja?"

7 Dhe ju i jepni përgjigje kësaj pyetjeje në raport. A
8 është e drejtë që përgjigjet tuaja vijnë me një lloj rezerve:
9 Është kjo mavijosje autentike, pra, e vërtetë?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe këto janë pyetjet dhe përgjigjet tuaja?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe ne nuk duhet të interpretojmë apo të kuptojmë
14 përgjigjet e tuaja ndaj këtyre pyetjeve si një lëshim apo
15 pranim i ndonjë mavijosjeje, në fakt, si autentike, e vërtetë
16 dhe të arrijmë në përfundim të tillë?

17 PË. Po.

18 PY. E kam fjalën, rezerva janë mendime të miat që kemi
19 diskutuar më parë?

20 PË. Mund të jetë mavijosje, jam përpjekur t'i përgjigjem
21 pyetjes nëse ishte mavijosje autentike, e vërtetë, por
22 gjithmonë duke patur në mendje që mund të mos jetë mavijosje
23 fare.

24 PY. Dhe, në fakt, mund të shohim një shembull të mirë të
25 kësaj kur duhet të jemi pak -- duhet të kemi një rezervë dhe

1 ndoshta mund ta shohim atë.

2 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kjo është në faqen 5, shikoni
3 pyetja 2. Faleminderit.

4 PY. Dhe këtu mund të shohim përgjigjen lidhur me objektin
5 mekanik të ashpër, ju jepni përgjigjen si në vijim:

6 "Profesori Dobricanin përshkruan zona të shumta të
7 mavijosjes së pretenduar ..."

8 Dhe pastaj jep një fjalë, formulimin e përdorur në
9 raport:

10 "... (lëkura është ngjyrë si vjollcë dhe ka gjak në
11 pjesën nën lëkurë, në indet menjëherë poshtë lëkurës,
12 përfshirë pjesën e sipërme të shpinës, pjesën rreth
13 shpatullave dhe krahët dhe këmbët, përfshirë pjesën përpara,
14 mbrapa të duarve dhe këmbëve. Nuk janë dhënë dimensionet e
15 tyre dhe që lidhen me mavijosjet dhe prerjet që mund të priten
16 për plagë të tilla kaq të mëdha, në qoftë se mavijosja është e
17 vërtetë dhe e mirëfilltë, është e saktë atëherë të përshkruar
18 si një traumë e shkaktuar nga një objekt i fortë ..."

19 Është e saktë?

20 PË. Po.

21 PY. Ky është mendimi juaj?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe shohim këtu se e keni shprehur edhe këtu rezervën
24 lidhur për sa i takon përgjigjes tuaj?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe duhet të lexojmë pastaj përgjigjet në vijim lidhur me
2 mavijosjen që dhe këtu kemi një rezervë të shprehur sa i takon
3 kufomave të tjera?

4 PË. Po.

5 PY. Tani, do t'ju bëj pyetje lidhur me copëzat e barutit të
6 padjegura, apo jo? Kjo është në faqen 6.

7 Në faqen 6 është bërë pyetja si në vijim. Pyetja 4 në
8 faqen 6:

9 "Çfarë do të thotë pjesa në vijim shenja të barutit, të
10 copëzave të barutit të padjegura janë gjetur në xhaketë, në
11 copëzat e xhaketës së shqyer dhe përputhen me plagën hyrëse
12 duke zbatuar një metodë kimike me *dipfhenylamine* dhe acid të
13 koncentruar' ..."

14 Ju kujtohet që është zhvilluar kjo pyetje?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe tani po flasim, që ta themi në mënyrë më të zakonshme
17 për mbetjet të barutit të armëve?

18 PË. Kur një armë qëllon apo bëhet një e shtënë me armë, ajo
19 që ngelet, pra, copëzat e pluhurit të barutit ngelin tek
20 tytät, dalja e tytës?

21 PË. Pra, mund të jetë flakë, barut i padjegur, mund të jetë
22 predhë. Pra, në terma të përgjithshëm flasim për barut të
23 padjegur.

24 PY. Dhe copëzat në vetvete, pastaj janë në dy forma.

25 Elementet e bariumit të kombinuar me elementë tjetër metalik

1 që vijnë në dy forma të ndryshme.

2 PË. Nuk është ekspertizë e imja, fusha e ekspertizës time.

3 Nuk do të debatoj me ju lidhur me detajet dhe përbërësit e
4 këtyre mbetjeve që gjejmë, por po flasim për nitroglicerinë.

5 Pluhuri i barutit përmban të gjitha këto elemente pra.

6 PY. Mund të mbaj dy ose mund të përmbajë *three* dhe të gjitha
7 këto përkufizohen si mbetje të pluhurit të barutit të padjegur
8 pra?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe këtë barut të padjegur mund ta gjejmë aty?

11 PË. Po.

12 PY. Copëzat gjinden si të tilla, kjo është një --

13 PË. Po, sepse është një shpërthim i barutit në të.

14 PY. Saktësisht, kjo është pra. Bëhet fjalë për një armë
15 zjarri?

16 PË. Nuk është vetëm armë zjarri, mund të jetë edhe tjetër.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po flisni
18 shumë shpejt.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Në të njëjtën kohë e kuptoj, ky
21 test është për të cilin folëm. Pra, *diphenylamine* dhe acidi
22 sulfurik, por ka dhe substanca të tjera që përmbajnë, që kanë
23 karakteristika të tilla.

24 Pra, mund të kenë rezultate pozitive që janë në fakt të
25 pavërteta. Dhe pse mbetjet e mirëfillta të të shtënave me armë

1 ndodh që dalin nga këto rezultate pozitive që nuk janë të
2 vërteta.

3 PY. Saktë. Sepse lloji i testit, që po përpigemi, që bëhet --
4 përpigjet të identifikojë nëse ato copëza të elementit, pra,
5 mbetjet e të shtënës me armë këto duhet të identifikohen. Dhe
6 identifikimi është edhe më i gjerë?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe ju konstatonit nitratet. Tani, është diçka që është
9 gjetur, kjo është substancë që gjendet në shumë gjëra?

10 PË. Po.

11 PY. Ju përmendët në raportin tuaj, që sapo e përmendët që ky
12 test, siç u përmend raportit autopsisë, pra, raportin e
13 autopsisë sepse është ajo që këtë përpigjet të identifikojë
14 raportit i dendësisë, pra, është, kuptohet që nuk është fusha
15 juaj, prandaj ndonjëherë mund të jetë edhe e vështirë të
16 mbështetesh në të sa i takon mbetjeve të të shtënave me armë
17 konkrete?

18 PË. Është tregues i mirë, por duhet të jemi të kujdesshëm në
19 interpretimin dhe të përjashtojmë shkaqet e mundshme, pra,
20 mund të jetë gjetje e mirëfilltë e mbetjeve të të shtënave me
21 armë por duhet të jemi të kujdesshëm në interpretimin e saj.

22 PY. Por ka një lloj dobie kjo dhe ju kërkoni që të jemi të
23 kujdesshëm kur -- në peshën që i jepet konstatimeve dhe
24 mbështetja që bëhet në to?

25 PË. Po.

1 PY. Që të lëvizim tani nga kjo pikë. Copëzat që janë gjetur
2 të barutit, përmendët nitratet, mund të gjenden natyrisht dhe
3 në atmosferë kjo gjë?

4 PË. Jo në ajër, po në tokë. Janë substanca që mund të
5 gjenden.

6 PY. Po të jap një shembull më konkret. Në qoftë se shkoni në
7 një shtëpi ku ka armë dhe jeni në kontakt me personat që kanë
8 përdorur këtë armë, a është e mundur që si rezultat i pranisë
9 së armëve 1 dhe 2, personave që e kanë manipuluar këtë armë
10 mund të ndodhë që në atë atmosferë, në atë mjedis ka copëza të
11 barutit që mund të jenë, gjinden tek personat?

12 PË. Është e vërtetë, por dua të theksoj që kjo nuk është
13 fushë e ekspertizës sime dhe nuk dua që të citohem me siguri
14 absolute lidhur me këtë pikë.

15 Pajtohem me ju në përgjithësi, por nuk jam ekspert i
16 kësaj.

17 PY. Këto janë teste të cilëve u keni kushtuar pak ose fare
18 vëmendje sepse ishte rreziku që mund të ishin pozitivë po jo
19 të vërtetë, pra, fallco?

20 PË. Këto janë teste që ndaj të cilave duhet të ketë, të
21 tregojmë kujdes dhe rezerva.

22 PY. Tani, së dyti lidhur me armët e përdorura ju është bërë
23 pyetja 5, shihet në faqen 6.

24 Dhe Prokuroria ju kërkon që të bëni komente lidhur me
25 distancën me vendndodhjen e personit që ka qëlluar. Dhe në

1 përgjigjen tuaj ju keni thënë që nuk ka djegie të përshkruar
2 me plagë që mund të tregonte distancën të paktën një metër?

3 PË. E gjithë baza për vlerësimin e distancës së pikës së
4 shtënies dhe të gjitha këto gjëra, pra, tyta e armës është si
5 plumbi udhëton, pra, bën, ka një distancë që duhet të
6 përshkruajë, do të udhëtojë për një distancë të caktuar.

7 Por ka edhe elementë të tjerë siç është tymi, flakët,
8 tymi, baruti që përshkojnë një distancë më së shumti një
9 metër. Pra, në qoftë se gjithë këto elemente gjenden mbi
10 kufomën, rrobat, te lëkura, këto tregojnë që e shtëna është
11 bërë nga një distancë më pak se një metër. Kjo është baza për
12 këtë.

13 PË. Pra, mungesa e këtyre konstatimeve a jeni në gjendje që
14 të përjashtoni distancën e të shtënës nga një metër, pra, por
15 mbetet e hapur distanca, mund të jetë përtej asaj?

16 PË. Po.

17 PY. Gjithashtu përmendëm sot që kjo ka të bëjë me barutin,
18 pra, se në fakt e shtëna mund të jetë bërë, është e arsyeshme
19 të mendohet që e shtëna mund të jetë bërë nga afër.

20 Duke u marrur me këtë, a pajtoheni dhe që prania e
21 mbetjeve të barutit është në përputhje me një të shtënë nga
22 një distancë e shkurtër, e afërt?

23 PË. Në qoftë se e shtëna do ishte bërë nga larg, nuk gjenden
24 mbetje të barutit tek personi i qëlluar.

25 PY. Mbetjet e barutit, unë po i referohem vetëm mbetjeve të

1 të shtënës, pra, copëzat, përbërja e tyre, pra, këto substanca
2 të bariumit, në qoftë se mund të gjendet aty, nuk mund ta
3 përjashtoni, pra, që kjo e shtënë është bërë nga një distancë
4 më e largët nëse ka prani të copëzave të barutit në trup?

5 PË. Nuk di shumë për këto copëzat, sesa nga këto copëzat
6 transportohen bashkë me plumbin, pra, nuk mund të përgjigjem.
7 Por në përgjithësi këto copëza të barutit gjinden vetëm në
8 qoftë se e shtëna është bërë nga një distancë e shkurtër.

9 PY. Tani, sa i takon lëvizjes, pra, trajektores së plagëve,
10 mënyra se si janë bërë plagët në raportin tuaj, në përgjigjen
11 tuaj të pyetjes numër 5, ju keni thënë -- është në të njëjtën
12 faqe.

13 Ju jeni takuar me Prokurorët më herët dhe këtë javë dhe u
14 keni dhënë atyre diagramën që ju keni krijuar, përpiluar,
15 është e saktë?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe ju keni dhënë disa diagrama që ju vetë keni krijuar
18 në përpjekje për të konstatuar trajektoren e plagëve të
19 shkaktuar nga armë zjarri, siç ju e keni kuptuar që janë
20 shkaktuar në këto pesë kufoma?

21 PË. Kam përgatitur këto kohët e fundit dhe po i lexoja,
22 mendoja se do të ishin të dobishme për këtë.

23 PY. Mendoj se do të jenë të dobishme dhe për ne dhe do t'i
24 shohim së bashku.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] A mund t'i kërkoj Sekretarit të

1 Gjykatës që të nxjerrë në ekran raportin në versionin
2 anglisht, raporti për diagramin, 124717-124783.

3 PY. Z. Clark, kur i keni dhënë këto Prokurorisë, kur i janë
4 dhënë këto Prokurorisë, a ju kërkuan ata që t'jua shpjegonit
5 këto apo thjesht i morën?

6 PË. Kemi patur shumë pak diskutime lidhur me këtë.

7 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] A mund të shfaqni në ekran
8 dokumentin që përfundon me 717. Në qoftë se mund ta zmadhojmë.
9 Nuk kemi nevojë që ta kemi në ekran, ndoshta mund të kufizojmë
10 pak fotografinë e kufomës dhe shënimet në fund. Faleminderit.
11 Nuk është e nevojshme që ta kemi, ta shohim.

12 PY. Z. Clark, a është kjo një prej diagrameve që keni dhënë?

13 PË. Po.

14 PY. A është e saktë që ky diagram konkret lidhet me personin
15 për të cilin është bërë raporti që po shohim?

16 PË. Po.

17 PY. Tani, ajo që shohim këtu është pjesa e përparme e trupit
18 në anën e djathtë dhe pjesa e majtë e trupit -- pjesa e
19 poshtme e trupit e bërë në -- pjesa e prapme e trupit në anën
20 e djathtë dhe në fund kemi shënimet që ju keni bërë që
21 përputhen me numrat në imazhet ku përcaktohen plagët e
22 shkaktuara nga armët e zjarrit tek ky person?

23 PË. Këto janë numrat që janë dhënë në raportin origjinal
24 *post-mortem*.

25 PY. Duke iu referuar këtyre numrave a mund të në sqaroni

1 çfarë po shohim këtu?

2 PË. Zonat, natyrisht, zonat me të kuqe janë plagët e
3 shkaktuara nga armë zjarri. Hyrje, plaga, vrima hyrëse apo
4 dalëse. Ato që kam shënuar jua kam dhënë një numër, kam
5 vendosur një numër ato. Aty ku kam vendosur i kam futur në
6 rreth janë plagët hyrëse dhe ato pa rreth janë plagët dalëse,
7 pra, vrima dalëse. Kjo është e renditur më tej në komentet më
8 poshtë.

9 Pra, ky person është shumë e drejtpërdrejtë, pra, është
10 një plagë e shkaktuar nga armë zjarri e drejtpërdrejtë, numër
11 3, në pjesën e sipërme të gjoksit e cila ka dalë pastaj, vrima
12 dalëse është në pjesën e pasme të trupit në anën e djathtë. Ka
13 penetruar, pra, indet e gjoksit.

14 Plaga e dytë në pjesën e përparme të gjoksit, pak më
15 poshtë, që ka qenë më shumë sipërfaqësore, pra, ka hyrë në
16 përballë dhe ka dalë në pjesën e prapme pa shkaktuar ndonjë
17 dëm

18 PY. Kjo është pika 8 në diagram, numri 8?

19 PË. Po është numri 8. Ka dalë, pra, në pikën 9 tregon vrimën
20 dalëse menjëherë prapa.

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Për ata që po na ndjekin kemi
22 numrin 9 të shënuar në pjesën e djathtë në cep të djathtë.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

25 PY. Tani, duke shënuar plagën në anën e djathtë të pjesës së

1 poshtme të shpinës?

2 PË. Po.

3 PY. Po.

4 PË. Pastaj kemi plagën në pjesën e sipërme të krahut të majtë
5 që në fakt është penetruese në indet e buta të pjesës së pasme
6 të shpatullës dhe del menjëherë në pjesën e shpatullës, pra,
7 në kockën e shpatullës. Kjo është plaga numër 6 vrima hyrëse
8 dhe vrima dalëse është numër 7.

9 PY. Po.

10 PË. Dhe pastaj kemi një tjetër vrimë hyrëse më poshtë, në
11 pjesën më të poshtme të krahut të majtë e cila del pastaj në
12 pjesën e jashtme dhe nga brenda, pra, vrima dalëse është në
13 pjesën e brendshme të krahut. Lexohet, mund ta lexojmë si
14 katër vrima hyrëse, katër vrima dalëse.

15 PY. Cili është përfundimi i patologut përpara që ta arrijmë
16 tek leximi që ju i keni dhënë aty? A është e saktë të kuptojmë
17 që raporti i patologut ka regjistruar këtë, pra, katër vrima
18 të plagës hyrëse, është e saktë?

19 PË. Nuk mendoj që e kanë analizuar në fakt. Ata thjesht i
20 kanë renditur, e kam fjalën që nuk ka dyshim që janë katër
21 vrima hyrëse të plagës dhe katër vrima dalëse.

22 Sugjerimi është, është thjesht sugjerim, që një plumb ka
23 hyrë nga pjesa e pasme e pjesës së sipërme të krahut të majtë,
24 ka dalë në pjesën, ka dalë nga pjesa e brendshme dhe pastaj ka
25 shku përmes gjoksit dhe ka dalë jashtë atje.

1 Kjo mund të jetë e gjithë një, një e shtënë, një plumb,
2 pra, është e mundur që ky person është qëlluar tre herë. Dhe
3 mund të ndodhë, mund të jetë edhe katër, por është thjesht
4 sugjerim që po bëj unë.

5 PY. Pra, sipas mendimit tim ka më shumë gjasa që të kenë qenë
6 tre të shtëna, tre plumba që kanë hyrë dhe kanë dalë.

7 PË. Mendoj që kështu është. Përshtypja ime është që ky njeri
8 është qëlluar në pjesën përpara, ndoshta ka patur krahun e
9 vendosur anash dhe në këtë rast plumbi ka plagosur, ka hyrë
10 përmes krahut dhe pastaj ka kaluar përmes indeve të buta të
11 krahut.

12 PY. Plaga 8 dhe 9 e shënuar në fund. Mund ta shohim këtu.

13 PË. Po.

14 PY. "Vrimë hyrëse e mundshme"?

15 PË. Po. Mund ta lexoni atë, "vrimë hyrëse e mundshme në
16 krahë".

17 PY. Dhe siç e shihni mund të jetë te pika -- është vrima
18 hyrëse 4 dhe 5 që shihet aty në thonjëza?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, mendimi juaj është ky sa i takon vrimave të plagëve
21 pra?

22 PË. Mendoj që të jemi të drejtë, patologu origjinal, kjo ka
23 qenë mënyra sesi e ka kuptuar ai, pra, plagët e shkaktuara.

24 Dhe kjo është shumë e qartë për mua, është e
25 drejtpërdrejtë. E vetmja gjë që unë do të shtoj është që mund

1 të jetë plagë rihyrëse kjo këtu, pra, që do të zvogëlonte
2 numrin e plagëve të shkaktuara në katër në tre, pra, vrimat
3 hyrëse.

4 PY. Dhe në fund përpara se të kthehemi tek raportit, dua t'ju
5 bëj një pyetje, të kthehem te një pyetje që ju ka bërë
6 Prokuroria lidhur me lëvizjen e trupit. Pyetja e fundit që ju
7 është bërë:

8 "A ka ndonjë mundësi në raport që tregon që trupi është
9 zhvendosur apo lëvizur dhe se viktimi mund të jetë -- ku mund
10 të jetë vrarë viktimi?"

11 Dhe mendimin që ju keni dhënë, a është e saktë që keni
12 thënë që ai ka shumë gjasa të jetë vrarë aty ku është gjetur?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe arsyeja -- janë dy arsye që e keni dhënë këtë. Është
15 njëra është sepse po të kishte qenë lëvizur do të prisnit më
16 shumë njolla gjaku?

17 PË. Po.

18 PY. Po të ishte qëlluar diku tjetër?

19 PË. Gjaku kullon dhe mund të ishte gjetur diku tjetër, do të
20 kisha pritur që të gjendeshin shenja gjaku diku tjetër. Dhe,
21 gjithashtu, nuk kemi fotografitë dhe duket thjesht dikush, një
22 person që është qëlluar dhe është shembur, pra, është rrëzuar
23 aty.

24 PY. Njëra prej karakteristikave që ju përmendni është se nuk
25 ka, nuk përmendet, nuk përmenden shenjat që të një trupi që

1 është në lëvizje aty?

2 PË. E saktë.

3 PY. A është e saktë të kuptojmë që shenjat që mund të
4 shkaktohen nga një lëvizje duken si një gërvishtje?

5 PË. Po.

6 PY. Po një prej karakteristikave të pazakonta në përgjithësi
7 lidhur me këto raporte është që ato nuk përshkruajnë asnjë
8 gërvishtje fare dhe kjo është diçka që e diskutuam?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe ju nuk keni fotografi të ndonjë pjese të këtyre
11 trupave të zhveshur me qëllim që të përcaktoni nëse apo jo ka
12 pasur gërvishtje që mund të jenë nën rrobat apo aty?

13 PË. Jo.

14 PY. Dhe sa i takon gjakderdhjes mbi rroba, duke pasur
15 parasysh se fotografitë e vendit të ngjarjes janë të marra të
16 gjitha me trupat në vendin ku ka ndodhur, nuk janë lëvizur
17 përpara. Nuk është e mundur që të shohim sasinë e gjakderdhjes
18 nga pjesa e pasme e trupit, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe si e tillë, a është e drejtë të themi, të arrijmë në
21 përfundimin, pra, që është bindëse që personi ka vdekur në
22 vendin ku është gjet duke marrë fotografitë?

23 PË. Nga informacioni që kam, do të sugjeroja që personat kanë
24 vdekur aty ku janë. Rrobat nuk duket që të jenë të një personi
25 që është tërhequr zvarrë në tokë. Por më shumë duken si dikush

1 që është rrëzuar menjëherë aty.

2 PY. Në qoftë se kthehemi në fillim, mund të lëvizim përpara
3 se të largohemi nga kjo kufomë.

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mund të kalojmë në faqen 5, ju
5 lutem, pyetja 1.

6 PY. Ju jeni pyetur, z. Clark:

7 "Çfarë informacioni në këtë procesverbal mund ta çojë
8 patologun që të arrijë në përfundimin se dhuna ka qenë e
9 dhunshme -- që vdekja ka qenë e dhunshme dhe ka shumë gjasa që
10 është shkaktuar -- që vrasja është shkaktuar si nga -- vdekja
11 është shkaktuar nga vrasja."

12 Do t'ju bëj një pyetje lidhur me nocionin e vrasjes.

13 Vrasja nuk është term mjekësor, apo jo?

14 PË. Jo.

15 PY. Është term ligjor?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe çfarë është vrasja dhe përkufizimi i vrasjes, vrasja
18 dhe përkufizimi i vrasjes ndryshon varësisht nga shteti,
19 juridiksioni ku gjendemi?

20 PË. Po.

21 PY. Siç e shpjeguat që në fillim, patologjia merret me
22 mekanizmin e vdekjes?

23 PË. Po.

24 PY. Vdekja, vrasja është çështje e mënyrës së vdekjes?

25 PË. Po.

1 PY. E kuptoj që po shkoj shumë shpejt. Po përpiqem të
2 ngadalësoj pak.

3 Vrasja është term që ju zakonisht prisni ta dëgjoni në
4 një autopsi, apo jo -- nuk është term që pritet të gjendet në
5 një raport autopsie zakonisht?

6 PË. Kështu është, nuk është term që do ta përdorja unë në
7 autopsi dhe nuk do të -- as nuk do të veja termin "vetëvrasje"
8 në autopsi. Megjithëse e di atë, jam i vetëdijshëm se në disa
9 juridiksione ndoshta kjo gjë pritet që të bëhet, pra, në
10 raportin e autopsisë --

11 PY. Po.

12 PË. -- që të flitet, pra, për mënyrën e vdekjes.

13 PY. Dhe ne nuk e dimë nëse kjo pritet nga patologu serb që të
14 shënonte termat të tillë?

15 PË. Po.

16 PY. Por me siguri, siç thoni ju, nuk është term që do të
17 përdorej nga ju, po të shkruanit ju këtë raport?

18 PË. Ashtu është. Edhe pse nuk lejohet që të flitet për
19 shkakun e vdekjes si vrasje, e kam fjalën fjalia është e
20 gabuar. Do të ishte mënyra e vdekjes --

21 PY. Kjo ishte pyetja ime e radhës. Vrasja nuk është shkaku i
22 vdekjes, apo jo?

23 PË. Jo.

24 PY. Vrasja është -- janë rrethanat e vdekjes?

25 PË. Po.

1 PY. Shkaku i vdekjes është mekanizmi i vdekjes?

2 PË. Po.

3 PY. Pra dhe kjo është puna e patologut që ta përcaktojë këtë
4 përgjigje?

5 PË. Po.

6 PY. Vrasja natyrisht mund të ndryshojë dhe të ketë kuptim
7 ligjor konkret dhe të ndryshëm varësisht nga vendi ku gjendemi
8 që - dhe kjo dallon nga juridiksioni në juridiksion, mbi, pra,
9 format e vrasjes, siç janë vrasje pa dashje, vrasje e
10 justifikueshme, për shembull?

11 PË. Po.

12 PY. Kemi dhe një term tjetër që është përdorur që është
13 vrasje e paqëllimshme?

14 PË. Po.

15 PY. Kjo mund të përfshijë, por nuk kufizohet tek vrasja e
16 qëllimshme. Pajtoheni me këtë? E kuptoj që ju po -- atë që po
17 prisni të thoni dhe ju ftoj që të komentoni në atë që po ju
18 ftoj, po ju kërktoj që të bëni komente ligjore?

19 PË. Po.

20 PY. Por vrasja është pa dashje është vrasja e -- vrasja e
21 qëllimshme është vrasja e një personi përmes një akti të
22 qëllimshëm?

23 PË. Po.

24 PY. E lëmë këtë. Ndoshta në terma më të thjeshtë. Pra,
25 zakonisht nuk është puna e patologut që të përcaktojë vrasje

1 të qëllimshme apo B, format, potencialet e ndryshme të
2 vrasjes, vrasje e paqëllimshme, aksidentale, e të tjera?

3 PË. Sigurisht që jo.

4 PY. Dhe ju përmendët vetëvrasjen para pak çastesh. Natyrisht
5 ka mënyra të tjera pas së cilave një person mund të vdesë
6 është vetëvrasja apo aksidenti?

7 PË. Po.

8 PY. Ju përmendët që zakonisht nuk shënoni fjalën "vetëvrasje"
9 në autopsi. Për plotësim a mund të na thoni ne pse kjo gjë?

10 PË. Sepse ka elementë të mjaftueshëm që nënkuptojnë në
11 raportin e autopsisë dhe sugjerojnë mënyrën e vdekjes së
12 personit dhe nuk do ta vendosja kurrë fjalën "vetëvrasje"
13 sepse duhet të ishte e qartë. Siç është, për shembull, në
14 qoftë se gjendet një person gjinden shenja të një vetëvrasjeje
15 përmes varjes, ai nuk ka nevojë të vendoset fjala sepse mënyra
16 e vdekjes është e qartë në vetvete.

17 PY. Kur komentoni dhe i përgjigjeni pyetjeve lidhur me
18 vrasjen, pyetjet që ju janë bërë nga Prokuroria, a duhet të
19 kuptojmë edhe ne dhe a është e drejtë përgjigjen tuaj se ju
20 jeni i mendimit që komentet që keni bërë lidhur me mënyrën,
21 rrethanat e vdekjes nuk janë punë e patologut?

22 PË. Jo, por është bërë këtu. E kam fjalën pajtohem me
23 komentin që nuk ka asgjë këtu që sugjeron se këto plagë të
24 shkaktuara nga armë zjarri kanë qenë vetëvrasje apo aksident,
25 pra, ngelet vrasja. Nëse patologu ndjehet i detyruar që të

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 159

1 përdorë termin atëherë në rregull.

2 PY. Por ju shënoni në gjetjet, thoni që ato konstatimet e
3 bëra në këto autopsi nuk janë në mospërputhje me një vrasje të
4 qëllimshme?

5 PË. Po.

6 PY. A është më e saktë kështu?

7 PË. Po.

8 PY. Pra, mënyra se si vendos të ta kuptojmë përfundimin tuaj,
9 pra, ndoshta në qoftë se -- a është e drejtë që të bëjmë një
10 përmbledhje të qëndrimit tuaj për këtë autopsinë e këtij
11 individ: Nuk ka që ka dyshime, sipas mendimit tuaj lidhur me
12 vërtetësinë e konstatimeve të mavijosjes dhe ka alternativa,
13 konstatime të tjera alternative të mundshme sipas mendimit
14 tuaj më të mira lidhur me rrugëtimin e trajektoren e predhës
15 dhe duhet të jemi të kujdesshëm, sipas mendimit tuaja lidhur
16 me praninë e mbetjeve të barutit. A është një përmbledhje e
17 saktë?

18 PË. Mendoj që është një përmbledhje e saktë.

19 PY. Duke patur parasysh atë që thamë më herët do të ishte e
20 drejtë që të themi që bazuar në konstatimet në raport, siç
21 është i joti, nuk mund të jemi absolutisht të sigurtë për
22 vërtetësinë dhe mbështetshmërinë në to?

23 PË. Cili raport?

24 PY. Raporti i patologut.

25 PË. Raporti i patologut.

1 PY. Nuk do të pajtohesha me tërësinë e konstatimeve aty.

2 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Pyetja u bë dhe u
3 përgjigj, përgjigja u mor disa herë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
5 Vazhdoni.

6 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po shoh nëse përgjigja u
7 regjistrua.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] U përgjigj
9 disa herë.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mund të kalojmë tek faqja tjetër,
11 faqja 7.

12 PY. Në krye të faqes 7, kemi personin me të cilin duhet të
13 merremi tani. Është raporti autopsisë që ju keni, që ju
14 përmendët më herët kur ju bë pyetja nga Prokurori.

15 Pyetja e parë lidhur me këtë ishte edhe këtu lidhur me
16 trajektoren e plagës të shkaktuar nga arma e zjarrit?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe në këtë shembull edhe këtu kemi një person ku sipas
19 jush plagët e shkaktuara nga armë zjarri, sipas fjalëve tuaja,
20 ishin "tejet të dyshimta", është kështu? Mund të përdorim
21 terminologjinë për referencë në krye të raportit rreshti i
22 dytë.

23 PË. Po.

24 PY. Dhe ndoshta mund ta shohim dhe në ekran.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të

Dëshmitari: John Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 161

1 shkoni më tej duhet të përfundoni brenda pesë minutash sepse
2 kemi takimin tjetër.

3 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Do të përfundoj brenda pesë
4 minutash.

5 PY. Ne e kemi referencën që po kërkoja, pra, plagët e
6 shkaktuara nga armë zjarri këtu, gjashtë plagët e shkaktuara
7 nga armë zjarri janë tejet të dyshimta, është kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Sot në mëngjes ju bë pyetja:

10 "... dhe plaga hyrëse dhe dalëse, pra, vrimat hyrëse dhe
11 dalëse të plagëve ishin shumë afër njëra-tjetrës, pra, të
12 dyja, pjesa -- të dyja në pjesën e prapme të trupit do të
13 ishin, duhet të ishin të pazakonta, përveç në rastet kur e
14 shtëna me armë është bërë nga një kënd shumë i mbyllur në
15 pjesën e pasme të shpinës që mendoj është e mundur sepse ka --
16 nuk kemi pak element që tregojnë nga pikëpamja e vrimës hyrëse
17 që ky ka ndodhur kështu. Pra, pritej që të ishte një formë e
18 çuditshme."

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ju lutem hiqni emrin po të shohim
20 shënimet.

21 PY. Z. Clark, a është e vërtetë që është diagrama që i përkon
22 kësaj autopsie?

23 PË. Po.

24 PY. Ju na bëtë një përshkrim, që e ndoqëm më herët dhe ju më
25 herët thatë ky person duhet të ketë qenë anash dhe "të ketë

1 pasur lëndime me armë zjarri në shpinë tangjentiale. Kjo mund
2 të jetë përgjigja por nuk e kam definitive.”

3 Tani e shikojmë këtë, ne shohim që ka një plagë në të
4 majtë, apo jo?

5 PË. Po. Ka një plagë që hyn nga kraharoni dhe ka dalë në
6 shpinë.

7 PY. Pra, ju e keni shënuar këtë tek 3 te 4. 4 është pika
8 poshtë apo jo që është në të majtë. Ajo që është e pazakontë
9 sipas jush është janë këto katër plagët në shpinë që janë
10 plaga hyrëse dhe dalje?

11 PË. Po është një kombinim i plagës me pikë hyrje e me pikë
12 dalje.

13 PY. Mirë. E marrim me terma më të thjeshtë. Si pikënisje do
14 të ishte shumë e pazakontë të shohësh një plagë me armë zjarri
15 që të ketë hyrë e të ketë dalë nga shpina jo më pastaj në
16 mënyrë si po e shohim këtu, apo jo?

17 PË. Mendoj se ka një shpjegim për këtë situatën e pazakontë
18 në shpinë, të paktën për dy nga këto plagë. Nuk është, pra,
19 tepër e pazakontë. Ekziston një shpjegim. Po është e vështirë
20 si ka ndodhur, s'e kuptoj dot si ka ndodhur. Se nuk janë as në
21 të njëjtin drejtim. Janë horizontalisht pak a shumë, 7 dhe 8,
22 ndërsa tjetra është me drejtim sipër, nga 5 tek 6. Pra, kjo
23 është ajo që tregon që ka pasur një lëvizje.

24 PY. A mund të themi që si pikënisje është e pazakontë të kesh
25 dhe plagën e hyrjes dhe të daljes në të njëjtën sipërfaqe të

1 trupit?

2 PË. Po.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 [Përkthim] Dëshmitar, do ta ndërpresim këtu. duhet të
5 ktheheni nesër në orën 9.00. Do të përfundojmë nesër dëshminë
6 tuaj. Faleminderit që ishit këtu sot.

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
9 largoheni. Mos flisni me askënd për dëshminë tuaj në Gjykatë.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
12 keni bërë një orë e 45 minuta deri tani. Nesër duhet ta
13 përfundojmë për 15 minuta.

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po mua më duhet një orë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po kemi
16 dëshmitarë tjerë që po presin.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po ju na keni thënë që kur kemi
18 nevojë për kohë shtesë do na e jepni.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur ju
20 nevojitet. Por nuk jam i bindur në këtë rast.

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po ky është një gjykim për vrasje
22 kështu që është e rëndësishme.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem bëni
24 një përmbledhje nesër për pikat kryesore edhe të vazhdojmë.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ky është një gjykim për vrasje dhe

1 kjo duhet thënë për procesverbal. Po më flasin këtu për
2 autopsinë e dhjetë viktimave që janë vrarë. Kjo është shumë e
3 rëndësishme për ne sepse duhet t'i bëjmë kundërpyetje një
4 patologu në një gjykim për vrasje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne ua kërkuam
6 ju parashikimin e kohës edhe ju jeni në fund të kohës suaj.

7 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Do ju kërkoj kohë kolegëve të mi
8 atëherë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I bie t'ia
10 merrni të gjithëve kohën.

11 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ne bashkërisht kishim gjashtë orë.
12 Nuk do t'i kalojmë gjashtë orët që kishim kërkuar. Dhe në
13 rrethanat kur kemi patolog në një gjykim për vrasje gjashtë
14 orë janë shumë të arsyeshme.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E di shumë
16 mirë çfarë gjykimi është ky. Unë po ju them që ju e kërkuat
17 vetë kohën tuaj dhe disa nga pyetjet që keni bërë janë të
18 panevojshme. Ju lutem trajtoheni nesër këtë.

19 Bëjmë pesë minuta pushim.

20 --- Seanca ndërpritet në orën 16.26

21 --- Seanca rifillon në orën 16.34

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është
23 planifikuar që të zgjasë kjo seancë. Sidomos duke mbajtur
24 parasysh nevojat e përkthyesve që të largohen. Do të përpiqemi
25 që të përfundojmë deri në orën 5.00.

1 I drejtohem Prokurorit për parashtrimet e tij.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Jemi në fazën përfundimtare të
3 paraqitjes të argumente dhe provave tona. ZPS-ja në
4 parashtrimin F02833, të -- tha se kanë mbetur edhe 11
5 dëshmitarë që priten të japin dëshmi nga shkurti deri në prill
6 2025. Kanë mbetur edhe 28 ditë seancash deri në atë kohë.
7 Sipas asaj që na e merr mendja ne, mendojmë se do ta arrijmë
8 datën që na është caktuar si datë për përfundimin e paraqitjes
9 së provave.

10 Ka disa dëshmitarë për të cilët nuk është bërë formalisht
11 njoftim përmes një parashtrimi zyrtar, mirëpo, bëhet fjalë për
12 një numër të kufizuar dëshmitarësh.

13 Dhe në fund mund të themi që e çmojmë kushtin që ta
14 përfundojmë paraqitjen e provave deri me datën 15 prill dhe do
15 të bëjmë çmos dhe jemi të bindur që do ta arrijmë këtë datë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja e dytë
17 ka të bëjë me parashtrimin e mocioneve sipas rregullës 153,
18 154 dhe 155. A ka ndonjë afat për këtë që parashikoni?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi parashikuar, mirëpo
20 mund t'ju jap një farë kalendari që e kemi paraparë ne si
21 Prokurori.

22 Për rregullën 154 të gjitha mocionet në lidhje me këtë
23 rregull janë dorëzuar, janë paraqitur për çdo dëshmitar që
24 është njoftuar që nga -- deri më prill. Në qoftë se ZPS-ja do
25 të bëjë njoftime për dëshmitarë të mëtejshëm kjo do të jetë në

1 lidhje me një grup të kufizuar dëshmitarësh dhe e kam ende
2 fjalën për rregullën 154.

3 Sa i përket rregullës 153 duhet të jemi në gjendje që t'i
4 bëjmë kërkesat për dëshmitarët e tjerë të mbetur brenda
5 rregullës 153 një muaj nga dita e sotme.

6 Për sa i përket rregullës 151 kemi të paktën edhe një
7 kërkesë të kësaj rregulle për të dorëzuar. Është e vështirë që
8 të japim kalendarin për parashtrimin e kësaj kërkesë, mirëpo
9 mund të mundohemi që t'ju japim një datë të përafërt.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E di që është
11 fjala për një person që është jashtë vendit për një kohë të
12 gjatë dhe për një tjetër që ka nevojë për një vlerësim
13 psikologjik.

14 Z. HALLING: [Përkthim] E di që për ç'ka e keni fjalën dhe
15 në këtë kontekst mund të flas në kategori. Mirëpo do t'ju
16 spjegoj.

17 Ka pasur ndikime për sa i përket njoftimin për dëshmitarë
18 që kanë dëshmuar dhe ata që kanë mbetur. Ka disa -- pika
19 katër, që dua t'i ngre dhe secilën do ta ngre duke bërë
20 komente të përgjithshme.

21 Pika e parë është çështja e dëshmitarëve jobashkëpunues
22 mbi të cilët ka pasur ndikim atmosfera e frikësimit dhe
23 kundërshtime të tjera për të dhënë dëshmi. Shumë prej këtyre
24 dëshmitarëve jetojnë jashtë Kosovës ku ZPS-ja nuk ka mundësi
25 që t'i detyrojë të vijin për të dhënë dëshmi.

1 Pika e dytë ka të bëjë me çështje mjekësore. Këtu
2 përfshihen njerëz që nuk janë të disponueshëm për arsye
3 mjekësore ose janë në rrezik shëndetësor po qe se do të
4 detyroheshin për të dhënë dëshmi.

5 Pika e tretë ka të bëjë me aspektin e sigurisë së
6 dëshmitarëve. Disa dëshmitarë kanë kërkesa më komplekse që
7 lidhen me sigurinë e tyre, dhe kjo ndikon në përgatitjet e
8 Prokurorisë se si do të thirren ata për të dhënë dëshmi.

9 Dhe pika e katër ka të bëjë dëshmitarë që ende janë në
10 vlerësim e sipër. Edhe pse i kemi përfunduar vlerësimet në
11 lidhje me dëshmitarët deri në këtë moment, mbeten disa
12 vlerësime të papërfunduar.

13 Ka kufi se deri çfarë mund të bëjmë ne për ta bindur një
14 dëshmitar që nuk është i vullnetit për të dhënë dëshmi. Atë
15 ç'ka mund të bëjë Prokuroria dhe atë që e ka bërë deri tani
16 është që të ndjekë një vijë të paraqitjes së provave ku të
17 mund të thotë se i kemi përdorur të gjitha mënyrat brenda
18 afateve dhe të kërkojmë mjet ndreqës, në bazë të rregullës 155
19 në mënyrë që të ndërmerren masat e duhura për të siguruar që
20 ato dëshmi të përfundojnë në kohën e caktuar.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur pritni që
22 të bëni rishikimin apo thjeshtëzimin e listave?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Besojmë që këtë do të mund ta
24 bëjmë pas përfundimit të këtij blloku të dëshmive.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Domethënë

1 deri të enjten e ardhshme?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, sa i
4 përket çështjes së shqetësimeve të Mbrojtjes në lidhje me këta
5 dëshmitarë të mbetur, a keni diçka për të ngritur ju si
6 Mbrojtje?

7 Do të fillojmë me Mbrojtjen e z. Thaçi.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

9 Lidhur me atë që tha Prokurori pak përpara u përmend një
10 datë, data 15 prill. Unë po e shikoj kalendarin dhe ditët që i
11 ka caktu Trupi Gjykses për gjykim. E kemi bllokun prej tre
12 javësh që vazhdon deri me datën 4 prill dhe nuk e di se si
13 mund të vazhdojmë deri në datën 15 apo si do zgjatet ai afat
14 për të kaluar tek blloku i katër apo i pestë i dëshmimeve. Sepse
15 në kalendar momentalisht nuk ka data të caktuara për seanca.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Kur i dhashë ditët e mbetura të
17 seancës, 28, që i përmenda, ne i kemi numëruar këto ditë në
18 bazë të kalendarit aktual. Domethënë, deri me 4 prill. Mirëpo
19 ju thatë që data e jonë për përfundimin e provave është 15
20 prill.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë e kam
22 thënë para një -- dy vitesh.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Po, ashtu është. Por, meqë me
24 kalendar është 4 prilli, atëherë do të përpiqemi të jemi
25 brenda asaj.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse ka
2 situata emergjente që duhet të plotësohet kalendari, atëherë
3 do ta bëjmë këtë, mirëpo nuk do ta kisha bërë këtë pa një
4 arsye të fortë.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Shqetësimi im i ardhshëm ka të
6 bëjë me atë që do të vijojë pas këtij blloku apo dy blloqesh
7 dëshmish që kanë mbetur për t'u paraqitur. Ne kemi nevojë që
8 të njoftohemi paraprakisht dhe në kohë në lidhje me
9 dëshmitarët që do të vijnë për të dhënë dëshmi. Mirëpo nuk
10 mund të hamendësojmë se sa kohë do të duhet. Domethënë, na
11 duhet një njoftim paraprak shumë në kohë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pas javës së
13 ardhshme, të enjten e javës së ardhshme, kur të na njoftojë
14 Prokuroria për thjeshtëzimin e numrit apo zvogëlimin e numrit
15 që e kanë bo, atëherë do të kemi një pasqyrë më të qartë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

17 E treta që duam që ngremë si problem është, ju e dini, të
18 nderuar Gjykatës, se kemi një kërkesë që ende nuk është
19 zgjidhur apo është shqyrtuar, është kërkesa F02620, në lidhje
20 me dy dëshmitarët për të cilët i kemi kërku Prokurorisë që t'i
21 detyrojë të paraqiten në Gjykatës.

22 Në goftë se këta dëshmitarë do të thërriten për të dhënë
23 dëshmi atëherë kërkojmë që të njoftohemi paraprakisht në kohë
24 edhe në lidhje me të në mënyrë që të kemi kohë t'i -- të kemi
25 mundësi të planifikojmë dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë të

1 rëndësishëm në qoftë se këta nuk janë të disponueshëm.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kemi
3 parasysh këtë.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Mirëpo nga perspektiva ime si
5 Mbrojtje në qoftë se kjo kërkesë e Prokurorisë, kjo kërkesa
6 miratohet, atëherë dua që të njoftohemi paraprakisht.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne po punojmë
8 në vendimin për atë kërkesë.

9 Në rregull. Dikush tjetër a ka diçka për të ngritur?

10 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Tre pika të shkurtra.

11 E para, ne kërkojmë që 4 prilli të caktohet si dita e
12 fundit e paraqitjes së provave nga ana e Prokurorisë.

13 Pika e dytë, është e ngjashme, në qoftë se deri të enjten
14 e ardhshme marrim orarin e fundit, ai duhet të përfshijë edhe
15 dëshmitarët e tjerë të mundshëm shtesë që mund t'i thërrasë
16 Prokuroria përveç atyre pesë deri në shtatë që i ka përmendur.
17 Dhe ajo të jetë listë përfundimtare dhe vetëm në raste
18 përjashtimore kur Prokuroria paraqet arsye të vlefshme se mund
19 të shtohet ai numër, atëherë, po. Dhe jo të jetë një farë
20 liste e hapur e pafund.

21 Dhe e treta, e kemi njoftuar Prokurorinë për disa
22 dëshmitarë kyçë që do të vijjnë për të dëshmuar, dhe në lidhje
23 me ta duam që të na japë një njoftim paraprak në kohë dhe atë
24 të na e njoftojë shumë ma përpara. Domethënë, na duhet një
25 siguri më e madhe dhe duhet që të Prokuroria të mbahet brenda

1 afateve që janë përcaktuar. Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 Z. TULLY: [Përkthim] Vetëm një pikë. E di që s'kemi
4 mbërritur te ajo pikë e agjendës, pikat në lidhje me mocionet
5 e rregullës 153, 154 dhe 155. Mirëpo, na duhet një listë e
6 përgjithësuar e provave materiale të pranuar pa dëshmi
7 gojore. Nuk kemi përqindjen e këtyre provave. Janë paraqitur
8 shumë materiale të tilla. Dhe ndoshta duhet të paraqiten dhe
9 shumë të tjera, mirëpo na duhet një farë numri i përafërt i
10 tyre.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Mund t'i përgjigjem Mbrojtjes së
12 Veselit dhe çështjen që ngriti z. Tully.

13 Shkurtimisht, ne vazhdojmë të punojmë aktivisht në lidhje
14 me listën e provave materiale, në lidhje me materialet të
15 dorëzuara pa dëshmi gojore. Kemi dy materiale në lidhje me to
16 kemi paraqitur -- përgatitur mocionet që do të dorëzohen. Këto
17 kanë të bëjnë me dy zona të UÇK-së, zonën e Pashtrikut dhe të
18 Dukagjinit. Dhe një mocion tjetër që ka të bëjë me raporte
19 ndërkombëtare.

20 Sa i përket asaj që tha z. Dixon, që të na caktohet një
21 datë e synuar për përfundimin e paraqitjes së provave, ne jemi
22 të vetëdijshëm për detyrimet tona.

23 Në qoftë se duhet të njoftojmë Mbrojtjen për një
24 dëshmitar të ri, atëherë këtë sigurisht që do ta njoftojmë dhe
25 nuk ka nevojë që për secilin dëshmitar të jetë koha e njëjtë

1 paraprahe e njoftimit sepse nuk kanë të gjithë nevojë për t'u
2 njoftuar shumë paraprakisht.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 [Përkthim] Atëherë ndoshta do ju duhet një farë afati për
5 sa i përket mocioneve në lidhur me materialet jогоjore sepse
6 në këtë mënyrë sigurohet që i gjithë materiali i Prokurorisë
7 është dorëzuar.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Ne kemi ndërmend që ta
9 përfundojmë paraqitjen e provave pa paragjykuar vendimet e
10 ardhme të Trupit Gjykues.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka duhet
12 një ditë e caktuar, si për shembull, e enjtja për të bërë
13 paralajmërim konkret në lidhje me heqjen e ndonjë dëshmitari
14 prej listës apo të ngjashme. Personi i pari që ju duhet të
15 njoftoni në këtë drejtim është Mbrojtja

16 Dhe është me rëndësi që Mbrojtja të njoftohet sa më
17 shpejt që është mundur për dëshmitarët e tillë.

18 Në rregull. Atëherë grupi i ardhshëm ka të bëjë me
19 kërkesat e mundshme, në bazë të rregullës 130, ne i kemi kërku
20 nga Mbrojtja që të na japë informacion në lidhje me oraret apo
21 afatet sa kohë ju duhet për të përgatitje dhe kur e kanë
22 ndërmend t'i dorëzojnë këto mocione.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Jam konsultuar me kolegët e mi të
24 ekipeve të Mbrojtjes. Kemi nevojë për katër javë për të
25 përgatitur mocionet tona të rregullës 130.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur të
2 përfundojë provat e saj Prokuroria?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe atëherë
5 do i dërgoni një të përbashkët?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Ashtu s'i kemi diskutuar ende
7 po besoj, besoj se po.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të na
9 thjeshtëzonte situatën.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Ka disa gjëra të cilat janë të
11 veçanta për të akuzuar të veçantë të cilat duheshin. Pastaj
12 janë disa çështje të tjera që janë më të përgjithshme që kanë
13 bëjnë të bëjnë me numrin e përgjithshëm të fjalëve, e kështu
14 me radhë. Pra, ka çështje specifike.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Diskutoni. E
16 kuptojmë që ka disa kufizime por në qoftë se ka ndonjë mundësi
17 për të patur një dokument të përbashkët, do të ishte mirë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. HALLING: [Përkthim] A mund të japim edhe ne mendimin
20 tim?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Ne nuk kemi kundërshtim për këtë
23 kërkesë të palës Mbrojtëse edhe ne do të kishim kërkuar një
24 mocion të përbashkët dhe ne do të kërkonim po kështu edhe një
25 muaj të kishim në dispozicion për të dhënë përgjigjen tonë.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne nuk kemi asnjë kundërshtim
2 lidhur me kohën që kërkon Prokuroria që të jetë e njëjtë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta marrim
4 parasysh të gjithë këtë sa i përket afatit kohor.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar, është një gjë që ka të
6 bëjë me përfundimin e rastit të Prokurorisë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përsëriteni.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Do të shohim se kur do të fillojë
9 numërimi i ditëve pas përfundimit të provave të Prokurorisë.
10 Rregulla 129, i nderuar Gjykatës, ka të bëjë me provat në të
11 cilat mbështet Prokurori. Kështu që ne do të duhen mocionet
12 mbi provat jogojore përpara. Dhe prandaj do të thoja që një
13 gjë e tillë të bëhej përpara 15 prillit dhe prandaj kërkoja që
14 të fiksohen datat e plota dhe të sakta.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 [Përkthim] Po, është një çështje vërtetë e rëndësishme të
17 cilën do ta trajtojmë.

18 Tjetra është hipotetike, por sa kohë kërkon ju për të
19 përgatitur nga dalja e vendimit me rregullën 130 dhe për
20 fillimit të paraqitjes të provave nga ana e palës Mbrojtëse
21 nëse një gjë e tillë është e nevojshme?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të them edhe një herë që kemi
23 konsultuar të katër ekipet e Mbrojtjes dhe kërkojmë dhjetë
24 javë, dhjetë javë punë dhe që të mos përfshihen këtu javët e
25 pushimit veror. Arsyet janë të shumta, por një nga këto kanë

1 të bëjnë me faktin që është vështirë për të marrë dëshmi dhe
2 për të pyetur gjatë pushimeve të verës. Kjo ka të bëjë jo
3 vetëm me ne si ekip, por edhe me dëshmitarët.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, dhjetë
5 javë kërkoni?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhjetë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuroria
8 dëshiron të flasë?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Ne do ta rezervojmë qëndrimin tonë
10 derisa të kemi, të arrijmë momentin e duhur. Më lejoni të them
11 diçka lidhur me rregullën 129, të nderuar Gjykatës, që
12 përmendi z. Dixon. Kjo rregull thotë që bëhet fjalë për
13 dëshmitarë të cilët do të duhet të paraqi -- për të cilën
14 duhen të paraqiten prova. Nuk thuhet që të pranohen këto
15 prova. Dhe në fakt Prokuroria mund ta mbyllë paraqitjen e
16 provave të saj edhe përpara sesa të merret vendimi lidhur me
17 provueshmërinë apo jo të provave. Kjo nuk kërkohet nga
18 rregulla, megjithatë, ne do të përpiqemi që t'i dorëzojmë këto
19 mocione sa më shpejt që të jetë e mundur.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund ta jap mendimin tim? E
22 rëndësishme për ne është që në qoftë se -- ne duhet të
23 dorëzojmë mocionin tonë të rregullës 130 dhe këtë ne nuk mund
24 ta bëjmë lehtësisht në qoftë se nuk e dimë se cilat prova të
25 Prokurorisë janë pranuar.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
2 kalojmë tani në paragrafin 8. Në qoftë se do të paraqisni
3 prova për sa i përket gjykimit, cili është vlerësimi juaj prej
4 secilit ekip lidhur me paraqitjen e provave tuaja.

5 Kjo është thjesht një opsion, nuk po ju kërkoj që ta bëni
6 këtë, nuk jeni i detyruar ta bëni një gjë të tillë.
7 Megjithatë, ne po përpiqmi të planifikojmë pjesën tjetër të
8 vitit. Në qoftë se mund të na e tregoni këtë informacion
9 dakord, në qoftë se nuk e tregoni dot, përsëri edhe kjo është
10 në rregull.

11 Fillojmë me Mbrojtjen e Thaçit.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam për të thënë gjë.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Të njëjtën gjë, edhe unë nuk jam në
14 gjendje ta them gjë -- ta them këtë.

15 Z. TULLY: [Përkthim] Të njëjtën gjë. Edhe ne jemi me të
16 njëjtin qëndrim. Do t'ju njoftojmë sa më shpejt që të jetë e
17 mundur.

18 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kemi të njëjtin qëndrim.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni pyetje
20 për Trupin Gjykses ju si palë Mbrojtëse përveç atyre që kemi
21 diskutuar?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Është një pyetje së cilës nuk ka
23 nevojë t'i jepet përgjigje tani, pasi nuk e keni shqyrtuar
24 ende si Trup Gjykses, por në qoftë se pala Mbrojtëse nuk do të
25 paraqesë provat e saj, dhe atëherë ne si Mbrojtje themi që nuk

1 kemi paraqitur prova të mjaftueshme nga Prokuroria. A do të
2 kalojë Trupi Gjykses drejtpërsëdrejti në fazën e dosjeve
3 paraprake?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj
5 pyetjen që keni bërë. Do ta diskutojmë këtë më vonë. Do të
6 japim përgjigje më vonë.

7 Z. Tully, a deshët të ngriheshit edhe njëherë? Jo.

8 Z. TULLY: [Përkthim] Jo, thjesht për -- thjesht po
9 ç'mpihesha pak.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk desha të
11 injoroj këtu edhe Mbrojtësin e Viktimave. A mund të na tregoni
12 lidhur me informacionin e kërkuar në paragrafin 10?

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ne mendojmë që do të thërrasim
14 tre deri në katër dëshmitarë që të vijjnë këtu. Një prej tyre
15 do të jetë ekspert -- ekspert, dëshmitar ekspert, do të bëjmë
16 kërkesa në bazë të rregullës 153 dhe 154 - më falni, 155. Dhe
17 ne mendojmë që provat tona të mund t'i paraqesim brenda një
18 jave dhe ndoshta mund të kalojmë në javën e dytë, por nuk do
19 të jetë, nuk ka mundësi që të jetë dy javë të plotë. Por nuk
20 jemi në gjendje ta parashikojmë këtë pasi nuk e dimë sesa do
21 të zgjasë edhe seanca apo sa do të zgjasë seancë e
22 kundërpjetjes.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju
24 kërkojmë që ta mendoni këtë për të ardhmen. Megjithatë, në
25 qoftë se vazhdon kjo çështje edhe më tutje, desha thjesht për

1 parashikimin e kohës, në qoftë se pra kërkohet që të paraqiten
2 dosjet paraprake.

3 Pra, fillojmë me Prokurorinë.

4 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne jemi të
5 gatshëm t'i përmbahemi afatit -- rregullës 150 -- 134(b). Kjo
6 mund të -- kjo mund të -- në qoftë se pala Mbrojtëse nuk ka --
7 nuk ka dëshmi të saj që do të zgjasin aq shumë, atëherë ne do
8 të kërkoni që të jepet i njëjti afat kohor që i jepet edhe
9 palës Mbrojtëse në qoftë se bëhet një gjë e tillë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, a
11 keni diçka për të thënë?

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, desha ta ngrija këtë në
13 çështjet e tjera.

14 Ne jemi ata të cilët prekemi më shumë nga kundërshtimi i
15 rregullës 130. Një nga ekspertët që do të paraqesim dëshiron
16 që të ketë një datë të caktuar për t'u paraqitur. Dhe ka një
17 numër çështjesh që duhet të diskutojmë. Por -- dhe kryesorja
18 është data se kur do ta përfundojë paraqitjen e provave të saj
19 pala e Prokurorisë. Në qoftë se nuk e paraqet me datën 4, pasi
20 ngelen disa mocione të cilat nuk janë diskutuar, ne do të
21 duhej ta dinim këtë datë sa më shpejt që është e mundur, pasi
22 mund ta fillojmë matematikën tonë që nga ai moment, pra një
23 muaj nga përfundimi i paraqitjes së provave nga Prokuroria për
24 këtë çështje.

25 Kjo ka rëndësi pasi në qoftë se ka vonesa do të shkojmë

1 menjëherë tek pushimi i verës dhe fundi i korrikut. Për ne nuk
2 është problem, por thjesht ndryshon mënyrën dhe rendin e
3 punëve tona, kryesisht për sa i përket një dëshmitari ekspert
4 që duam ta paraqisim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të ishte
6 mirë sikur kjo gjë të mund të përfundonte përpara pushimit të
7 verës, dhe sigurisht që secilës palë do t'i japim një muaj për
8 ta paraqitur mocionin e saj të rregullës 130.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të varet nga përfundimi i tërë
10 çështjes gjyqësore dhe sa kohë do t'ju duhet juve, të nderuar
11 Gjykatës. Janë në duart tuaja. Por, nuk po tregohem jorealit.
12 Po them që në fund të korrikut do të jetë afati përfundimtar.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord. Të
14 gjithë e kemi problem këtë parashikim kohor.

15 A ka çështje të tjera që doni të ngrini? A ka ndonjë gjë
16 që do të ngrëjë ndokush tjetër?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkurtimisht, dy gjëra. E para,
18 kemi ngritur *inter partes* me Prokurorinë çështjen e
19 dëshmitarit të parë të bllokut të provave të ardhshme. I kemi
20 kërkuar Prokurorisë që të na tregojë një javë njoftim paraprak
21 për shkak të volumit të dëshmisë që do të jepet. Na është
22 dhënë përgjigje që ndoshta një gjë e tillë nuk është e mundur,
23 dhe kemi kërkuar apo kemi rezervuar qëndrimin tonë nëse mund
24 të thirret ky dëshmitar, sa kohë do na duhet, sa të gatshëm do
25 të jetë pra, nuk e dimë nëse në këtë moment do të jemi -- do

1 të na duhet të kërkojmë kohë të mëtejshme për t'u përgatitur
2 duke pasur parasysh sesa voluminoze është dëshmia e tij.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A është ky
4 për bllokun tjetër? Sa kohë do t'ju nevojitet? Dhe a mund t'i
5 jepni një njoftim paraprak sa më shpejt?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmitari do të vijë me datën 10
7 dhe ne thamë datën 5. Janë katër ditë përpara se të fillojë
8 dhënia e dëshmisë së tij. Dhe ne kështu e kemi kuptuar
9 rezervimin e palës Mbrojtëse.

10 Ky është një dëshmitar i madh, por ne nuk mendojmë që ky
11 do të jetë aq i madh si -- apo me kohëzgjatje kaq të madhe sa
12 Dëshmitari W0441 [Sipas përkthimit] vitin e shkuar. Ne
13 mendojmë që sipas rrethanave iu kemi dhënë njoftimin e duhur.
14 Ndoshta mund të ndryshojmë pak rendin, të vendosim një
15 dëshmitar më pak të rëndësishëm në fillim të javës.
16 Megjithatë, ne po përpiqemi që t'i zgjidhim pikërisht edhe
17 problemet që ka ngritur pala Mbrojtëse në këtë drejtim.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 [Përkthim] Atëhere rishikojeni dhe një herë për ta parë
20 nëse mund të jepni parashikim -- një paralajmërim pak më të
21 gjatë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] E vlerësoj, e vlerësoj këtë nga
23 ana e z. Halling. Nuk po e akuzoja atë që nuk po sillej në
24 mënyrën e duhur.

25 Çështja e dytë, është ajo që është ngritur nga Prokuroria

1 lidhur me dëshmitarët dhe sapo mu kujtua një gjë e tillë, se
2 në qoftë se ka dëshmitarë që ato po përpiqen t'i sigurojnë
3 tani, dhe ndoshta nuk realizohet një gjë e tillë dhe në këtë
4 rast do të bëhen ndoshta mocione të rregullës 155, doja
5 thjesht ta ngrija çështjen që kjo mund të krijojë probleme për
6 ne pasi këtu bëhet fjalë që ne si palë Mbrojtëse nuk jemi në
7 gjendje për të parë nëse janë shfrytëzuar të gjitha mjetet
8 ligjore përpara se të paraqitet dëshmia e tyre sipas 155. Dhe
9 kjo ka të bëjë me shumë çështje të sigurisë dhe e di që është
10 problem.

11 Megjithatë, duhet ta paraqes këtë për procesverbal pasi
12 pala e Prokurorisë do të duhet të japë prioritetin e duhur
13 dëshmitarëve të duhur dhe të -- dhe në qoftë se nuk i kanë të
14 bëjnë një aplikim lidhur me këtë drejtim. Dhe ne mendojmë që
15 nuk i kanë bërë përpjekjet e duhura për të siguruar dëshminë
16 ne do ta ngremë këtë çështje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta marrim
18 këtë vendim në momentin e duhur.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Ne duam të pyesim lidhur me dosjet
20 përfundimtare të palës Mbrojtëse.

21 Nuk donim ta diskutonim këtë, pasi nuk është momenti i
22 duhur, megjithatë, ne deshëm që t'ju pyesim nëse mund ta
23 ngremë këtë çështje me shkrim për ju, të nderuar Gjykatës,
24 pasi na duhet një periudhë më e gjatë sesa 30 ditë, duke pasur
25 parasysh sesa të ndërlikuara janë çështjet. E dyta, ne do të

1 kërkojmë që kjo të bëhet në rendin e duhur. Fillimisht ta japë
2 Prokuroria dosjen e saj pasi është një numër [E pakuptueshme]
3 që do të ngrihet nga ana e Prokurorisë dosjen e saj
4 përfundimtare. Ne do të përgatitemi në kohën e duhur, por duke
5 pasur parasysh faktin se në ç'prova do të mbështetet
6 Prokuroria dhe ne do t'ju ndihmonin ju, të nderuar Gjykatës,
7 në qoftë se shkruanim dosjen tonë bazuar në ato që kërkon të
8 shfrytëzojë Prokuroria si provë.

9 Pra, ne deshëm thjesht të paraqisnim arsyet tona pasi ky
10 është një ndryshim qasjeje. Ne mendojmë se është një, një, një
11 qëndrim apo qasje mjaft e efektshme dhe do të sqarojë shumë
12 çështje për ju, të nderuar Gjykatës në këtë drejtim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe ju doni
14 që këto çështje t'i paraqisni me shkrim? Dakord mund ta bëni
15 një gjë të tillë. Prokuroria mund të japë përgjigjen e saj
16 pesë ditë më pas dhe më pas do ta diskutojmë këtë çështje.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Do ta bëjmë këtë dhe me këtë
18 kursejmë edhe kohën.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por kur do ta
20 bëni?

21 Z. DIXON: [Përkthim] Desha të kisha udhëzim nga ana juaj.
22 Ne do ta bëjmë sa më shpejt që të jetë e mundur. Ne kemi mjaft
23 çështje të cilat janë më prioritare për momentin, por një
24 udhëzim nga ana juaj do të ishte me vlerë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 [Përkthim] ... pas dëshmisë së javës së ardhshme, ne kemi
2 një javë pushim dhe atëherë do të duhet ta dorëzoni në atë
3 periudhë kohore.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Dhe ju kërkon, të nderuar Gjykatës,
5 që ne ta bëjmë të premtën e asaj jave?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Kështu do të bëjmë.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Si përgjigje nga ana jonë, pesë
9 ditë apo limitin mes -- që është me ligj, që është dhjetë, që
10 desha ta konfirmoj. Nuk është pesë po dhjetë.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Misetic, a mund të
12 sqaroni një gjë? Ju thatë që:

13 "Në qoftë se pala Mbrojtëse nuk ka për të paraqitur, nuk
14 ka për të paraqitur dëshmitë e saj dhe arrijmë në momentin që
15 nuk ka -- nuk ka asnjë gjë që është provuar ..."

16 Në qoftë se nuk ka gjë që nuk është -- që është pranuar,
17 atëherë përfundon çështja. Këtë deshe të thoje, apo e the
18 gabim?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, shfrytëzova këtë terminologji
20 për të thënë që në kërkohet një mocion i rregullës 130 dhe do
21 të shohim se me çfarë standardi do të bëhet një gjë e tillë
22 ose mund të thuhet që në qoftë se nuk kemi -- do të paraqesim
23 dëshmi mund të kalojmë në argumentet përfundimtare.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne themi që pala Mbrojtëse nuk ka

1 prova për të paraqitur, për shembull, dhe në qoftë se --

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju nuk do ta shfrytëzoni
3 mocionin e rregullës 130, kështu është?

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, ashtu është, nëse ka nevojë
5 këtë gjë do të bëjmë. Do të paraqesim mocion kur të kthehemi
6 që nuk është provuar asgjë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 [Përkthim] Do përpiqemi që ta shikojmë këtë në transkript
9 dhe t'ju japim përgjigjen tuaj. Do të presim dhe çfarë keni
10 për të paraqitur ju.

11 Ju falënderoj të gjithëve që erdhën këtu.

12 Përkthyesve ju kërkoj ndjesë që kaluam, që ndodhi kjo
13 punë dhe u zgjat më shumë sesa duhej, por në fakt kështu
14 funksionojnë punët me avokatët. Faleminderit.

15 Takomi nesër.

16 --- Seanca mbyllet në orën 17.07

17

18

19

20

21

22

23

24

25